



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 32

Tiranë – E martë, 28 shkurt 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 8/2023, datë 2.2.2023	Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror..... 3212
Dekret i Presidentit nr. 32, datë 24.2.2023	Për shpallje ligji..... 3234
Ligj nr. 15/2023, datë 16.2.2023	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Finlandës për eliminimin e tatimit të dyfishtë, në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin e shmangien e evazionit tatimor..... 3235
Dekret i Presidentit nr. 33, datë 24.2.2023	Për shpallje ligji..... 3246
Dekret i Presidentit nr. 35, datë 24.2.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3246
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1, datë 15.2.2023	Mbi përcaktimin e metodave të marrjes së mostrave dhe analizave për kontrollin e niveleve të mikroelementeve dhe kontaminantëve të përpunimit në produktet ushqimore..... 3247
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 2, datë 17.2.2023	Mbi programet e kontrollit për mbetjet e pesticideve..... 3263
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm, i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 28, datë 24.2.2023	Mbi bashkëpunimin e strukturave të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për garancinë financiare në procedurat e vlerësimit të vizave për të huajt..... 3263
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 63, datë 17.2.2023	Për delegim kompetencash 3264

Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 2607, datë 24.2.2023	Mbi hyrjen në fuqi të një memorandumit mirëkuptimi me Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut.....	3265
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 1, datë 23.1.2023	Me objekt zgjidhjen e konfliktit të kompetencave ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10-ta e deputetëve. Deklarimin e vendimeve nr. 83, datë 17.11.2022, “Për mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka”, dhe nr. 84, datë 17.11.2022, “Për miratimin e raportit të shumicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka”, të Kuvendit të Shqipërisë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	3265
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 23.1.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 83, datë 17.11.2022, “Për mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka”, dhe nr. 84, datë 17.11.2022, “Për miratimin e raportit të shumicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka”, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka.....	3286
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. 59(470), datë 11.2.2022	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Luçjan Shqau.....	3206
	Kërkesë për shpalljen të vdekur së shtetases Tefta Kallaku.....	3206



LIGJ
Nr. 8/2023

**PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT
PËRMBARIMOR GJYQËSOR
SHTETËROR**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83,
pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror, kushtet që duhet të përmbushin shtetasit për të ushtruar detyrën e përmbarruesit gjyqësor shtetëror, statusin, vlerësimin etik dhe profesional të tyre, procedimin disiplinor, përfundimin e marrëdhënies në shërbimin përmbarrimor gjyqësor shtetëror, si dhe marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe me subjektet e tjera publike dhe private.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për përmbarruesit gjyqësorë shtetërorë, që kryejnë veprimtarinë përmbarrimore për ekzekutimin e titujve ekzekutivë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, Kodin Civil dhe aktet e tjera ligjore, si dhe për subjektet e tjera publike dhe private, që përfshihen në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm.

2. Ky ligj zbatohet edhe për veprimtaritë dytësore që kryen përmbarruesi gjyqësor shtetëror, si:

a) kryerja e njoftimit të akteve gjyqësore dhe dokumenteve zyrtare;

b) njoftimi dhe mbledhja e detyrimeve financiare me mirëkuptim, me kërkesë të të interesuarve;

c) kryerja e konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike, sipas legjislacionit në fuqi, me kërkesë të të interesuarve;

ç) shitja e sendeve në ankand publik, me kërkesë të të interesuarve.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Përmbarruesi gjyqësor shtetëror” është shtetasi i emëruar nga ministri i Drejtësisë për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë dhe veprimtarive dytësore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

b) “Ministri” është ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë;

c) “Ministria” është ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë;

ç) “Veprimtari dytësor” është veprimtaria që kryhet nga përmbarruesi gjyqësor shtetëror sipas përcaktimeve të këtij ligji;

d) “Kryetari i zyrës përmbarrimore” është përmbarruesi gjyqësor shtetëror që ushtron edhe funksionin e drejtimit administrativ të zyrës përmbarrimore vendore;

dh) “Komandimi” është caktimi i përkohshëm i përmbarruesit gjyqësor shtetëror të zyrës përmbarrimore vendore në pozicionin e inspektorit në strukturën përgjegjëse për inspektimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarrimit, sipas parashikimeve të këtij ligji;

e) “Transferimi” është lëvizja e përkohshme ose e përhershme e përmbarruesit gjyqësor shtetëror nga zyra përmbarrimore në të cilën është emëruar në një zyrë tjetër përmbarrimore në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë ligj.

Neni 4
Shërbimi Përmbarrimor Gjyqësor

Shërbimi Përmbarrimor në Republikën e Shqipërisë organizohet në Shërbimin Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror, sipas këtij ligji, dhe në Shërbimin Përmbarrimor Gjyqësor të organizuar



mbi baza private, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbarrimor gjyqësor privat.

Neni 5

Parimet bazë të veprimtarisë përmbarrimore

1. Përmbarruesi gjyqësor shtetëror gjatë ushtrimit të profesionit udhëhiqet nga parimet bazë të ligjshmërisë, ndershmërisë, paanësisë, profesionalizmit, etikës dhe respektimit të të drejtave dhe interesave të palëve në procesin e ekzekutimit.

2. Përmbarruesi gjyqësor shtetëror në ushtrimin e veprimtarisë përmbarrimore përfaqëson autoritetin shtetëror.

3. Përmbarruesi gjyqësor shtetëror në ushtrimin e detyrave të tij i nënshtrohet zbatimit të dispozitave të këtij ligji, Kodit të Procedurës Civile, Kodit Civil dhe akteve të tjera për ekzekutimin e titujve ekzekutivë dhe kryerjen e veprimtarive dytësore.

KREU II

SHËRBIMI PËRMBARRIMOR GJYQËSOR SHTETËROR

Neni 6

Organizimi i Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror

1. Shërbimi Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror varet nga ministri dhe organizohet në nivel qendror dhe vendor, si vijon:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit, e cila përbën nivelin qendror të organizimit;

b) zyrat përmbarrimore vendore, të cilat përbëjnë nivelin vendor të organizimit dhe varen administrativisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit.

2. Rregulla të hollësishme lidhur me metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit dhe zyrave përmbarrimore vendore përcaktohen në rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit, e cila miratohet me urdhër të ministrit.

Neni 7

Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarrimit

1. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit përgjigjet për drejtimin, bashkërendimin dhe

Faqe | 3212

kontrollin e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror.

2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit.

3. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi brenda vendit, me diplomë “Master i shkencave” ose “Master profesional”, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike apo të barasvlershme me to, ose të ketë përfunduar studimet universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

c) të ketë jo më pak se 7 (shtatë) vjet përvojë profesionale si jurist;

ç) të mos jetë shkarkuar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

d) të ketë integritet të lartë moral;

dh) të plotësojë kriteret për të mos iu nënshtrohet ndalimeve për t’u emëruar në një funksion publik sipas legjislacionit në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

e) të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit në kuptimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;

ë) të mos jetë dënuar me vendim penal të formës së prerë për vepra penale të kryera me dashje.

4. Funksioni i drejtorit të përgjithshëm të Përmbarrimit është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër shtetëror, me anëtarësimin në partitë politike dhe pjesëmarrjen në veprimtaritë e tyre, si dhe me çdo veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies.

Neni 8

Përgjegjësitë e drejtorit të përgjithshëm të Përmbarrimit

Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit ka këto përgjegjësi:



a) drejton, bashkërendon dhe kontrollon veprimtarinë e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror;

b) siguron unifikimin e kuptimit dhe zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe të praktikave në fushën e veprimtarisë procedurale të ekzekutimit;

c) përgatit dhe nxjerr urdhra dhe udhëzime të brendshme me natyrë administrative ose procedurale, si dhe metodika për mbarëvajtjen dhe metodën e punës, trajtimin në përgjithësi të çështjeve në ekzekutim për garantimin e kuptimit dhe zbatimit uniform të ligjit dhe praktikave në fushën e veprimtarisë procedurale të ekzekutimit;

ç) i propozon ministrit emërimin dhe shkarkimin e kryetarëve të zyrave përmbartimore;

d) emëron, liron dhe shkarkon punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit dhe të zyrave përmbartimore vendore;

dh) kontrollon dokumentimin e veprimtarisë përmbartimore;

e) organizon dhe kujdeset për trajnimin e përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë;

ë) ndjek zbatimin e etikës profesionale gjatë veprimtarisë përmbartimore;

f) përfaqëson Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror në marrëdhënie me të tretët;

g) mban dhe zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione shtetërore apo private për realizimin e veprimtarisë përmbartimore në përputhje me legjislacionin në fuqi;

gj) promovon Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror dhe veprimtarinë që kryhet prej tij, me qëllim përmirësimin e veprimtarisë përmbartimore dhe rritjen e besimit të publikut ndaj këtij shërbimi;

h) ushtron përgjegjësi të tjera të përcaktuara me ligj ose me akte nënligjore.

Neni 9

Organizimi i zyrave përmbartimore vendore

1. Zyrat përmbartimore vendore përbëhen nga:

- a) kryetari i zyrës përmbartimore;
- b) përmbartuesit gjyqësorë shtetërorë;
- c) personeli administrativ dhe teknik.

2. Çdo zyrë përmbartimore vendore është person juridik dhe ka vulën e saj.

3. Marrëdhëniet e punës të personelit administrativ dhe teknik rregullohen nga Kodi i Punës.

Neni 10

Kryetari i zyrës përmbartimore

1. Kryetar i zyrës përmbartimore zgjidhet përmbartuesi gjyqësor shtetëror, që plotëson kriteret e mëposhtme:

a) të ketë përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi brenda vendit, me diplomë “Master i shkencave” ose “Master profesional”, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike apo të barasvlershme me to, ose të ketë përfunduar studimet universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

b) të ketë të paktën pesë vjet përvojë pune si përmbartues gjyqësor shtetëror;

c) të mos ketë masë disiplinore në fuqi dhe ndaj tij të mos ketë filluar procedimi disiplinor;

ç) të jetë vlerësuar “shkëlqyeshëm” në dy vlerësimet e fundit etike dhe profesionale, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

d) të ketë aftësi organizative dhe drejtuese;

dh) të ketë aftësi komunikimi;

e) të ketë integritet të lartë moral dhe profesional.

2. Kryetari i zyrës përmbartimore emërohet dhe shkarkohet nga detyra nga ministri, me propozim të drejtorit të përgjithshëm të Përmbartimit. Në rast mungese, paafësie afatshkurtër për ushtrimin e detyrave ose vakance, drejtori i përgjithshëm i Përmbartimit cakton përkohësisht një prej përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë që ka vjetërsi më të madhe pune në shërbimin përmbartimor gjyqësor për kryerjen e detyrave të kryetarit të zyrës përmbartimore.

3. Në rast se pas shqyrtimit të dokumentacionit justifikues për përmbushjen e kriterëve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, rezulton më shumë se një kandidat potencial që plotëson këto kriterë, drejtori i përgjithshëm i Përmbartimit i propozon ministrit kandidatin që ka më shumë vjetërsi pune si përmbartues gjyqësor shtetëror.

Neni 11

Organika

1. Numri i përgjithshëm i përmbartuesve gjyqësorë të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror caktohet me urdhër të ministrit, pasi të



ketë marrë mendimin me shkrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit.

2. Struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit, si dhe e zyrave përmbarrimore vendore miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore duke mbajtur në konsideratë, por pa u kufizuar, organizimin e rretheve gjyqësore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 12

Këshilli i Përmbarrimit

1. Këshilli i Përmbarrimit përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë:

- a) Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë;
- b) drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit;
- c) një këshilltar i ministrit;

ç) drejtori i përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë që mbikëqyr veprimtarinë e përmbarrimit shtetëror;

d) një anëtar që zgjidhet nga drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit nga radhët e përmbarruesve gjyqësorë shtetërorë.

2. Kandidati i zgjedhur sipas pikës 1, shkronja “d”, të këtij neni duhet të ketë jo më pak se 5 vjet përvojë profesionale si përmbarrues gjyqësor. Zgjedhja e këtij anëtar bëhet përmes shortit dhe duhet të synojë shmangien e konfliktit të interesit.

3. Këshilli i Përmbarrimit mbështetet administrativisht nga Ministria e Drejtësisë.

4. Rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Përmbarrimit përcaktohen me urdhër të ministrit.

5. Masa e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Përmbarrimit caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas rregullave të përcaktuara për shpërblimin e anëtarëve të organeve kolegjiale.

Neni 13

Burimet financiare

1. Për realizimin e detyrave, Shërbimi Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror ka buxhetin e vet, si pjesë e veçantë brenda buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë.

2. Shërbimi Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror ka të drejtë të përdorë të ardhura të tjera të krijuara nga veprimtaria përmbarrimore, që lejohen me ligj.

Neni 14

Sigurimi i të ardhurave nga veprimtaria përmbarrimore

1. Çdo veprim përmbarrimor kryhet kundrejt pagimit të tarifave përkatëse, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Ndarja e të ardhurave, kriteret e procedurat e administrimit dhe të shpërndarjes së të ardhurave përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit dhe ministrit përgjegjës për financat.

KREU III

EMËRIMI I PËRMBARRUESIT GJYQËSOR SHTETËROR

Neni 15

Organi emërues

1. Ministri është autoriteti shtetëror përgjegjës, i cili emëron përmbarruesit gjyqësorë shtetërorë për ushtrimin e veprimtarisë përmbarrimore në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë ligj.

2. Asnjë shtetas nuk mund të ushtrojë funksionin e përmbarruesit gjyqësor shtetëror pa u pajisur më parë me aktin e emërimit si përmbarrues gjyqësor shtetëror, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 16

Kushtet për emërimin e përmbarruesit gjyqësor shtetëror

Shtetasi, që kërkon të emërohet si përmbarrues gjyqësor shtetëror, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- c) të ketë përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi brenda vendit ose diplomë të njësuar me të, ose të ketë përfunduar studimet universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;
- ç) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor penal të formës së prerë;



d) të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose funksionit publik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë;

dh) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

e) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë profesionale si jurist;

ë) të ketë integritet moral të lartë;

f) të ketë kaluar me sukses provimin e pranimit për përmbarues gjyqësor shtetëror.

Neni 17

Pranimi në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror

1. Pranimi në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror bëhet nëpërmjet konkursit të hapur, i cili organizohet nga Këshilli i Përmbarimit.

2. Procesi i përzgjedhjes përfshin provimin e pranimit, që planifikohet për zhvillim bazuar mbi kërkesat dhe nevojat publike për numrin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 11 të këtij ligji.

3. Të gjithë individët që përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 16 të këtij ligji, kanë të drejtë t'i nënshtrohen provimit të pranimit për përmbarues gjyqësor shtetëror.

4. Provimi i pranimit përbëhet nga pjesa e kontrollit të njohurive me shkrim dhe pjesa e provimit me gojë, ku pjesa e provimit me shkrim përmban 75% të numrit total të pikëve.

5. Rregulla të hollësishme për organizimin, zhvillimin, përmbajtjen e provimit të pranimit, si dhe procedurën e vlerësimit dhe shpalljes së rezultateve përcaktohen me urdhër të ministrit.

Neni 18

Periudha e provës

1. Kandidatët fitues i nënshtrohen një periudhe prove që zgjat 6 (gjashtë) muaj nga data e aktit të emërimit të ministrit.

2. Gjatë periudhës së provës, përmbaruesi gjyqësor shtetëror kryen detyrat nën kujdesin e një përmbaruesi të vjetër në detyrë dhe i nënshtrohet trajnimit të detyrueshëm.

3. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror gjatë periudhës së provës gëzon të drejtat dhe detyrimet e përmbaruesit gjyqësor shtetëror, të përcaktuara në këtë ligj dhe në akte të tjera.

4. Në fund të periudhës së provës, ministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit, vendos:

a) emërimin përfundimtar si përmbarues gjyqësor; ose

b) largimin nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.

5. Vendimarrja, sipas pikës 4 të këtij neni, bazohet në çdo rast në vlerësimin e rezultateve në punë nga përmbaruesi gjyqësor mbikëqyrës dhe në rezultatin e testimit në përfundim të ciklit të trajnimit.

Neni 19

Programi i detyrueshëm i trajnimit

1. Programi i detyrueshëm i trajnimit për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove zhvillohet për një kohëzgjatje prej jo më pak se 200 orësh në 6 muaj dhe ka si qëllim aftësimin e tyre me njohuritë e duhura profesionale për ushtrimin e veprimtarisë përmbarimore.

2. Programi i detyrueshëm i trajnimit realizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit ose nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike apo nga institucione të arsimit të lartë të akredituara sipas ligjit.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me institucione të interesuara apo me organet drejtuese të dhomave të profesioneve të lira për organizimin e programeve të përbashkëta të trajnimeve ose për trajnime specifike.

4. Organizimi dhe përmbajtja e programit të trajnimit, rregullat për pjesëmarrjen në trajnime, si dhe për testimin e njohurive të përfituara përcaktohen me urdhër të ministrit.

KREU IV

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PËRMBARUESVE GJYQËSORË SHTETËRORË

Neni 20

Të drejtat e përmbaruesit gjyqësor shtetëror

Përmbaruesi gjyqësor shtetëror ka të drejtat e mëposhtme:

a) të marrë lirisht masat për ekzekutimin e çështjeve apo kryerjen e veprimtarive dytësore të



ngarkuara në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera ligjore, me përjashtim të rastit kur konstaton se është në situatën e konfliktit të interesit;

b) të kërkojë, kur e konsideron të nevojshme për veprimtarinë e tij procedurale, çdo informacion që ka të bëjë me gjendjen pasurore të debitorit apo vendndodhjen e tij, të nevojshëm për procedurat e ekzekutimit, nga institucione shtetërore, persona juridikë apo fizikë, në përputhje me ligjin;

c) të kërkojë mbështetjen dhe ndihmën e institucioneve shtetërore dhe subjekteve të tjera, kur e çmon të domosdoshme, gjatë procedurave të ekzekutimit;

ç) t'i sigurohet mbrojtja e integritetit fizik, moral dhe dinjitetit;

d) të përfitojë pagë dhe përfitime të tjera sipas përcaktimeve të këtij ligji;

dh) të anëtarësohet në sindikata apo shoqata profesionale;

e) të përmirësojë aftësitë profesionale nëpërmjet programit të formimit vazhdues;

ë) të përfitojë trajtim shëndetësor dhe sigurime shëndetësore në përputhje me legjislacionin në fuqi;

f) çdo të drejtë tjetër që i garantohet nga ky ligj dhe akte të tjera në fuqi.

Neni 21

Detyrat e përbaruesit gjyqësor shtetëror

Përbaruesi gjyqësor shtetëror ka këto detyra:

a) të veprojë me ndershmëri, paanësi, profesionalizëm dhe kurdohërë në interes të palës kreditore, pa cenuar në mënyrë të paligjshme të drejtat dhe interesat e palës tjetër;

b) të zbatojë me përpikëri dispozitat e këtij ligji, Kodit të Procedurës Civile, Kodit Civil dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, që lidhen me veprimtarinë përbarimore, si dhe urdhrat, udhëzimet e metodikat e drejtorit të përgjithshëm të Përbarimit;

c) të kryejë për subjektet fizike ose juridike veprimet e nevojshme, që synojnë realizimin e së drejtës së tyre dhe mbrojtjen e interesave të tyre të ligjshëm;

ç) të informojë për çdo veprim procedural palët në proces ekzekutimi, si dhe të japë sqarimet e nevojshme për veprimet e kryera;

d) të këshillojë palën kreditore për pasojat juridike që rrjedhin nga veprimet procedurale, me qëllim që të mos dëmtohen interesat e tyre;

dh) të ruajë sekretin profesional dhe të mos zbulojë të dhëna që i ka mësuar gjatë veprimtarisë së tij profesionale ose nga dokumentet, që i janë vënë në dispozicion nga palët në proces ekzekutimi, përveç kur dhënia e këtij informacioni është detyrim ligjor;

e) të marrë çdo masë të arsyeshme për t'u përditësuar me ndryshimet legjislative dhe praktikën gjyqësore mbi veprimtarinë përbarimore;

ë) të ndjekë trajnimet e programit të formimit vazhdues për përmirësimin e aftësive profesionale;

f) të marrë masat dhe veprimet e nevojshme për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, në respekt të dinjitetit njerëzor, duke vënë në bilanci nevojat e debitorëve dhe interesat e kreditorëve;

g) të respektojë dhe të zbatojë rregullat e etikës dhe standardet profesionale në ushtrimin e detyrës, duke garantuar ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut të shërbimi përbarimor gjyqësor shtetëror;

gj) të mbajë të ekspozuar në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit si përbarues gjyqësor shtetëror kur kryen veprime procedurale përbarimore, si dhe kur paraqitet përpara palëve të interesuara në lidhje me një procedurë përbarimore.

Neni 22

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

1. Përbaruesit gjyqësorë shtetërorë ndjekin programin e formimit vazhdues, i cili ka për qëllim përditësimin e njohurive dhe zhvillimin e kompetencave të tyre.

2. Programi i formimit vazhdues përcakton objektivat, modulet e trajnimit, organizimin e trajnimeve dhe kohëzgjatjen e tyre, rregullat e frekuentimit, mënyrën e kontrollit të njohurive dhe aftësive, si dhe rregulla të tjera të hollësishme për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të përbaruesve gjyqësorë shtetërorë.

3. Programi i formimit vazhdues miratohet me urdhër të ministrit.



Neni 23

Papajtueshmëritë me funksionin e përmbaruesit gjyqësor shtetëror

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror nuk mund të ushtrojë njëkohësisht funksione apo veprimtari publike dhe të kryejë veprimtari që vijnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji ose janë të papajtueshme me ushtrimin e detyrës së përmbaruesit gjyqësor shtetëror.

2. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër politike, shtetërore ose profesionale, që realizohet kundrejt pagesës, me përjashtim të veprimtarisë akademike ose shkencore.

3. Funksioni i përmbaruesit gjyqësor shtetëror është i papajtueshëm me:

a) anëtarësinë në parti politike dhe pjesëmarrjen në veprimtari politike të organizuara nga një parti politike;

b) kryerjen e çdo veprimtarie politike, pavarësisht nëse veprimtaria kryhet në bashkëpunim ose jo me ndonjë parti politike.

Neni 24

Konflikti i interesit

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror është i detyruar të mos pranojë ekzekutimin e çështjes ose të heqë dorë nga ekzekutimi, nëse ka filluar, nëse ai ka marrë dijeni ose duhet të kishte marrë dijeni për ekzistencën e një shkakut, që tregon një konflikt interesi, kur:

a) ka një interes në çështjen përkatëse ose në një çështje tjetër, që ka lidhje me atë në ekzekutim;

b) ai vetë ose bashkëshortja e tij është e afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërin nga palët në proces ekzekutimi ose me përfaqësuesit;

c) ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor a në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve në proces ekzekutimi ose njërin prej përfaqësuesve;

ç) është kujdestar, punëdhënës i njërit prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër, që ka interesa për çështjen në ekzekutim;

d) në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.

2. Mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga ekzekutimi i çështjes nga përmbaruesi gjyqësor, i cili ka dijeni ose duhet të kishte marrë dijeni për ekzistencën e konfliktit të interesit, konsiderohet shkelje disiplinore.

Neni 25

Heqja dorë nga ekzekutimi

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka arsye për të mos marrë pjesë në ekzekutimin e një çështjeje për shkak të konfliktit të interesit, i paraqet menjëherë kërkesën për heqje dorë nga ekzekutimi i çështjes kryetarit të zyrës përmbarimore.

2. Kryetari i zyrës përmbarimore, kur e vlerëson me vend kërkesën, urdhëron zëvendësimin e tij me një tjetër përmbarues gjyqësor të asaj zyre përmbarimore brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës. Për kryetarin e zyrës përmbarimore, zëvendësimi urdhërohet nga drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit.

3. Përmbajtja e kërkesës për heqje dorë nga ekzekutimi i çështjes dhe vendimi u njoftohet palëve në proces ekzekutimi.

Neni 26

Praktika të ndaluara

1. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, përmbaruesi gjyqësor shtetëror nuk duhet të kryejë veprime që cenojnë subjektet, që u nënshtrohen procedurave të ekzekutimit.

2. Ndalohet veçanërisht kryerja e veprimtarive të mëposhtme:

a) përdorimi i paligjshëm i forcës ndaj subjekteve fizike, që i nënshtrohen ekzekutimit të detyruar apo pasurisë së tyre;

b) kërcënimi fizik apo presioni psikologjik ndaj subjektit, palë në procedurë ekzekutimi;

c) përdorimi i fjalëve të pahijshme, që cenojnë reputacionin apo dinjitetin e subjekteve, që i nënshtrohen ekzekutimit të detyruar;

ç) angazhimi në ndonjë praktikë të ndaluar ose përdorimi i ndonjë metode të pandershme në mbledhjen e detyrimeve, në kundërshtim me dispozitat ligjore;



d) çdo veprim tjetër me karakter mashtrues, i cili do të komprometonte rëndë besimin e palëve dhe integritetin moral të përmbauesit gjyqësor;

dh) angazhimi i personave të tjerë të paemëruar për ushtrimin e veprimtarisë përmbaimore.

Neni 27

Konfidencialiteti

Përmbauesi gjyqësor shtetëror, i cili merr informacione gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, ruan konfidencialitetin e këtyre të dhënave dhe nuk duhet t'ua japë këto informacione të tretëve, përveç:

a) organeve të rendit publik, prokurorisë ose gjykatës;

b) Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaimit, vetëm për efekt të ushtrimit të kompetencave, sipas këtij ligji;

c) strukturave të tjera shtetërore lidhur me çështjet pasurore të debitorëve;

ç) përmbauesve të tjerë vetëm nëse informacioni është i nevojshëm për procedurat e ekzekutimit;

d) kreditorit, i cili ka depozituar për ekzekutim një titull ekzekutiv në rastet kur nuk është njohur rregullisht me këtë informacion;

dh) kur personi për të cilin kërkohet informacioni jep pëlqimin.

Neni 28

Dokumenti i identifikimit

1. Përmbauesi gjyqësor shtetëror ka dokument identifikues si përmbaues gjyqësor shtetëror, të cilin e paraqet në çdo rast të ushtrimit të detyrës.

2. Dokumenti përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj.

3. Dokumenti i identifikimit përmban:

a) emrin, mbiemrin e përmbauesit gjyqësor shtetëror;

b) stemën e Republikës së Shqipërisë dhe logon e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaimit;

c) zyrën përmbaimore vendore ku do të ushtrojë veprimtarinë përmbauesi gjyqësor shtetëror.

4. Forma e dokumentit të identifikimit përcaktohet me urdhër të ministrit.

Neni 29

Mbrojtja e veçantë e përmbauesit gjyqësor shtetëror

1. Kur përmbauesi gjyqësor shtetëror gjatë ushtrimit të detyrës së tij ose për shkak të saj i rrezikohet jeta, shëndeti, familja apo prona, shteti i garanton mbrojtje të veçantë.

2. Kushtet dhe mënyra e përfitimit të kësaj mbrojtjeje përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 30

Dorëzimi i dokumentacionit pas largimit nga detyra

1. Kur përmbauesi gjyqësor shtetëror largohet nga detyra sipas rasteve të parashikuara në këtë ligj dhe ka në proces ekzekutimi çështje përmbaimore të papërfunduara, kryetari i zyrës përmbaimore cakton përmbauesin gjyqësor shtetëror zëvendësues.

2. Rregulla të hollësishme për procedurën dhe afatet e dorëzimit të dokumentacionit nga përmbauesi gjyqësor shtetëror përcaktohen me udhëzim të ministrit.

KREU V

TRAJTIMI FINANCIAR I PËRMBARUESIT GJYQËSOR SHTETËROR

Neni 31

Paga e përmbauesit gjyqësor shtetëror

1. Paga e përmbauesit gjyqësor shtetëror duhet të jetë në përputhje me natyrën e përgjegjësisë së detyrës së përmbauesit dhe e përshtatshme për të garantuar pavarësinë dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e jashtme në ushtrim të funksionit të tyre.

2. Paga e përmbauesve gjyqësorë shtetërorë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Në çdo rast, paga e përmbauesve gjyqësorë shtetërorë nuk mund të jetë më e ulët se paga mujore e drejtorit të drejtorisë në ministri.

3. Përmbauesi gjyqësor shtetëror, në varësi të rezultateve në punë, mund të përfitojë një shpërblim, i cili përballohet nga të ardhurat që i mbeten Shërbimit Përmbaimit Gjyqësor Shtetëror, në përputhje me nenin 14 të këtij ligji.



Shpërblimi i posaçëm caktohet në çdo rast me urdhër të ministrit.

Neni 32

Përfitime të tjera

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror gëzon të drejtën e pushimeve vjetore të paguar prej 4 (katër) javësh kalendarike. Si rregull, pushimi vjetor përfshin një periudhë prej tre javësh, pa ndërprerje në muajt korrik dhe gusht. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror, i ngarkuar me detyra të ngutshme në këtë periudhë, pushimin vjetor e kryen në një periudhë tjetër, duke përfituar 5 (pesë) ditë pushimi shtesë.

2. Pushimi vjetor jepet nga kryetari i zyrës përmbarimore.

3. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror ka të drejtë që në raste të veçanta, për nevoja personale ose familjare, të kërkojë leje pa të drejtë page. Kohëzgjatja e kësaj leje përcaktohet nga kryetari i zyrës përmbarimore. Kohëzgjatja maksimale e lejeve të papaguara brenda një viti kalendarik nuk mund të jetë më e gjatë se 30 ditë.

4. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të kërkojë leje të papaguar deri në 2 (dy) vjet për arsye shëndetësore, familjare ose për qëllime kualifikimi apo specializimi profesional. Leja e papaguar mund të merret e gjitha njëherësh ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së përmbaruesit.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit mund të japë lejen e papaguar sipas pikës 4, pasi ka marrë mendimin e kryetarit të zyrës përmbarimore, nëse leja nuk cenon interesat e funksionit dhe nuk vë në rrezik në tërësi përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë në zyrën përmbarimore. Periudha e lejes së papaguar nuk merret në konsideratë për vjetërsinë në punë ose për efekt të përfitimeve të tjera.

6. Ministri miraton rregulla më të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar, sipas këtij neni.

Neni 33

Koha e punës

1. Kohëzgjatja javore e punës dhe orari, si rregull, janë të njëjta me ato të institucioneve të administratës shtetërore.

2. Për nevoja pune, me kërkesë të eprioritetit të drejtpërdrejtë dhe me urdhër të kryetarit të zyrës

përmbarimore përkatëse, përmbaruesi gjyqësor shtetëror është i detyruar të punojë edhe jashtë orarit të punës në ditët e pushimit ose në ditët e festave zyrtare, brenda kufijve të përcaktuar në Kodin e Punës. Në këto raste zbatohen rregullat për kompensimin e orëve shtesë, sipas legjislacionit në fuqi për orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore.

KREU VI

TARIFAT

Neni 34

Tarifat fikse të veprimeve përmbarimore

1. Për fillimin e procedurave të ekzekutimit dhe kryerjen e veprimeve procedurale nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, paguhet tarifa fikse.

2. Masa e tarifës fikse caktohet duke mbajtur në konsideratë vlerën dhe llojin e detyrimit, si dhe kompleksitetin e veprimit procedural përmbarimor.

3. Masa e tarifës fikse të veprimit përmbarimor, llojet e veprimeve përmbarimore të tarifuara dhe rastet e përjashtimit nga parapagimi i tarifës për kategori të caktuara përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe ministrit përgjegjës për financat.

Neni 35

Tarifa e suksesit

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror përfiton një tarifë suksesi, e cila mund të jetë në formën e një shume të caktuar, një përqindje e caktuar mbi vlerën e detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar apo nëpërmjet kombinimit të të dyjave mbi vlerën e detyrimit të ekzekutuar. Masa e tarifës së suksesit caktohet në marrëveshjen mes kreditorit dhe përmbaruesit gjyqësor shtetëror.

2. Ministri dhe ministri përgjegjës për financat përcaktojnë me udhëzim të përbashkët nivelin minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbarimore. Tarifa e suksesit nuk parapaguhet dhe nuk i ngarkohet debitorit.

3. Marrëveshja tip për mbledhjen e tarifës së suksesit nga Shërbimi Përmbarimor Shtetëror miratohet me urdhër të ministrit.



Neni 36

Tarifat e veprimtarive dytësore

Tarifat për veprimtaritë dytësore të përmbaruesit gjyqësor shtetëror, të parashikuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 37

Rastet e pakthyeshmërisë së tarifës

1. Në rastet e ekzekutimeve të pasuksesshme, kur nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror janë kryer në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme të gjitha veprimet procedurale, tarifat fikse janë të pakthyeshme.

2. Kur pala kreditore ka paguar tarifën fikse të fillimit të procedurës përmbarimore dhe detyrimi përmbushet në mënyrë vullnetare nga pala debitor brenda afateve ligjore, tarifa fikse e fillimit të procedurës është e pakthyeshme.

KREU VII

MARRËDHËNIET ME PALËT NË PROCES EKZEKUTIMI DHE ME TË TRETËT

Neni 38

Marrëdhëniet me palën kreditore

Pala kreditore ka të drejtë të kërkojë nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror çdo informacion lidhur me veprimet procedurale dhe ecurinë e procesit të ekzekutimit.

Neni 39

Marrëdhëniet me palën debitorë dhe personin e tretë

1. Pala debitorë, personat e barazuar me të ose personi i tretë detyrohet të lejojë përmbaruesin gjyqësor shtetëror të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për ekzekutimin e detyrueshëm, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.

2. Debitori me fillimin e veprimeve procedurale, pas kërkesës së përmbaruesit gjyqësor shtetëror, deklaron pasuritë e tij dhe saktësinë e të dhënave të tyre. Ndaj debitorit që fsheh, nuk jep apo i jep në mënyrë fiktive të dhënat mbi pasuritë e tij përmbaruesit gjyqësor shtetëror, zbatohen sanksionet e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

3. Pala debitorë, personat e barazuar me të ose personi i tretë ka të drejtë të kundërshtojë veprimet e përmbaruesit gjyqësor shtetëror në gjykatë, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 40

Përgjegjësitë ndaj palëve në proces ekzekutimi dhe të tretëve

Përmbaruesi gjyqësor shtetëror, që kryen veprimtarinë përmbarimore në kundërshtim me ligjin, mban përgjegjësi vetjake për dëmin që u shkakton palëve në proces ekzekutimi, si dhe për dëmin ndaj të tretëve.

Neni 41

Marrëdhëniet me të tretët

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror ka të drejtë të kërkojë informacionin e nevojshëm për procedurat e ekzekutimit nga organet publike, entet publike ose nga personat juridikë dhe fizikë që zotërojnë informacionin përkatës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Informacioni i kërkuar i jepet përmbaruesit gjyqësor shtetëror brenda pesë ditëve pune nga marrja e kërkesës zyrtare dhe jo më vonë se dy ditë pune kur informacioni kërket nëpërmjet komunikimit me postë elektronike, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

3. Ndaj personave fizikë ose juridikë, që paraqesin pengesë gjatë procedurave të ekzekutimit ose fshehin, deklarojnë apo japin të dhëna të pasakta në lidhje me prona, të ardhura, të drejta mbi pasuritë e debitorit, të kërkuara nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror, kur këto veprime përbëjnë vepër penale në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal, përmbaruesi gjyqësor shtetëror bën kallëzim penal.

4. Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë me objekt “Takim dhe kujdestari fëmijë”, përmbaruesi gjyqësor shtetëror njofton njësinë për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki dhe kërkon asistencën e një psikologu.

5. Të dhënat e marra në përputhje me këtë nen trajtohen në përputhje me detyrimin e konfidencialitetit dhe sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.



Neni 42

Bashkëpunimi me organet e tjera

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror për kryerjen e detyrave të ngarkuara bashkëpunon me Policinë e Shtetit, policitë e tjera, Inspektoratën Kombëtare të Mbrojtjes së Territorit, njësitë e qeverisjes vendore, si dhe prefektin e qarkut.

2. Organet publike janë të detyruara të mbështesin dhe ndihmojnë përmbaruesin gjyqësor shtetëror sa herë që kërkohet ndihma e tyre, kur çmohet nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror se veprimet procedurale përmbarimore nuk mund të kryhen pa mbështetjen, ndihmën apo prezencën e tyre.

3. Rregulla të hollësishme për kriteret, procedurën dhe mënyrën e bashkëpunimit dhe mbështetjes së përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe ministrave përgjegjës, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

KREU VIII

KOMANDIMI DHE TRANSFERIMI

Neni 43

Komandimi

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të komandohet si inspektor në strukturën përgjegjëse për inspektimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit për një periudhë jo më shumë se 1 (një) vit. Pas mbarimit të periudhës 1-vjeçare, përmbaruesi gjyqësor shtetëror ka të drejtën e rikomandimit në pozicionin e inspektorit.

2. Komandimi bëhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit, pasi të ketë marrë pëlqimin e përmbaruesit gjyqësor shtetëror.

3. Përvoja e përmbaruesit gjyqësor shtetëror, të komanduar nga zyra përmbarimore vendore përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit, llogaritet përvojë pune në profesion.

4. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror gjatë komandimit ka përgjegjësi disiplinore sipas përcaktimeve që zbatohen për nëpunësit e tjerë, që kanë të njëjtin pozicion në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit.

5. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror i komanduar merr pagën më të lartë ndërmjet pagës së pozicionit

të mëparshëm dhe atij në të cilin është komanduar, si dhe shtesë në masën 1% për çdo ditë pune.

6. Rregulla të hollësishme për procedurën e komandimit, sipas këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 44

Transferimi i përkohshëm

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të transferohet përkohësisht në një zyrë tjetër përmbarimore për nevoja të punës dhe në interes të shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.

2. Transferimi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet në zyrën përmbarimore vendore më të afërt me zyrën e përmbaruesit gjyqësor shtetëror, jo më shumë se 2 herë në vit, me kohëzgjatje deri në 3 muaj secila. Në përfundim të periudhës së transferimit, përmbaruesi gjyqësor shtetëror rikthehet në zyrën përmbarimore ku është emëruar.

3. Për nevoja të punës, përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të transferohet në zyrën përmbarimore më të afërt me të për ekzekutimin e dosjeve përmbarimore të caktuara.

4. Transferimi në një zyrë tjetër përmbarimore, sipas pikave 1 dhe 3 të këtij neni, bëhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit.

5. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të refuzojë transferimin, sipas pikës 1 të këtij neni, në rastin kur gjendja shëndetësore e tij, provuar me vërtetimin mjekësor përkatës, e bën transferimin e pamundur.

6. Rregulla të hollësishme për transferimin e përkohshëm, sipas këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 45

Transferimi i përhershëm

1. Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i përmbaruesit gjyqësor në një zyrë tjetër përmbarimore vendore, në rastet e:

a) shmangies së konflikteve të vazhdueshme të interesit;

b) mbylljes ose ristrukturimit të zyrës përmbarimore, ku përmbaruesi gjyqësor ushtron funksionin e tij.

2. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të refuzojë transferimin në rastet kur:



a) gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur;

b) zyra përbarimore vendore ku transferohet gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i përbaruesit gjyqësor shtetëror. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera përbën shkak për largim nga detyra.

3. Transferimi i përhershëm i përbaruesit gjyqësor shtetëror bëhet me urdhër të ministrit, me propozim të drejtorit të përgjithshëm të Përbarimit.

4. Rregulla të hollësishme për transferimin e përhershëm, sipas këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

KREU IX

VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL I PËRMBARUESIT GJYQËSOR SHTETËROR

Neni 46

Parimet e vlerësimit

Vlerësimi etik dhe profesional bazohet në parimet e mëposhtme:

a) parimi i paanshmërisë, sipas së cilit procesi i vlerësimit nuk duhet të ndikojë apo të ndërhyjë në paanësinë e përbaruesit gjyqësor shtetëror;

b) parimi i meritokracisë, sipas të cilit vlerësimi i veprimtarisë së përbaruesit gjyqësor shtetëror bëhet duke i dhënë rëndësinë më të madhe vlerave profesionale dhe cilësisë në punë;

c) parimi i efikasitetit, sipas të cilit vlerësimi i veprimtarisë përbarimore bëhet nëpërmjet një procesi në afate kohore të arsyeshme, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

ç) parimi i konfidencialitetit, sipas të cilit subjektet e ngarkuara me detyrën e vlerësimit janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të përbaruesit gjyqësor shtetëror që vlerësohet, si dhe të dhënat personale, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 47

Qëllimi i vlerësimit të përbaruesit gjyqësor shtetëror

Qëllimi i vlerësimit etik dhe profesional të përbaruesve gjyqësorë shtetërorë është:

a) të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme etikën dhe aftësitë profesionale të përbaruesve;

b) të vendosë standarde të qëndrueshme për cilësinë e veprimtarisë së përbaruesve;

c) të informojë Drejtorinë e Përgjithshme të Përbarimit në lidhje me nevojat për trajnim të përbaruesve dhe për të lehtësuar planifikimin e trajnimit të tyre;

ç) të identifikojë përbaruesit që mund të kenë aftësi të veçanta profesionale për sistemin e përbarimit gjyqësor;

d) të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të punës së përbaruesve.

Neni 48

Subjektet e vlerësimit

1. Të gjithë përbaruesit gjyqësorë shtetërorë, përfshirë kryetarët e zyrave përbarimore, i nënshtrohen vlerësimit etik dhe profesional në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë ligj.

2. Kryetarët vlerësohen gjithashtu edhe për veprimtarinë e tyre si kryetar zyre përbarimore.

Neni 49

Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi kryhet sipas kriterëve të mëposhtme:

a) aftësisë profesionale të përbaruesit;

b) aftësisë organizative;

c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të përbaruesit;

ç) aftësisë personale dhe angazhimit profesional.

Neni 50

Aftësitë profesionale të përbaruesit

1. Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të përbaruesit vlerësohet aftësia profesionale e tij në drejtim të njohurive profesionale, teorike dhe praktike në fushën e ekzekutimit të detyruar përbarimor, njoftimit të akteve gjyqësore dhe dokumenteve zyrtare, shitjes së sendeve në ankand publik, si dhe konstatimit të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike sipas legjislacionit në fuqi.

2. Aspekti i njohurive, sipas pikës 1 të këtij neni, vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e përbaruesit për të ekzekutuar tituj ekzekutivë dhe për të kryer veprimtari dytësore, sipas përcaktimeve të këtij ligji, duke u bazuar në tregues të tillë, si:



aftësia e përgjithshme për të kryer aktet dhe veprimet procedurale në përputhje me legjislacionin për ekzekutimin e detyrueshëm, për të bashkëpunuar me institucionet shtetërore apo me çdo subjekt tjetër sikurse parashikohet nga ligji për kryerjen e procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm, aftësia për të shitur sendin në ankandin e parë, aftësia për kryerjen e veprimeve ligjore të nevojshme, si dhe për konstatimin e realitetit në procesverbalin e mbajtur për konstatimin e fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme.

Neni 51

Aftësitë organizative

1. Me anë të kriterit të aftësisë organizative vlerësohet aftësia e përmbaruesit për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të kryer procedurat përmbarimore, si dhe aftësia për të administruar dosjet përmbarimore duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga përmbaruesi dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit.

2. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo dosjeje, në rendimentin e përfundimit të çështjeve përmbarimore dhe kohën mesatare për ekzekutimin e detyrueshëm të një titulli ekzekutiv, kryerjen e njoftimit të akteve gjyqësore dhe dokumenteve zyrtare, shitjes së sendeve në ankand publik dhe konstatimit të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike sipas legjislacionit në fuqi.

3. Aftësia e përmbaruesit për të kryer në mënyrë të efektshme procedurat përmbarimore matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale brenda afatit kohor të përcaktuar për ekzekutimin e dosjeve përmbarimore.

4. Aftësia për të administruar dosjet përmbarimore matet duke u bazuar në treguesit e rregullshmërisë, plotësisë dhe saktësisë së dokumentacionit të dosjes.

Neni 52

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

1. Me anë të kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale vlerësohet aftësia e përmbaruesit për etikën në punë dhe paanësinë.

2. Etika në punë e përmbaruesit në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion matet duke u bazuar në treguesit e dalë nga burimet e vlerësimit, të tilla si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, si dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore.

3. Paanësia e përmbaruesit në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit matet duke u bazuar në tregues të tillë, si: numri i kërkesave për mospranimin e ekzekutimit dhe heqje dorë nga ekzekutimi i dosjeve përmbarimore që i janë ngarkuar.

Neni 53

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

1. Me anë të kriterit të aftësisë personale dhe angazhimit profesional vlerësohen aftësitë e komunikimit, aftësia për të bashkëpunuar me kolegët dhe gatishmëria për punë në grup, si dhe aftësia për t'u angazhuar në trajnime profesionale.

2. Aftësia e komunikimit të përmbaruesit matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit të qartë dhe transparent me palët, subjektet e tjera, të tretët, në respektim edhe të parimit të konfidencialitetit. Vlerësimi i aftësive drejtuese si kryetar i zyrës përmbarimore me të paktën “shumë mirë” ka përparësi në vlerësimin si përmbarues, i cili kryhet pas vlerësimit si kryetar i zyrës përmbarimore.

3. Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët dhe gatishmëria në grup matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit dhe bashkëveprimit me kolegët apo stafin administrativ të zyrës përmbarimore, si dhe shkëmbimit të njohurive apo të përvojës profesionale me ta.

4. Gatishmëria për t'u angazhuar në trajnime profesionale matet duke u bazuar në tregues të tillë, si: pjesëmarrja e përmbaruesit në trajnimet vazhduese, pjesëmarrja në trajnime të tjera profesionale, pjesëmarrja në veprimtari ndërinstitucionale dhe publikimet akademike.



Neni 54

Burimet e vlerësimit

Vlerësimi i përmbarduesve gjyqësorë bazohet në këto burime:

- a) të dhënat statistikore për veprimtarinë e ekzekutimit të titujve ekzekutivë;
- b) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj përmbarduesit;
- c) informacioni nga institucioni trajnues, që vërteton pjesëmarrjen dhe ecurinë e përmbarduesit në formimin vazhdues apo në veprimtaritë të tjera trajnuese;
- ç) vendimet përfundimtare për masat disiplinore, që janë dhënë ndaj përmbarduesit, dhe nëse masat disiplinore janë shuar ose jo;
- d) kundërshtimet e përmbarduesit;
- dh) mendimi i kryetarit të zyrës përmbardimore;
- e) qëndrimet e gjykatës lidhur me ankimet e palëve për kundërshtimin e veprimeve të kryera nga përmbarduesi gjyqësor shtetëror;
- ë) raportet e inspektimit për veprimtarinë procedurale, administrative dhe financiare të përmbarduesit gjyqësor shtetëror;
- f) çdo të dhënë tjetër, që tregon aftësitë e kualifikimit profesional të përmbarduesit.

Neni 55

Nivelet e vlerësimit

1. Vlerësimi i përmbarduesit gjyqësor shtetëror kryhet, sipas këtyre niveleve:

- a) “Shkëlqyeshëm” në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi shumë të larta;
- b) “Shumë mirë” në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mbi mesataren;
- c) “Mirë” në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mesatare;
- ç) “Mjaftueshëm” në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi nën mesataren;
- d) “I pamjaftueshëm” në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi të dobët.

2. Vlerësimi i përgjithshëm “Shkëlqyeshëm” jepet në ato raste kur përmbarduesi është vlerësuar “Shkëlqyeshëm” për të katërta kriteret.

3. Vlerësimi i përgjithshëm “Shumë mirë” jepet vetëm në ato raste kur përmbarduesi vlerësohet “Shumë mirë” për tri kriteret dhe “mirë” për njërin prej tyre. Në çdo rast, kriteret “Aftësitë profesionale” dhe “Etika dhe angazhimi ndaj

vlerave profesionale” duhet të jenë vlerësuar “Shumë mirë”.

4. Vlerësimi i përgjithshëm “Mirë” jepet në rastin kur aftësitë e përmbarduesit vlerësohen “Mirë” për dy kriteret dhe “Mjaftueshëm” për dy kriteret e tjera. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur ka barazi në vlerësimin e kriterëve në nivelet “Mjaftueshëm” dhe “I pamjaftueshëm”.

5. Vlerësimi i përgjithshëm “I pamjaftueshëm” jepet në këto raste, kur:

- a) përmbarduesi vlerësohet “I pamjaftueshëm” për të paktën në tri kriteret;
- b) përmbarduesi vlerësohet “I pamjaftueshëm” për kriteret “Aftësitë profesionale” dhe “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” dhe jo më shumë se “Mirë” për dy kriteret e tjera.

Neni 56

Kriteret për vlerësimin e veprimtarisë së kryetarit të zyrës përmbardimore

Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit të një zyre përmbardimore kryhet bazuar në këto kriteret:

- a) aftësisë drejtuese dhe organizative;
- b) aftësisë së komunikimit.

Neni 57

Aftësitë drejtuese dhe organizative

1. Me anë të kriterit të aftësive drejtuese dhe organizative vlerësohen aftësitë e kryetarit të zyrës përmbardimore për organizimin e qartë të veprimtarive administrative nëpërmjet dhënies së vendimeve dhe urdhrave për të siguruar respektimin e afateve dhe përdorimin sa më të mirë të burimeve të disponueshme, si dhe transparencën në zyrë.

2. Kriteri i aftësive drejtuese dhe organizative matet duke u bazuar në treguesit që kanë lidhje me mirorganizimin e punës dhe shpërndarjen e dosjeve përmbardimore në raport të drejtë me ngarkesën e përmbarduesve, komunikimin e prioritetëve, aftësinë për të përdorur me efektshmëri burimet financiare dhe njerëzore, zëvendësimin në kohë të përmbarduesve, që kanë pengesa për kryerjen e procedurës së ekzekutimit, krijimit të ambienteve të përshtatshme në zyrë, në përputhje me nevojat e palëve dhe zhvillimin e mbledhjeve me përmbarduesit.



3. Përfshirja e kryetarit të zyrës përmbartimore në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit përmbartimor ose në trajnime profesionale për drejtimin dhe organizimin e zyrave përmbartimore vlerësohet me përparësi në matjen e këtij kriteri.

Neni 58

Aftësitë komunikuese

1. Me anë të kriterit të aftësisë komunikuese vlerësohet aftësia e kryetarit të zyrës përmbartimore për komunikim të qartë, në kohë dhe transparent.

2. Ky kriter matet duke u bazuar në treguesit që kanë lidhje me bashkëpunimin efektiv dhe në kohë me Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit, Këshillin e Përmbartimit, njësitë e qeverisjes vendore, Policinë e Shtetit apo me çdo institucion ose subjekt tjetër, si dhe komunikimin me publikun dhe të tretët.

Neni 59

Burimet e vlerësimit për veprimtarinë e kryetarit të zyrës përmbartimore

Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit të zyrës përmbartimore bazohet në këto burime:

a) të dhëna statistikore për funksionimin e zyrës përmbartimore në 5 (pesë) vjetët e fundit;

b) vendimmarrjen e kryetarit të zyrës përmbartimore në zbatim të kompetencave drejtuese dhe menaxheriale;

c) raportet e inspektimit të zyrës përmbartimore nga institucionet shtetërore;

ç) çdo dokument, i cili tregon aftësitë e komunikimit të kryetarit të zyrës përmbartimore me publikun dhe të tretët;

d) të dhëna për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj kryetarit të zyrës përmbartimore në këtë cilësi;

dh) vendime përfundimtare për masa disiplinore për shkak të pozicionit të kryetarit të zyrës përmbartimore, pavarësisht nëse masa disiplinore është shuar ose jo;

e) kundërshtimet e kryetarit të zyrës përmbartimore;

ë) çdo burim tjetër që evidenton veprimtarinë profesionale të kryetarit të zyrës përmbartimore.

Neni 60

Nivelet e vlerësimit

1. Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit të zyrës përmbartimore kryhet sipas këtyre niveleve:

a) “Shumë mirë” në rastin e veprimtarisë drejtuese me cilësi mbi mesataren;

b) “Mirë” në rastin e veprimtarisë drejtuese me cilësi mesatare;

c) “Mjaftueshëm” në rastin e veprimtarisë drejtuese nën mesatare.

2. Vlerësimi i përgjithshëm “Shumë mirë” jepet nëse veprimtaria drejtuese e kryetarit të zyrës përmbartimore vlerësohet “Shumë mirë” në të dyja kriteret. Vlerësimi i përgjithshëm “Mjaftueshëm” jepet nëse veprimtaria drejtuese e kryetarit të zyrës përmbartimore vlerësohet “Mjaftueshëm” të paktën në një prej kriterëve. Në rastet e tjera veprimtaria drejtuese e kryetarit të zyrës përmbartimore vlerësohet “Mirë”.

Neni 61

Periudha e vlerësimit

1. Përmbartuesi gjyqësor shtetëror vlerësohet 1 herë në 2 vjet gjatë 15 viteve të para të përvojës profesionale.

2. Përmbartuesi gjyqësor shtetëror vlerësohet 1 herë në 5 vjet pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si përmbartues gjyqësor shtetëror.

3. Kryetari i zyrës përmbartimore vlerësohet të paktën 1 herë gjatë ushtrimit të detyrave si kryetar.

Neni 62

Procedura e vlerësimit

1. Këshilli i Përmbartimit, jo më vonë se muaji nëntor i çdo viti, miraton programin, që përcakton listën e përmbartuesve dhe kryetarëve të zyrave përmbartimore për të cilët do të kryhet vlerësimi përgjatë vitit pasardhës dhe periudhën e vlerësimit. Programi publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit.

2. Kryetarët e zyrave përmbartimore dhe përmbartuesit, të cilët do të vlerësohen sipas programit të miratuar, njoftohen në kohën e duhur nga Këshilli, por, në çdo rast, jo më vonë se 3 javë nga momenti i vlerësimit sipas përcaktimeve të kësaj dispozite.



3. Përmbaruesi kryen vlerësimin etik dhe profesional të tij sipas formularit standard të vendosur nga Këshilli i Përmbarimit brenda 3 (tre) javëve nga marrja e njoftimit, nëpërmjet të cilit përmbaruesi:

a) vlerëson detyrat e ushtruara përkundrejt kritereve vlerësuese;

b) paraqet një analizë të të dhënave statistikore që lidhen me veprimtarinë e tij si përmbarues;

c) përshkruan masat që ka ndërmarrë për përmbushjen e objektivave të përcaktuara në vlerësimin e mëparshëm;

ç) përshkruan shkallën, në të cilën janë përmbushur këto objektiva, duke dhënë edhe shpjegimin përkatës;

d) përshkruan objektivat për zhvillimin e tij profesional për vlerësimin e ardhshëm të tij;

dh) përshkruan nevojat për trajnim dhe, nëse ka, rrethanat të cilat përbëjnë pengesë për zhvillimin e tij profesional dhe propozon zgjidhje konkrete për periudhën e ardhshme të vlerësimit.

4. Përmbaruesi dorëzon formularin e plotësuar pranë kryetarit të zyrës përmbarimore.

5. Kryetari i zyrës përmbarimore jep mendimin për veprimtarinë e përmbaruesit në përputhje me standardet e vendosura nga Këshilli i Përmbarimit brenda 10 ditëve nga dorëzimi i formularit. Në mendimin e kryetarit të zyrës përmbarimore përshkruhet veprimtaria e përmbaruesit gjyqësor dhe vlerësimi i tij për këtë veprimtari, sipas kritereve të vlerësimit, duke u bazuar në nivelet e vlerësimit të parashikuara në këtë ligj. Gjithashtu, në mendimin e kryetarit të zyrës përmbarimore pasqyrohet një analizë e të dhënave statistikore të veprimtarisë së përmbaruesit.

6. Brenda tri ditëve nga njoftimi i mendimit të kryetarit të zyrës përmbarimore, përmbaruesi gëzon të drejtën për t'u dëgjuar dhe paraqet kërkesë për zhvillimin e një takimi me kryetarin e zyrës përmbarimore.

7. Kryetari i zyrës përmbarimore zhvillon takimin me përmbaruesin brenda dy javëve nga data e depozitimit të kërkesës dhe merr masat për pasqyrimin e takimit në procesverbal, i cili i bashkëlidhet mendimit të kryetarit të zyrës përmbarimore.

8. Jo më vonë se 5 ditë nga realizimi i takimit, kryetari i zyrës përmbarimore i dërgon Këshillit të Përmbarimit aktet e vlerësimit të përmbaruesit, ku përfshihen vlerësimi i kryer nga përmbaruesi,

mendimi përfundimtar i kryetarit të zyrës përmbarimore për veprimtarinë e përmbaruesit, kundërshtitë e mundshme të përmbaruesit ndaj mendimit të kryetarit të zyrës përmbarimore dhe procesverbalin e dëgjësës. Nëse është e nevojshme për qëllime të vlerësimit, Këshilli i Përmbarimit mund të kërkojë informacione shtesë nga kryetari i zyrës përmbarimore apo përmbaruesi gjyqësor shtetëror.

9. Brenda një muaji nga marrja e akteve të vlerësimit, sipas pikës 8 të këtij neni, Këshilli i Përmbarimit, pasi shqyrton dokumentacionin, merr vendimin për vlerësimin, të cilin ia njofton brenda 20 ditëve përmbaruesit dhe zyrës përmbarimore ku është i emëruar, Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit dhe ministrit.

10. Në rastet kur përmbaruesi vlerësohet “I pamjaftueshëm”, i ulet paga me 2% gjatë dy viteve kalendarike pas këtij vlerësimi.

11. Përmbaruesi, kur nuk është dakord me vendimin e Këshillit të Përmbarimit për vlerësimin e tij, ka të drejtë ta ankimojë në gjykatën administrative kompetente, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

KREU X

PEZULLIMI I PËRMBARUESIT GJYQËSOR SHTETËROR

Neni 63

Pezullimi

1. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të pezullohet përkohësisht nga detyra nga ministri, kur:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;

b) ndaj tij ka filluar një procedurë për heqjen e zotësisë juridike për të vepruar;

c) deklarohet i zhdukur me vendim të formës së prerë të gjykatës, deri në shfaqjen e personit apo deklarimit të vdekjes me vendim të formës së prerë të gjykatës;

ç) nëse ndodhet në gjendje konflikti interesi të vazhdueshëm, deri në transferimin e tij në një pozicion tjetër, sipas nenit 45 të këtij ligji;

d) nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror, ndaj të cilit ka filluar një procedim



disiplinor, pengon hetimin administrativ apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij. Në këtë rast pezullimi vendoset deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

2. Kundër urdhrit të ministrit, përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të bëjë ankim në gjykatën administrative kompetente brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij.

Neni 64

Efektet e pezullimit

1. Në përfundim të afatit apo zhdukjes së shkakut të pezullimit, përveçse kur vendoset largimi nga detyra, sipas këtij ligji, përmbaruesi gjyqësor rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës ose në rast se pozicioni i mëparshëm është i plotësuar përfundimisht, ai transferohet në një zyrë tjetër përmbarimore sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.

2. Periudha e pezullimit në rastet e parashikuara nga shkronjat “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 63 të këtij ligji, llogaritet si vjetërsi pune në profesion.

3. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë. Në rastet e parashikuara nga shkronjat “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 63 të këtij ligji, përmbaruesi përfiton 50% të pagës së plotë. Në rastin e parashikuar nga shkronja “a” e pikës 1 të nenit 63 të këtij ligji, kur vendoset pushimi i çështjes apo pafajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë, përmbaruesit gjyqësor shtetëror i jepet paga e plotë që nga momenti i pezullimit.

KREU XI

PROCEDIMI DISIPLINOR

Neni 65

Fillimi i hetimit

1. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit vendos të fillojë hetimin për shkeljen e pretenduar ose të arkivojë një ankesë brenda 3 muajve nga marrja e ankesës.

2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit brenda gjashtë muajve nga dita e marrjes së vendimit për fillimin e hetimit fillon procedimin disiplinor duke i paraqitur Këshillit të Përmbarimit raportin e hetimit ose merr vendim për mbylljen e hetimit.

3. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit mund të zgjasë afatën e hetimit në raste komplekse për arsye të shtimit ose ndryshimit të objektit të hetimit apo në rast sëmundjeje ose pamundësisë së përmbaruesit gjyqësor, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

4. Në rastet kur pas kalimit të afateve të parashikuara në pikat 2 ose 3 të këtij neni, dalin prova të reja, mbi bazën e të cilave ka shkaqe të arsyeshme të besohet se shkelja mund të ketë ndodhur, drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit riçel hetimin, me kushtin që të mos jetë parashikuar sipas nenit 85 të këtij ligji.

Neni 66

Ankesat

1. Çdo individ, person juridik ose zyrat përmbarimore vendore kanë të drejtë t'i paraqesin drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit ankesa të arsyetuara me shkrim.

2. Në rastet kur ka të dhëna të besueshme që përmbaruesi mund të ketë kryer shkelje disiplinore, çdo funksionar publik që ka dijeni duhet të informojë drejtorin e përgjithshëm të Përmbarimit.

3. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit ka detyrimin të shqyrtojë të gjitha ankesat, përveç atyre anonime. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë ruajtjen e konfidencialitetit.

4. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit i konfirmon ankuesit marrjen e ankesës brenda 10 ditëve. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit i njofton ankuesit vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin e hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit përkatës.

5. Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit informon ministrin mbi ankesën e paraqitur, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur faktet për të cilat kërkohet fillimi i procedimit disiplinor, shkeljen e pretenduar, si dhe vendimmarrjen përkatëse.

6. Tërheqja e ankesës nga ankuesi nuk sjell arkivimin e ankesës dhe mbylljen e hetimit të filluar nëse drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit vlerëson që ka shkaqe të mjaftueshme për kryerjen e hetimit me iniciativën e tij.

7. Formulari i ankesës publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.



Neni 67

Fillimi i hetimeve kryesisht

1. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit fillon hetimin me iniciativën e vet bazuar në të dhëna thelbësore dhe mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. Informacionet që përftohen nga media ose nga ankues anonimë mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht.

2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit nxjerr vendim të arsyetuar për fillimin e hetimit kryesisht, duke parashtruar rrethanat faktike të verifikueshme. Vendimi i njoftohet edhe përmbarruesit.

Neni 68

Bashkimi i hetimeve, shtimi dhe ndryshimi i objektit të hetimit

1. Në rast se gjatë hetimit ngrihen dyshime të arsyeshme se një shkelje tjetër mund të ketë ndodhur, drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit urdhëron shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit në zbatim të nenit 67 të këtij ligji dhe njofton ankuesin, përmbarruesin gjyqësor, Këshillin Përmbarrimor, si dhe ministrin.

2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit bashkon hetimet në rastet kur konstaton se ankesat ose hetimet e filluara u referohen të njëjtave fakte ose të njëjtë përmbarrues.

Neni 69

Pezullimi i hetimeve

1. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit urdhëron pezullimin e hetimit disiplinor kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil, në të cilat:

a) njëra nga palët është përmbarruesi gjyqësor shtetëror;

b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte për të cilat do të merret vendimi.

2. Hetimi pezullohet deri në dhënien e vendimit të formës së prerë të institucionit kompetent.

3. Ankuesi, përmbarruesi gjyqësor shtetëror, gjykata, prokuroria, zyra përmbarrimore, Këshilli i Përmbarrimit Disiplinor dhe ministria njoftohen me shkrim për urdhrin e pezullimit.

4. Gjykata, prokuroria ose institucione të tjera i dërgojnë drejtorit të përgjithshëm të Përmbarrimit pa vonesë çdo vendim që merret gjatë hetimit dhe procesit përkatës.

5. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit u referohet vetëm fakteve mbi të cilat bazohet vendimi gjyqësor i formës së prerë. Vendimi gjyqësor i formës së prerë në favor të përmbarruesit nuk pengon hetimin për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të përmbarruesit.

6. Pezullimi i hetimeve ndërpret afatin e parashkrimit të parashikuar nga neni 83 të këtij ligji.

7. Urdhri për pezullimin e hetimit nuk ankimohet.

Neni 70

Të drejtat e përmbarruesit gjatë hetimit

1. Përmbarruesi gjyqësor shtetëror është palë në proces që nga momenti i fillimit të hetimit disiplinor dhe atij i garantohet aksesin në dosjen e hetimit në atë masë që nuk cenon sekretin e hetimit.

2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit mund të kërkojë nga përmbarruesi gjyqësor shtetëror informacione, dokumente ose çdo provë që është e nevojshme për hetimin.

3. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit i njofton përmbarruesit gjyqësor shtetëror ose përfaqësuesit të tij vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin e hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit.

Neni 71

Ecuria e hetimeve

1. Objekti i hetimit tregon qartë elementet e shkeljes së pretenduar, sipas përcaktimeve në vendimin për fillimin e hetimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit thërret dëshmitarë dhe mbledh të dhëna, dokumente dhe prova nga gjykata, prokuroria, institucione të tjera shtetërore, organizata, dëshmitarë, si dhe nga përmbarruesi dhe ndërmer veprime të nevojshme për të hetuar e përcaktuar nëse shkelja e pretenduar ka ndodhur.



Neni 72

Kërkesat për marrjen në pyetje

1. Kur drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit vlerëson se marrja në pyetje e përmbarruesit, dëshmitarëve ose personave të tjerë paraqet rëndësi për hetimin, i njofton ata lidhur me kohën dhe vendin e seancës së marrjes në pyetje.

2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit merr masa për dokumentimin e seancës së marrjes në pyetje, sipas rregullave të parashikuara në këtë nen.

3. Regjistrimi audio i seancës së marrjes në pyetje përmbledhet në procesverbal dhe zbardhet me kërkesë të palëve. Përmbarruesi nënshkruan procesverbalin e marrjes në pyetje, si dhe transkriptimin e regjistrimit audio.

4. Regjistrimi audio, transkriptimi i tij, si dhe procesverbali i seancës së marrjes në pyetje bëhen pjesë e dosjes.

Neni 73

Kërkesat në lidhje me mbledhjen e provave nga institucionet e tjera

1. Çdo organ publik, person fizik ose juridik përmbush në kohë kërkesat e drejtorit të përgjithshëm të Përmbarrimit për marrje informacioni, dokumente ose prova të tjera që lidhen me hetimin, brenda afateve kohore të arsyeshme të përcaktuara në kërkesë, me përjashtim të rasteve kur dhënia e tyre është e kufizuar me ligj.

2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit përsërit kërkesën në rastin kur personi ose subjekti, të cilit i drejtohet kjo kërkesë, nuk e përmbush atë brenda afatit të caktuar, duke informuar në rastin e personit juridik edhe drejtuesin e tij. Në rastin kur personi ose subjekti, të cilit i drejtohet kjo kërkesë, nuk përmbush kërkesën e përsëritur brenda afatit të caktuar, drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit njofton organin përgjegjës disiplinor.

3. Nëse gjatë hetimit disiplinor të përmbarruesit gjyqësor shtetëror ekziston nevoja thelbësore dhe specifike për të marrë dokumente, informacione, të cilat mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit mund t'i kërkojë gjykatës me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë lëshimin e një urdhri për dhënien e informacionit të kërkuar për përmbarruesin. Vendimi i gjykatës

merret nga gjyqtari i vetëm në dhomë këshillimi brenda 15 ditëve nga dorëzimi i kërkesës.

4. Kërkesa duhet të përmbajë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se përmbarruesi gjyqësor shtetëror ka kryer shkeljen dhe se informacioni i kërkuar është thelbësor për të përcaktuar nëse shkelja ka ndodhur.

Neni 74

Dokumentacioni i hetimit

1. Struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarrimit dokumenton çdo veprim hetimor me procesverbal.

2. Procesverbali përmban:

a) emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës që kryen veprimin;

b) datën e kryerjes së veprimit;

c) subjektin dhe objektin e veprimit;

ç) pjesëmarrësit;

d) përshkrimin e hollësishëm të veprimit të kryer;

dh) nënshkrimin e personave që marrin pjesë në këto veprime.

3. Me përfundimin e hetimit disiplinor, struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarrimit harton raportin e hetimit, i cili përmban të paktën:

a) emrin dhe mbiemrin e hartuesve të raportit;

b) shkaqet për të filluar hetimin, subjektin dhe objektin e hetimit, sipas përcaktimeve të bëra në vendimin për fillimin e hetimit, ndryshimin ose shtimin e objektit të hetimit;

c) veprimet e kryera gjatë hetimit;

ç) përmbledhjen e deklaratave të përmbarruesit gjyqësor shtetëror përkatës dhe të personave të tjerë ose institucioneve;

d) parashtrimin e fakteve të pranura dhe të papranuara, ashtu si edhe të provave, si dhe vlerësimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre;

dh) analizën ligjore të fakteve të pranura që mbështesin përfundimin se shkelja disiplinore e pretenduar është kryer ose se hetimi duhet mbyllur;

e) propozimin për mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor dhe propozimin për caktimin e masës disiplinore.



Neni 75

Përfundimi i hetimit

1. Në përfundim të hetimit, nëse ka dyshime të arsyeshme që përmbaruesi gjyqësor shtetëror ka kryer shkelje disiplinore, drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit fillon procedimin disiplinor duke paraqitur në Këshillin e Përmbarimit raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.

2. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit mbyll hetimin nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit, se:

a) provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore;

b) çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë në kuadër të një procedimi disiplinor, përveç rasteve kur paraqiten fakte ose prova të reja;

c) çështja është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi për shkak të kalimit të afateve;

ç) përmbaruesi ka ndërruar jetë.

3. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit i njofton vendimin përmbaruesit gjyqësor shtetëror të interesuar ose përfaqësuesit të tij, ankuesit, Këshillit Përmbarimor dhe ministrit. Vendimi përmban arsyet për mbylljen e hetimit sipas pikës 2, të këtij neni.

Neni 76

Ridërgimi i çështjes drejtorit të përgjithshëm të Përmbarimit

Nëse gjatë procedimit disiplinor, drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit merr informacion se ka dyshime të arsyeshme që mund të jetë kryer një shkelje tjetër, atëherë:

a) i kërkon Këshillit të Përmbarimit të ndërpresë procedimin disiplinor, urdhëron shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, kryen hetimin e nevojshëm dhe paraqet raportin e hetimit të mëtejshëm brenda 1 muaji nga ndërprerja e procedimit; ose

b) i kërkon Këshillit të Përmbarimit që të shtojë ose të ndryshojë objektin e procedimit disiplinor, nëse nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme.

Neni 77

Procedura përpara Këshillit të Përmbarimit

1. Këshilli i Përmbarimit cakton një datë për seancën dëgjimore pas marrjes së dosjes nga drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit dhe njofton palët për zhvillimin e seancës, së paku 10 ditë përpara.

2. Këshilli i Përmbarimit merr parasysh të gjitha rrethanat që kanë lidhje me çështjen.

3. Këshilli i Përmbarimit verifikon dokumentacionin e dosjes personale të përmbaruesit gjyqësor, përvojën dhe rezultatet individuale në ushtrimin e detyrës, rrethanat e kryerjes së shkeljes disiplinore, rëndësinë e saj, shkallën e fajësisë, shpeshhtësinë e kryerjes së shkeljes, qëndrimin e përmbaruesit gjyqësor ndaj shkeljes së kryer, pasojat e mundshme dhe të shkaktuara, si dhe çdo situatë të mundshme jashtë kontrollit të përmbaruesit gjyqësor shtetëror.

4. Komisioni disiplinor mund të marrë dëshmi shtesë, duke përfshirë thirrjen e dëshmitarëve, si dhe të angazhojë ekspertë kur e konsideron të përshtatshme.

5. Nëse provat shtesë nuk mund të sigurohen, Këshilli i Përmbarimit mund të kërkojë nga drejtori i përgjithshëm i Përmbarimit që të kryejë hetime të mëtejshme duke specifikuar elementet e munguara dhe periudhën kohore për të cilën kërkohet hetimi.

Neni 78

Mbyllja e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore

1. Këshilli i Përmbarimit vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore, nëse:

a) shkelja disiplinore është parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi;

b) pas nisjes së procedimit, rezulton se çështja ka qenë objekt i një procedimi të mëparshëm;

c) përmbaruesi ka ndërruar jetë.

2. Këshilli i Përmbarimit mbyll procedimin disiplinor, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, me vendim të arsyetuar me shkrim. Këshilli i Përmbarimit njofton palët dhe ministrin për shkaqet e mbylljes së procedimit disiplinor.



Neni 79

Bashkimi i procedimeve disiplinore, ndryshimi dhe shtimi i objektit të procedimit disiplinor

1. Këshilli i Përmbarrimit, kur konstaton që procedimi disiplinor u referohet të njëjtave fakte dhe të njëjtit përmbarrues, mund të vendosë bashkimin e procedimeve.

2. Këshilli i Përmbarrimit, kur e çmon së çështja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, pa marrë në shqyrtim një ose disa pretendime të tjera për shkeljen disiplinore ndaj të njëjtit përmbarrues gjyqësor shtetëror, ka të drejtë:

a) të vendosë për pretendimet e ndryshuara ose të shtuara, nëse nuk është i nevojshëm hetimi i mëtejshëm, pasi të ketë dëgjuar palët në procedim; ose

b) pa pezulluar procedimin disiplinor, t'i kërkojë drejtorit të përgjithshëm të Përmbarrimit të ndryshojë ose të shtojë objektin e procedimit disiplinor në përputhje me këtë ligj, si dhe të hetojë këto pretendime të tjera të paktën brenda afatit 30-ditor.

Neni 80

Të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë procedimit disiplinor

1. Gjatë procedimit disiplinor, përmbarruesit gjyqësorë shtetërorë ose përfaqësuesit të tij i sigurohet akses në dosje në masën që nuk cenon:

- a) interesat ligjorë të palëve ose personat e tretë;
- b) qëllimin e procedimit disiplinor;
- c) funksionet e organit vendimmarrës.

2. Kur përmbarruesit gjyqësor shtetëror i njoftohet se ndaj tij ka filluar procedimi disiplinor, duhet që t'i bëhen të ditura të drejtat, si më poshtë:

a) për të paraqitur një parashitje me shkrim në afatin e caktuar;

b) për të marrë pjesë në seancë dëgjimore;

c) për të thirrur dëshmitarë që mund të dëshmojnë fakte me interes për çështjen;

ç) për të paraqitur dokumente;

d) për të marrë masa të tjera për paraqitjen e provave në mbështetje të mbrojtjes së tij;

dh) për t'u përfaqësuar sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

3. Këshilli i Përmbarrimit mund t'i kërkojë përmbarruesit gjyqësor shtetëror të paraqesë të

dhëna, dokumente ose çdo lloj prove, si dhe të marrë pjesë në seancë dëgjimore.

4. Palët njoftohen për çdo vendim të komisionit disiplinor brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Neni 81

Pezullimi i procedimit disiplinor

Rregullat për pezullimin e hetimit disiplinor zbatohen për aq sa është e mundur për pezullimin e procedimit disiplinor.

Neni 82

Vendimet e Këshillit të Përmbarrimit

1. Këshilli i Përmbarrimit merr vendim, në lidhje me:

a) angazhimin e ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre;

b) shtyrjen e seancave;

c) pranueshmërinë e provave;

ç) zgjidhjen e çështjes; dhe

d) çdo çështje tjetër që vlerëson të nevojshme ose të përshtatshme në trajtimin e çështjes.

2. Pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe provave, si dhe masës disiplinore të propozuar nga drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit, Këshilli i Përmbarrimit vendos:

a) rrëzimin e kërkesës për procedim disiplinor për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore; ose

b) pranimin e kërkesës, marrjen e një ose më shumë masave disiplinore dhe njoftimin e vendimit Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit dhe ministrisë.

3. Këshilli i Përmbarrimit jep vendim të arsyetuar me shkrim brenda dy javëve nga përfundimi i seancës.

Neni 83

Ekzekutimi i vendimeve të Këshillit të Përmbarrimit

Ministri brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së vendimit të Këshillit të Përmbarrimit nxjerr urdhrin për zbatimin e masave disiplinore përkatëse në të cilin parashikon edhe modalitetet e zbatimit të tij, sipas vendimmarrjes së Këshillit të Përmbarrimit.



Neni 84

E drejta e ankimit

Kundër vendimeve për dhënien e masave disiplinore sipas këtij ligji mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

KREU XII**SHKELJET DHE MASAT DISIPLINORE**

Neni 85

Shkeljet disiplinore

1. Shkelje nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror konsiderohen veprimet dhe mosveprimet e mëposhtme:

a) shkelja e rregullave të parashikuara nga ky ligj, ligjet e tjera dhe aktet nënligjore, që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor shtetëror;

b) braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për 7 ditë e më shumë, kur mungesa ka sjellë pasoja në përmbushjen e detyrave të institucionit ose për të drejtat dhe interesat ligjore të palëve në proces ekzekutimi;

c) mospërmbushja me faj e veprimeve përmbarimore të parashikuara në ligj, që kanë cenuar të drejtat e palëve në proces ekzekutimi;

ç) konflikti i interesit në një procedurë ekzekutimi;

d) mospërmbushja në mënyrë të qëllimshme dhe të pajustificuar të detyrave, që i caktohen përmbaruesit gjyqësor shtetëror;

dh) shkelja e detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit, sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave që disponon si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së tij;

e) mosevidentimi në mënyrë të rregullt i të gjitha akteve dhe veprimeve procedurale të kryera gjatë veprimtarisë përmbarimore;

ë) pakujdesia në drejtim të mbajtjes dhe administrimit të dosjeve dhe dokumentacionit të krijuar për shkak të detyrës;

f) mosrespektimi i rregullave të etikës dhe standardeve profesionale në marrëdhënie me palët, subjektet e tjera të përfshirë në proces, kryetarin e zyrës përmbarimore, kolegët, personelin dhe publikun;

g) refuzimi apo pengimi i strukturës përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit apo strukturave të tjera shtetërore për të ushtruar kontroll për veprimtarinë përmbarimore, në përputhje me detyrat e tyre;

gj) shkelja e besimit të palëve në proces nëpërmjet kryerjes së veprimeve të padrejta ose të parregullta me njërën prej tyre ose me të tretë për të mos ekzekutuar apo vonuar ekzekutimin e titullit ekzekutiv;

h) ushtrimi i praktikave të ndaluara sipas përcaktimeve të këtij ligji;

i) pakujdesia në drejtim të mbajtjes së dosjeve përmbarimore dhe dokumentacionit tjetër;

j) tejkalimi i kompetencave të dhëna nga ligji;

k) trajtimi i pasurive dhe aseteve në kundërshtim me ligjin ose autorizimin e palëve;

l) punësimi në detyra të tjera publike, administrative ose mbikëqyrëse apo angazhimi në veprimtari, të cilat janë në kundërshtim me integritetin, paanësinë e përmbaruesit dhe parimet e ushtrimit të funksionit, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

ll) kryerja e transaksioneve të veta në emër të një personi tjetër ose të transaksioneve të një personi tjetër në emër të vet, qenia palë në transaksione për të cilat vepron edhe si përmbarues gjyqësor shtetëror;

m) përfitimi në mënyrë të padrejtë apo të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat, qoftë edhe me anë të veprimeve të ligjshme, i jepen për shkak të detyrës që ushtron ose si pasojë e përdorimit prej tij të pozicionit të përmbaruesit gjyqësor shtetëror;

n) shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar për të dhënat e klasifikuara si të tilla sipas legjislacionit në fuqi;

nj) kryerja brenda ose jashtë orarit zyrtar të veprimeve që cenojnë figurën e përmbaruesit gjyqësor shtetëror, Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit apo shërbimin përmbarimor në tërësi;

o) mospërmbushja e detyrimit për të marrë pjesë në formimin vazhdues, pa arsye të përligjura;

p) dëmtimi i pronës shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pronës shtetërore.

2. Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda 5 (pesë) vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja.



Neni 86

Masat disiplinore

1. Për shkeljet disiplinore jepen masat disiplinore të mëposhtme:

- a) vërejtje;
- b) vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra;
- c) ulje e pagës deri në 40% për një periudhë jo më të gjatë se 1 vit;
- ç) pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, me të drejtë për përfitimin e pagës minimale sipas vendimit të Këshillit të Ministrave;
- d) largim nga detyra.

2. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni jepen me vendim të drejtorit të përgjithshëm të Përmbarrimit, ndërsa masat e parashikuara në shkronjat “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni jepen me vendim të Këshillit të Përmbarrimit.

Neni 87

Parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore

1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, Këshilli i Përmbarrimit bazohet në:

- a) shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj;
- b) shkallën e fajësisë;
- c) ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashuara.

2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer.

Neni 88

Shuarja e masave disiplinore

1. Masat disiplinore shuhen, me përjashtim të masës së parashikuar në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 86 të këtij ligji, pas kalimit të këtyre afateve:

- a) 1 vit nga njoftimi i masës së parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 86 të këtij ligji;
- b) 2 vjet nga njoftimi i masës së parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 86 të këtij ligji;
- c) 3 vjet nga njoftimi i masës së parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 86 të këtij ligji;
- ç) 5 vjet nga njoftimi i masës së parashikuar në shkronjën “ç”, të pikës 1, të nenit 86 të këtij ligji;

2. Deklarimi i shuarjes bëhet kryesisht apo me kërkesë, me vendim të drejtorit të përgjithshëm të Përmbarrimit. Masa fshihet nga dosja e personelit të përmbarruesit gjyqësor shtetëror dhe regjistri disiplinor që mbahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit.

KREU XIII

PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES NË SHËRBIMIN PËRMBARIMOR SHTETËROR

Neni 89

Dorëheqja

1. Përmbarruesi gjyqësor shtetëror mund të njoftojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin përmbarrimor shtetëror nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes me shkrim te kryetari i zyrës përmbarrimore, duke vënë në dijeni drejtorin e përgjithshëm të Përmbarrimit.

2. Dorëheqja nuk motivohet dhe i prodhon efektet 30 ditë nga data e paraqitjes së saj.

3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar të nëpunësit dhe me miratimin e kryetarit të zyrës përmbarrimore, dorëheqja i prodhon efektet përpara afatit 30-ditor nga njoftimi.

Neni 90

Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin përmbarrimor shtetëror për shkak të ligjit

1. Marrëdhënia në shërbimin përmbarrimor shtetëror përfundon për shkak të ligjit, kur:

a) përmbarruesi gjyqësor shtetëror ndërron jetë apo kur merr formë të prerë vendimi gjyqësor për deklarimin e vdekjes së tij;

b) përmbarruesi gjyqësor shtetëror humbet shtetësinë shqiptare apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;

c) plotësohet moshja për pensionin e plotë të pleqërisë;

ç) konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit;

d) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

2. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin përmbarrimor shtetëror, për shkak të ligjit, konstatohet 5 ditë nga ndodhja apo njohja e tij nga kryetari i zyrës përmbarrimore.



Neni 91

**Largimi nga funksioni i përmbaaruesit
gjqësor shtetëror**

1. Përmbaaruesi gjqësor shtetëror largohet nga detyra, në rastet kur:

a) ka marrë masën disiplinore të largimit nga detyra sipas këtij ligji;

b) për shkak të refuzimit të pajustificuar për të pranuar transferimin e përhershëm, sipas këtij ligji;

c) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit, të deklaruar nga vetë ai dhe nëse transferimi në një pozicion tjetër nuk do të mënjanonte gjendjen e konfliktit të interesit;

ç) jep dorëheqjen nga detyra;

d) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor sipas ligjit;

dh) pas dy vlerësimeve të njëpasnjëshme “I pamjaftueshëm” të rezultateve në punë;

e) në çdo rast tjetër që parashikohet nga ligji.

2. Largimi nga detyra, me përjashtim të rastit të parashikuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni, konstatohet me urdhër të ministrit brenda 10 ditëve nga njohja e shkakut të largimit.

KREU XIV**DISPOZITA KALIMTARE
DHE TË FUNDIT**

Neni 92

Dispozita kalimtare

1. Procedurat e nisura ose në proces në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji përfundojnë sipas dispozitave të zbatueshme përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Ndaj përmbaaruesve gjqësorë shtetërorë, që në ditën e hyrjes në fuqi nuk kanë përfunduar periudhën e provës, procedura për emërimin përfundimtar të tyre në detyrë përfundon sipas dispozitave të zbatueshme përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Përmbaaruesit gjqësorë shtetërorë në detyrë vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

4. Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 8730, datë 18.1.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbaarimit gjqësor”, të ndryshuar, do të jenë në fuqi deri në nxjerrjen e

akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 93

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 12, pika 5; 29, pika 2, dhe 31, pika 2, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 2; 12, pika 4; 17, pika 5; 19, pika 4; 22, pika 3; 28, pika 4; 30, pika 2; 31, pika 3; 32 pika 6; 35, pika 3; 36, 42, pika 3, 43, pika 6; 44, pika 6, dhe 45, pika 4, të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri dhe ministri përgjegjës për financat që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 14, pika 2; 34, pika 3, dhe 35, pika 2, të këtij ligji.

Neni 94

Shfuqizime

Ligji nr. 8730, datë 18.1.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbaarimit gjqësor”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 95

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.2.2023.

Shpallur me dekretin nr. 32, datë 24.2.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET**Nr. 32, datë 24.2.2023****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,



DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 15/2023

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË FINLANDËS PËR
ELIMINIMIN E TATIMIT TË DYFISHTË,
NË LIDHJE ME TATIMET MBI TË
ARDHURAT DHE PARANDALIMIN E
SHMANGIEN E EVAZIONIT TATIMOR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Finlandës për eliminimin e tatimit të dyfishtë, në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin e shmangien e evazionit tatimor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.2.2023.

Shpallur me dekretin nr. 33, datë 24.2.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

SHTOJCA II

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
FINLANDËS PËR ELIMINIMIN E TATIMIT
TË DYFISHTË, NË LIDHJE ME TATIMET
MBI TË ARDHURAT DHE PARANDALIMIN
DHE SHMANGIEN E EVAZIONIT
TATIMOR**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Finlandës,

me qëllimin për të lidhur një Marrëveshje për eliminimin e tatimit të dyfishtë, në lidhje me tatimet mbi të ardhurat, pa krijuar mundësi për mostatim ose tatim të reduktuar nëpërmjet evazionit ose shmangies së tatimeve (duke përfshirë nëpërmjet marrëveshjeve të tipit *treaty shopping* (praktika e strukturimit të një biznesi shumëkombësh për të përfituar riga traktatet tatimore më të favorshme në dispozicion në juridiksione të caktuara), që synojnë lehtësirat e parashikuara në këtë marrëveshje për përfitim të tërthortë të rezidentëve të shteteve të treta),

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Personat e mbuluar

Kjo Marrëveshje zbatohet për personat që janë rezidentë të një ose dy Shteteve Kontraktuese.

Neni 2

Tatimet e përfshira

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për tatimet mbi të ardhurat të vendosura në emër të një Shteti Kontraktues ose të autoriteteve të tij lokale, pavarësisht nga mënyra se si vendosen.

2. Konsiderohen tatime mbi të ardhurat të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat totale ose mbi elemente të të ardhurave, duke përfshirë tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme, si dhe tatimet mbi vlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese për të cilat zbatohet Marrëveshja janë, në veçanti:

a) Në Shqipëri:



i. tatimet mbi të ardhurat, duke përfshirë tatimin mbi fitimin, tatimin mbi të ardhura personale dhe tatimin e të ardhurave nga kapitali ose nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme; dhe

ii. tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël (në vijim i referuar si “tatimi shqiptar”).

b) Në Finlandë:

i. tatimet mbi të ardhurat shtetërore (*valtion tuloverot; de statliga inkomstskatterna*);

ii. tatimet mbi të ardhurat korporative (*yhteisöjen tuloverot; inkomstskatterna för samfund*);

iii. tatimi bashkiak (*kunnallisvero; kommunalskatten*);

iv. tatimi i kishës (*kirkollisvero; kyrkoskatten*);

v. tatimi i mbajtur në burim nga interesi (*kekkotulon lähdevero; källskatten på ränteinkomst*); dhe

vi. tatimi i mbajtur në burim nga të ardhurat e jorezidentëve (*rajoitetusti verovelvollisen lähdevero; källskatten för begränsat skattskyldig*),

(në vijim i referuar si “tatimi finlandez”).

4. Marrëveshja zbatohet edhe për çdo tatim të njëjtë ose kryesisht të ngjashëm që vendoset pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes, si shtesë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese njoftojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim thelbësor në ligjet e tyre përkatëse tatimore.

Neni 3

Përkufizime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe:

a) termi “Shqipëri” nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe, nëse përdoret në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si dhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, që, në bazë të ligjeve të saj dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj, në lidhje me shtratin e detit, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

b) termi “Finlandë” nënkupton Republikën e Finlandës dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Finlandës, brenda të cilit, sipas ligjeve të Finlandës dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, mund të

ushtrohen të drejtat e Finlandës, në lidhje me eksplorimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore të shtratit të detit dhe në tokën e vet dhe të ujërave përreth;

c) termi “person” përfshin një individ, shoqëri dhe çdo organizim tjetër personash;

d) termi “shoqëri” nënkupton një organ korporativ ose subjekt që trajtohet si organ korporativ për qëllime tatimore;

e) termi “ndërmarrje” zbatohet për kryerjen e ndonjë biznesi;

f) termat “Shtet Kontraktues” dhe “Shteti tjetër Kontraktues” nënkupton Republikën e Finlandës dhe Republikën e Shqipërisë, siç e kërkon konteksti;

g) termi “ndërmarrje e një Shteti Kontraktues” dhe “ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues” nënkupton përkatësisht një ndërmarrje të zhvilluar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrje të zhvilluar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;

h) termi “shtetas”, në lidhje me një Shtet Kontraktues, nënkupton:

i. çdo individ që ka kombësinë ose shtetësinë e atij Shteti Kontraktues; dhe

ii. çdo person juridik, partneritet ose shoqatë, statusi i së cilës buron si i tillë nga ligjet në fuqi në atë Shtet Kontraktues.

i. termi “trafik ndërkombëtar” nënkupton çdo transport me anije ose avion që kryhet nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues, përveç kur anija ose avioni operon vetëm ndërmjet vendeve në Shtetin tjetër Kontraktues

j) termi “autoritet kompetent” nënkupton:

i. në Shqipëri, Ministria e Financave ose një përfaqësues i autorizuar i Ministrisë së Financave;

ii. në Finlandë, Ministria e Financave, përfaqësuesi ose autoriteti i autorizuar, i cili, nga Ministria e Financave, caktohet si autoritet kompetent;

k) termi “biznes” përfshin kryerjen e shërbimeve profesionale dhe të aktiviteteve të tjera të një karakteri të pavarur.

2. Në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term që nuk është përkufizuar në të, përveç ku konteksti e kërkon ndryshe, ka kuptimin që ka në atë kohë, sipas ligjit të atij Shteti, për qëllimet e tatimeve për të cilat zbatohet kjo Marrëveshje, ku çdo kuptim sipas ligjeve të zbatueshme tatimore të atij Shteti ka



përparësi ndaj kuptimit të dhënë atij termi, sipas ligjeve të tjera të atij Shteti.

Neni 4 Rezidenti

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi “rezident i një Shteti Kontraktues” nënkupton çdo person i cili, sipas ligjeve të atij shteti, u nënshtrohet tatimeve atje, për shkak të vendbanimit, vendqëndrimit, vendit të themelimit, vendit të menaxhimit ose një kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe përfshin edhe atë shtet ose çdo nënndarje politike apo autoritet të tij lokal. Megjithatë, ky term nuk përfshin asnjë person që u nënshtrohet tatimeve në atë Shtet, në lidhje me të ardhurat nga burimet në atë Shtet.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident në të dyja Shtetet Kontraktuese, atëherë statusi i tij përcaktohet, si më poshtë:

a) konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit në të cilin ka banesë të përhershme në dispozicion, nëse ai ka një banesë të përhershme në dispozicion në të dyja Shtetet, ai do të konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit, me të cilin ka marrëdhënie më të afërta personale dhe ekonomike (qendra e interesave jetikë);

b) nëse Shteti ku ka qendrën e interesave të tij jetikë nuk mund të përcaktohet ose nëse nuk ka banesë të përhershme në dispozicion në asnjë Shtet, ai do të konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit në të cilin ka vendbanim të zakonshëm;

c) nëse ka vendbanim të zakonshëm në të dyja Shtetet Kontraktuese ose në asnjërin prej tyre, do të konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit nga i cili është shtetas;

d) nëse është shtetas i të dyja Shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do ta zgjidhin çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person i ndryshëm nga një individ, është rezident i të dyja Shteteve Kontraktuese, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen të përcaktojnë me marrëveshje të ndërsjellë, Shtetin Kontraktues nga i cili ky person konsiderohet rezident, për qëllime të Marrëveshjes, duke pasur parasysh vendin e menaxhimit të tij efektiv, vendin ku është themeluar ose ndryshe

krijuar dhe faktorë të tjerë përkatës. Në mungesë të kësaj marrëveshjeje, ky person nuk ka të drejtë për kompensim dhe në një mënyrë të tillë që mund të bihet dakord nga autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese.

Neni 5 Selia e përhershme

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi “seli e përhershme” nënkupton një vend fiks biznesi nëpërmjet të cilit zhvillohet biznesi i një ndërmarrjeje në mënyrë të plotë ose të pjesshme.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin në veçanti:

a) një vend menaxhimi;

b) degë;

c) zyrë;

d) fabrikë;

e) punishte; dhe

f) minierë, pus naftë ose gazi, gurore ose vend tjetër për nxjerrjen e burimeve natyrore.

3. Termi “seli e përhershme” përfshin, gjithashtu:

a) një kantier ndërtimi, projekt ndërtimi ose instalimi, por vetëm nëse vazhdon për më shumë se nëntë muaj; dhe

b) ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë shërbimet e konsulencës, brenda një Shteti Kontraktues, nga një ndërmarrje, nëpërmjet punonjësve ose personeli tjetër të angazhuar nga ndërmarrja për këtë qëllim, por vetëm nëse aktivitetet e kësaj natyre (për të njëjtin projekt ose projekt të lidhur me të) brenda atij Shteti, vazhdojnë për një periudhë ose periudha që në total përbëjnë më shumë se nëntë muaj brenda çdo periudhe dymbëdhjetëmuajore.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “seli e përhershme” konsiderohet të mos përfshijë:

a) përdorimin e mjediseve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose dorëzimi të mallrave, ose artikujve që i përkasin ndërmarrjes;

b) mbajtjen e një stoku mallrash, që i përkasin ndërmarrjes, vetëm për qëllim magazinimi ose ekspozimi;

c) mbajtjen e një stoku mallrash, që i përkasin ndërmarrjes, vetëm për qëllim të ruajtjes, ekspozimit ose dorëzimit;



d) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të blerjes së mallrave ose të artikujve ose të mbledhjes së informacionit për ndërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të kryerjes nga ana e ndërmarrjes, të çdo aktiviteti tjetër të një karakteri përgatitor ose ndihmës;

f) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët “a” deri “e”, me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit fiks të biznesit që rezulton nga ky kombinim, të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 6, vepron në emër të një ndërmarrjeje dhe ka dhe zakonisht ushtron në një Shtet Kontraktues, autoritet për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes, ajo ndërmarrje do të konsiderohet të ketë seli të përhershme në atë Shtet, në lidhje me aktivitetet që ai person merr përsipër për ndërmarrjen, nëse aktivitetet e një personi të tillë nuk kufizohen tek ato të përmendura në paragrafin 4, që, nëse ushtrohet nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk do ta bënte këtë vend fiks biznesi një seli të përhershme, sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Një ndërmarrje nuk konsiderohet të ketë seli të përhershme në Shtetin tjetër Kontraktues vetëm se zhvillon biznesin në atë Shtet me anë të një ndërmjetësi, agjenti me autorizim të përgjithshëm ose çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që ata persona të veprojnë në ushtrim të zakonshëm të biznesit të tyre.

7. Fakti që një shoqëri, e cila është rezidente e një Shteti Kontraktues, kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues ose që zhvillon biznes në atë Shtet tjetër (qoftë nëpërmjet një selie të përhershme ose ndryshe), nuk përbën në vetvete që një prej këtyre shoqërive është seli e përhershme e shoqërisë tjetër.

Neni 6

Të ardhurat nga prona e paluajtshme

1. Të ardhurat që rrjedhin nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga prona e paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pylltaria), që

gjendjen në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” ka kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues ku ndodhet prona në fjalë. Në çdo rast, termi përfshin godinat, pasurinë ndihmëse të pasurisë së paluajtshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi dhe pylltari, të drejtat për të cilat zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm, në lidhje me pasurinë e paluajtshme, uzufruktin e pasurisë së paluajtshme dhe të drejtat për pagesa të ndryshueshme ose fikse, si shpërblim për punën ose të drejtën për punë, depozitat minerare, burimet dhe pasuritë e tjera natyrore; anijet, varkat dhe avionët nuk konsiderohen si pasuri e paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurisë së paluajtshme.

4. Kur pronësia e aksioneve ose të drejtave të tjera korporative në një shoqëri autorizon mbajtësin e këtyre aksioneve ose të drejtave korporative për gëzimin e pronës së paluajtshme të mbajtur nga shoqëria, të ardhurat nga përdorimi i drejtpërdrejtë, dhënia me qira ose përdorimi në ndonjë formë tjetër i kësaj të drejte për gëzim mund të tatohen në Shtetin Kontraktues ku ndodhet prona e paluajtshme.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 zbatohen edhe për të ardhurat nga prona e paluajtshme e një ndërmarrjeje.

Neni 7

Fitimet e biznesit

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues janë të tatueshme vetëm në atë Shtet, përveç kur ndërmarrja zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje. Nëse ndërmarrja zhvillon biznes si më sipër, fitimet e ndërmarrjes mund të tatohen në Shtetin tjetër, por vetëm në masën që i atribuohet asaj selie të përhershme.

2. Në bazë të dispozitave të paragrafit 3, kur një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje, fitimet të cilat mund të pritej të nxirte nëse do të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e ndarë, e përfshirë në aktivitete të njëjta ose të ngjashme, sipas kushteve të njëjta ose



të ngjashme dhe që ka marrëdhënie tërësisht të pavarura me ndërmarrjen seli e përhershme e së cilës ajo është, në secilin Shtet Kontraktues i atribuohen asaj selie të përhershme.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme lejohen si zbritje shpenzimet që janë kryer për qëllime të selisë së përhershme, duke përfshirë shpenzimet ekzekutive dhe shpenzimet e përgjithshme administrative të kryera në këtë mënyrë, qoftë në Shtetin ku ndodhet selia e përhershme ose diku tjetër.

4. Asnjë fitim nuk i atribuohet një selie të përhershme vetëm për shkak të blerjes nga ajo seli e përhershme të mallrave ose artikujve për ndërmarrjen.

5. Kur fitimet përfshijnë zërat e të ardhurave që rregullohen veçmas në nenet e tjera të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e atyre neneve nuk do të cenohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8

Transporti detar dhe ajror

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues nga operimi i anijeve ose i avionëve në trafikun ndërkombëtar janë të tatueshme vetëm në atë Shtet.

2. Dispozitat e paragrafëve 1 zbatohen edhe për fitimet nga pjesëmarrja në një ortakëri, biznes të përbashkët ose agjenci operuese ndërkombëtare, por vetëm deri në atë masë që fitimet e nxjerra në këtë mënyrë t'i atribuohen pjesëmarrësit në raport me pjesën/përqindjen e tij në operacionin e përbashkët.

Neni 9

Ndërmarrjet e asociuara

1. Nëse:

a) një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues; ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues,

dhe kur në çdo rast janë caktuar ose vendosur kushte midis dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e

tyre tregtare ose financiare, që ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë, çdo fitim që në mungesë të atyre kushteve do t'i ishte shtuar një prej ndërmarrjeve, por, për shkak të atyre kushteve nuk është shtuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe të tatohet, sipas rrethanave.

2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të atij Shteti dhe për rrjedhojë taton fitimet për të cilat një ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues është tatuar në atë Shtet tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitimet të cilat do t'i ishin shtuar ndërmarrjes së Shtetit të përmendur më parë, nëse kushtet e vendosura midis dy ndërmarrjeve do të kishin qenë ato që do të ishin vendosur midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë Shteti tjetër do të kryejë një rregullim të përshtatshëm ndaj shumës së tatimeve të vendosura në të mbi ato fitime. Në përcaktimin e këtij rregullimi, duhet t'u kushtohet vëmendje e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, nëse është e nevojshme, konsultohen me njëri-tjetrin.

Neni 10

Dividendët

1. Dividendët e paguar nga një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, këta dividendë mund të tatohen edhe në Shtetin Kontraktues ku është rezidente shoqëria që paguan dividendët dhe sipas ligjeve të atij Shteti, por, nëse mbajtësi përfitues i dividendëve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur në këtë mënyrë nuk tejkalon:

a) 5 për qind të shumës bruto të dividendëve, nëse mbajtësi përfitues është një shoqëri (e ndryshme nga një partneritet), që mban drejtpërdrejt të paktën 25 për qind të kapitalit të shoqërisë që paguan dividendët;

b) 15 për qind të shumës bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

Ky paragraf nuk cenon tatimin e shoqërisë, në lidhje me fitimet nga të cilat paguhet dividendët.

3. Termi “dividendë”, siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga aksionet, aksionet



jouissance ose të drejta *jouissance*, aksionet e minierave, aksionet e themeluesve ose të drejta të tjera që nuk janë detyrime borxhi, që marrin pjesë në fitime, si dhe çdo e ardhur nga të drejta të tjera korporative që i nënshtrohet të njëjtit trajtim tatarimor, si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e Shtetit në të cilin shoqëria që kryen shpërndarjen është rezidente.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse mbajtësi, përfitues i dividendëve, që është rezident i një Shteti Kontraktues zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues ku shoqëria që paguan dividendët është rezidente, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të dhe që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhen dividendët është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme. Në këtë rast zbatohen dispozitat e nenit 7.

5. Kur një shoqëri rezidente e një Shteti Kontraktues nxjerr fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ai Shtet tjetër nuk mund të vendosë ndonjë tatim mbi dividendët e paguar nga shoqëria, përveç rasteve kur këta dividendë i paguhen një rezidenti të atij Shteti tjetër ose për sa kohë që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhen dividendët, është efektivisht e lidhur me selinë e përhershme të vendosur në atë Shtet tjetër, dhe as nuk do t'i nënshtrojë fitimet e pashpërndara të shoqërisë një tatim mbi fitimet e pashpërndara të shoqërisë, edhe nëse dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara përbëhen tërësisht ose pjesërisht prej fitimeve ose të ardhurave të nxjerra në atë Shtet tjetër.

Neni 11

Interesi

1 Interesi i lindur në një Shtet Kontraktues dhe i paguar një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohet në atë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, ky interes mund të tatohet edhe në Shtetin Kontraktues ku lind dhe sipas ligjeve të atij Shteti, por nëse mbajtësi përfitues i interesit është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur nuk tejkalon 5 për qind të shumës bruto të interesit.

3. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 2, interesi i lindur në një Shtet Kontraktues dhe i paguar rezidentit të Shtetit tjetër Kontraktues, i cili është mbajtës përfitues i tij, do të jetë i tatueshëm vetëm

në atë Shtet tjetër, nëse një interes i tillë i është paguar:

a) Qeverisë së Shtetit tjetër Kontraktues, duke përfshirë çdo autoritet lokal të tij, Bankën Qendrore ose ndonjë agjenci ose instrumentalitet (përfshirë një institucion financiar) të zotëruar plotësisht ose kryesisht nga ajo qeveri;

b) një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, në lidhje me ndonjë hua ose kredi të garantuar nga qeveria e Shtetit tjetër, duke përfshirë çdo autoritet lokal të tij, Bankën Qendrore ose ndonjë agjenci ose instrumentalitet (përfshirë një institucion financiar) të zotëruar ose të kontrolluar nga ajo qeveri.

4. Termi “interes” siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga detyrimet e borxhit të çdo lloji, i garantuar apo jo me hipotekë dhe pavarësisht nëse mban apo jo të drejtën për të marrë pjesë në fitimet e debitorit dhe, në veçanti, të ardhurat nga letrat qeveritare me vlerë dhe të ardhurat nga obligacionet ose dëftesat e borxhit, duke përfshirë primet dhe çmimet që u bashkëngjiten këtyre letrave me vlerë, obligacioneve ose dëftesave të borxhit. Tarifat e penaltiteve për vonesën në pagesë nuk konsiderohen interes për qëllimin e këtij neni.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse mbajtësi përfitues i interesit që është rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin lind interesi, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të dhe pretendimi i borxhit në lidhje me të cilin paguhet interesi është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7.

6. Interesi konsiderohet të lindë në një Shtet Kontraktues, kur paguesi është rezident i atij Shteti. Megjithatë, nëse personi që paguan interesin, qoftë rezident i një Shteti Kontraktues apo jo, ka në një Shtet Kontraktues një seli të përhershme, në lidhje me të cilën ka ndodhur mbetja e borxhit mbi të cilën është paguar interesi dhe ky interes mbulohet nga kjo seli e përhershme, atëherë interesi do të konsiderohet të lindë në Shtetin ku ndodhet selia e përhershme.

7. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe mbajtësit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e interesit, duke pasur parasysh pretendimin e borxhit për të cilin paguhet, tejkalon shumën që do



të ishte rënë dakord nga paguesi dhe mbajtësi përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme, sipas ligjeve të secilit Shtet Kontraktues, duke u kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Tarifat e licencave

1. Tarifat e licencave të lindura në një Shtet Kontraktues dhe të paguara një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto tarifa licencash mund të tatohen, gjithashtu, në Shtetin Kontraktues në të cilin ato lindin, dhe sipas ligjeve të atij Shteti, por nëse pronari përfitues i tarifave të licencave është një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur nuk tejkalon 5 për qind të shumës bruto të tarifave të licencave.

3. Termi “tarifë e licencave”, siç përdoret në këtë nen nënkupton pagesa të çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin, ose të drejtën e përdorimit, të ndonjë të drejte të autorit të veprës letrare, artistike ose shkencore, përfshirë filmat e kinematografisë dhe filmat ose kasetat për transmetim në televizion ose radio, çdo patentë, markë tregtare, dizajn ose model, plan, formulë sekrete ose proces, ose për informacion, në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen, nëse mbajtësi përfitues i tarifave të licencave që është rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues, në të cilin lindin tarifat e licencave, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të dhe e drejta ose prona për të cilën paguhen tarifat e licencave është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7.

5. Tarifat e licencave konsiderohen se lindin në një Shtet Kontraktues kur paguesi është rezident i atij Shteti. Megjithatë, nëse personi që paguan tarifat e licencave, qoftë rezident i një Shteti Kontraktues apo jo, ka në një Shtet Kontraktues një seli të përhershme, në lidhje me të cilën ka ndodhur detyrimi për të paguar tarifat e licencave dhe këto tarifa të licencave mbulohen nga kjo seli e

përhershme, atëherë tarifat e licencave do të konsiderohen të lindin në Shtetin ku ndodhet selia e përhershme.

6. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe mbajtësit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e tarifave të licencave, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin paguhen, tejkalon shumën që do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe mbajtësi përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme, sipas ligjeve të secilit Shtet Kontraktues, duke u kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13

Fitimet e kapitalit

1. Fitimet që rrjedhin nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të referuar në nenin 6 dhe të vendosur në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme që formon pjesë të pasurisë së biznesit të një selie të përhershme që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues, duke përfshirë fitime të tilla nga tjetërsimi i kësaj selie të përhershme (vetëm ose me të gjithë ndërmarrjen), mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

3. Fitimet e marra nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i anijeve ose i avionëve të operuar në trafik ndërkombëtar ose pronë të luajtshme, që kanë të bëjnë me funksionimin e këtyre anijeve ose avionëve, do të tatohen vetëm në atë Shtet.

4. Fitimet e marra nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i aksioneve ose i interesave të krahasueshëm, që rrjedhin më shumë se 50 për qind të vlerës së tyre direkt ose indirekt nga prona e paluajtshme e vendosur në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo prone tjetër, përveç asaj të përmendur në paragrafët e mësipërm të këtij neni, tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit është tjetërsuesi.



Neni 14

Të ardhurat nga punësimi

1. Sipas dispozitave të neneve 15, 17 dhe 18, rrogat, pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme, që rrjedhin nga një rezident i një Shteti Kontraktues, në lidhje me një punësim tatohen vetëm në atë Shtet, përveç nëse punësimi ushtrohet në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse punësimi ushtrohet, ky shpërblim që rrjedh prej tij mund të tatohet në atë Shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, shpërblimi që rrjedh nga një rezident i një Shteti Kontraktues, në lidhje me një punësim të ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues tatohet vetëm në Shtetin e parë të përmendur, nëse:

a) marrësi është i pranishëm në Shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i kalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetë muaj, që fillon ose mbaron në vitin kalendarik në fjalë; dhe

b) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi që nuk është rezident i Shtetit tjetër; dhe

c) shpërblimi nuk mbulohet nga një seli e përhershme që punëdhënësi ka në Shtetin tjetër; dhe

d) punësimi nuk është një rast punësimi jashtë punës.

3. Pavarësisht nga dispozitat pararendëse të këtij neni, shpërblimi që rrjedh në lidhje me një punësim të ushtruar në bordin e një anijeje ose avioni që operohet në trafikun ndërkombëtar nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues, mund të tatohet në atë Shtet.

Neni 15

Tarifat e drejtorëve

Tarifat e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme, që rrjedhin nga një rezident i një Shteti Kontraktues, në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtorëve ose ndonjë organ tjetër i ngjashëm i një kompanie që është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

Neni 16

Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga parashikimet e nenit 14, të ardhurat që rrjedhin nga një rezident i një Shteti

Kontraktues si argëtues, të tilla si teatër, film, artist në radio ose në televizion, ose një muzikant, ose si një sportist, nga aktivitetet personale të këtij rezidenti, si të tilla të ushtruara në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat, në lidhje me aktivitetet personale të ushtruara nga një argëtues ose një sportist që vepron si i tillë nuk i takojnë argëtuesit ose sportistit por një personi tjetër, ato të ardhura mund, pa marrë parasysh dispozitat e nenit 14, të tatohen në Shtetin kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e argëtuesit ose sportistit.

Neni 17

Pensionet, pagesat vjetore dhe pagesat e ngjashme

1. Sipas dispozitave të paragrafit 2 të nenit 18, pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme, duke pasur parasysh punësimin e kaluar të paguar një rezidenti të një Shteti Kontraktues tatohen vetëm në atë Shtet.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 dhe sipas dispozitave të paragrafit 2 të nenit 18, pensionet e paguara dhe përfitimet e tjera, qofshin kompensime periodike ose me shumë të njëhershme, të dhëna sipas legjislacionit për sigurimet shoqërore të një Shteti Kontraktues ose sipas ndonjë skeme publike të organizuar nga një Shtet Kontraktues për qëllime të mirëqenies sociale ose çdo pagesë vjetore, që lind në një Shtet Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet.

3. Termi “pagesë vjetore”, siç përdoret në këtë nen nënkupton një shumë të deklaruar të pagueshme në mënyrë periodike një individ, në kohë të caktuara gjatë jetës së tij ose gjatë një periudhe kohore të caktuar ose të konstatueshme, sipas detyrimit për të bërë pagesa kundrejt një shpërblimi të duhur dhe të plotë në para ose vlerë monetare (përveç shërbimeve të kryera).

Neni 18

Shërbimi i qeverisë

1. a) Rrogat, pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të paguara një individ nga një Shtet Kontraktues ose një organ statusor ose një autoritet lokal i tij, në lidhje me shërbimet e dhëna atij Shteti ose organi ose autoriteti tatohen vetëm në atë Shtet.



b) Megjithatë, këto rroga, paga dhe shpërblime të tjera të ngjashme do të tatohet vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse shërbimet kryhen në atë Shtet dhe individit është rezident i atij Shteti, i cili:

- i. është shtetas i atij Shteti; ose
- ii. nuk është bërë rezident i atij Shteti vetëm për qëllimin e dhënies së shërbimeve.

2. a) Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të paguara një individ nga, ose nga fondet e krijuara nga një Shtet Kontraktues ose një organ statusor ose një autoritet lokal i tij, në lidhje me shërbimet e dhëna atij Shteti ose organi ose autoriteti tatohen vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, një pension i tillë dhe shpërblime të tjera të ngjashme tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse individit është rezident dhe shtetas i atij Shteti.

3. Dispozitat e neneve 14, 15, 16 dhe 17 zbatohen për rrogat, pagat, pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme, për sa u përket shërbimeve të dhëna, në lidhje me një biznes të kryer nga një Shtet Kontraktues ose një organ statusor ose një autoritet lokal i tij.

Neni 19 Studentët

Pagesat që një student ose një praktikant biznesi, i cili është ose ishte menjëherë para se të vizitonte një Shtet Kontraktues një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, dhe i cili është i pranishëm në Shtetin e parë të përmendur vetëm për qëllimin e arsimimit ose trajnimit të tij për qëllimin e mirëmbajtjes, arsimimit ose trajnimit të tij nuk tatohen në atë Shtet, me kusht që këto pagesa të lindin nga burime jashtë këtij Shteti.

Neni 20 Të ardhurat e tjera

1. Zërat e të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kudo që lindin, që nuk trajtohen në nenet e mësipërme të kësaj Marrëveshjeje, tatohen vetëm në atë Shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen për të ardhurat, përveç të ardhurave nga prona e paluajtshme, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6, nëse marrësi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron

biznes në Shtetin tjetër Kontraktues përmes një selie të përhershme të vendosur në të, dhe e drejta ose prona për të cilën paguhen të ardhurat efektivisht lidhen me një seli të tillë të përhershme. Në një rast të tillë zbatohen dispozitat e nenit 7.

Neni 21 Eliminimi i tatimit të dyfishtë

1. Sipas dispozitave të ligjit finlandez, në lidhje me eliminimin e tatimit të dyfishtë ndërkombëtar (i cili nuk do të ndikojë në parimin e përgjithshëm të tij), tatimi i dyfishtë eliminohet në Finlandë, si më poshtë:

a) Kur një rezident i Finlandës siguron të ardhura, të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të tatohen në Shqipëri, Finlanda, sipas dispozitave të nënparagrafit “b”, lejon si zbritje nga taksa finlandeze e atij personi, një shumë të barabartë me taksën shqiptare të paguar sipas ligjit shqiptar dhe në përputhje me Marrëveshjen, siç llogaritet duke iu referuar të njëjtave të ardhura, për të cilat llogaritet tatimi finlandez.

b) Dividendët e paguar nga një kompani që është rezidente e Shqipërisë ndaj një kompanie që është rezidente e Finlandës dhe që kontrollon drejtpërdrejt të paktën 10 për qind të fuqisë së votës në kompaninë që paguan dividendët, përjashtohen nga taksa finlandeze.

c) Kur në përputhje me ndonjë dispozitë të Marrëveshjes, të ardhurat që rrjedhin nga një rezident i Finlandës përjashtohen nga tatimi në Finlandë, Finlanda, megjithatë, për llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat e mbetura të një personi të tillë, mund të marrë parasysh të ardhurat e përjashtuara.

2. Në Shqipëri tatimi i dyfishtë eliminohet, si më poshtë:

a) Kur një rezident i Shqipërisë siguron të ardhura të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të tatohen në Finlandë, Shqipëria lejon si zbritje nga tatimi shqiptar mbi të ardhurat e atij rezidenti një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Finlandë.

Megjithatë, kjo zbritje nuk duhet të tejkalojë atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat, siç llogaritet para se të jepet zbritja, e cila u atribuohet të ardhurave që mund të tatohen në Finlandë.



b) Kur në përputhje me ndonjë dispozitë të Marrëveshjes, të ardhurat e siguruar nga një rezident i Shqipërisë përjashtohen nga tatimi në Shqipëri, Shqipëria megjithatë, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat e mbetura të një rezidenti të tillë, mund të marrë parasysh të ardhurat e përjashtuara.

Neni 22

Jodiskriminimi

1. Shtetasit e një Shteti Kontraktues nuk i nënshtrohen në Shtetin tjetër Kontraktues ndonjë tatimi ose ndonjë kërkesë që lidhet me të, e cila është tjetër ose më e rëndë se sa takimi dhe kërkesat e lidhura, ndaj të cilave shtetasit e atij Shteti tjetër në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me vendbanimin, janë ose mund t'i nënshtrohen. Kjo dispozitë, pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, zbatohet gjithashtu, për personat që nuk janë banorë të njërit ose të të dyja Shteteve Kontraktuese.

2. Tatimi mbi një seli të përhershme që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues nuk vendoset më pak në mënyrë të favorshme në atë Shtet tjetër se sa tatimi i vendosur ndërmarrjeve të atij Shteti tjetër që kryejnë të njëjtat veprimtari. Kjo dispozitë nuk interpretohet se detyron një Shtet Kontraktues t'u japë rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues ndonjë ndihmë personale, lehtësim dhe ulje për qëllime të tatimit, për shkak të statusit civil ose përgjegjësiwe familjare që ai u jep banorëve të vet.

3. Me përjashtim të rastit kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, paragrafi 7 i nenit 11, ose paragrafi 6 i nenit 12, interesi, tarifat e licencave dhe disbursimet e tjera të paguara nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues zbriten, me qëllim të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, në të njëjtat kushte sikur të ishin paguar një rezidenti të Shtetit të përmendur së pari.

4. Ndërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilit është në pronësi të plotë ose të pjesshme ose kontrollohet, drejtpërdrejt ose indirekt, nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk i nënshtrohen në Shtetin e parë të përmendur ndonjë tatimi ose ndonjë kërkesë të lidhur me të, e cila është tjetër ose më e rëndë se sa tatimi dhe kërkesat e lidhura me të, ndaj të cilave

mund të jene subjekt ndërmarrje të tjera të ngjashme të Shtetit të parë të përmendur.

5. Dispozitat e këtij neni, pavarësisht nga dispozitat e nenit 2, zbatohen për tatimet e çdo lloji dhe përsëkrimi.

Neni 23

Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë

1. Kur një person merr parasysh se veprimet e njërit ose të të dyja Shteteve Kontraktuese i sjellin ose do t'i sjellin tatim jo në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, ai mund, pavarësisht nga mjetet juridike të parashikuara nga ligji i brendshëm i atyre Shteteve, të paraqesë çështjen e tij tek autoriteti kompetent i Shtetit Kontraktues ku ai është rezident ose, nëse çështja e tij është sipas paragrafit 1 të nenit 22, tek autoriteti kompetent i Shtetit Kontraktues ku ai është shtetas. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetësh nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatim, jo në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes.

2. Autoriteti kompetent bën përpjekje, nëse kundërshtimi i duket i justifikuar dhe nëse nuk mund të arrijë një zgjidhje të pranueshme, të zgjidhë çështjen me marrëveshje të ndërsjellë me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me qëllim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me Marrëveshjen. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht nga ndonjë kufizim kohor në ligjin e brendshëm të Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese bëjnë përpjekje të zgjidhin me marrëveshje të ndërsjellë çdo vështirësi ose dyshim që lind lidhur me interpretimin ose zbatimin e Marrëveshjes. Ata, gjithashtu, mund të konsultohen bashkërisht për eliminimin e tatimit të dyfishtë, në rastet që nuk parashikohen në Marrëveshje.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri-tjetrin drejtpërdrejt, duke përfshirë përmes një komisioni të përbashkët të përbërë nga ata ose përfaqësuesit e tyre, për qëllimin e arritjes së një marrëveshjeje sipas paragrafëve të mësipërm.



Neni 24

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese shkëmbejnë informacione të tilla që parashikohen të jenë të rëndësishme për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose për administrimin ose zbatimin e ligjeve të brendshme, në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimin e vendosur në emër të Shteteve Kontraktuese, ose të nënndarjeve të tyre politike ose autoriteteve lokale, për aq sa tatimi mbi të nuk është në kundërshtim me Marrëveshjen. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2.

2. Çdo informacion i marrë sipas paragrafit 1 nga një Shtet Kontraktues trajtohet si sekret në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë, sipas ligjeve të brendshme të atij Shteti dhe u njoftohet vetëm personave ose autoriteteve (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative) që kanë të bëjnë me vlerësimin ose heqjen, zbatimin ose ndjekjen penale, për sa i përket përcaktimit të ankesave, në lidhje me tatimet e referuara në paragrafin 1 ose mbikëqyrjen e sa më sipër. Këta persona ose autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund të zbulojnë informacionin në procedurat gjyqësore publike ose në vendimet gjyqësore. Pavarësisht nga sa më sipër, informacioni i marrë nga një Shtet Kontraktues mund të përdoret për qëllime të tjera kur një informacion i tillë mund të përdoret për qëllime të tilla të tjera, sipas ligjeve të të dyja Shteteve dhe autoriteti kompetent i Shtetit që jep informacionin autorizon një përdorim të tillë.

3. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk interpretohen se i imponojnë një Shteti Kontraktues detyrimin:

a) të kryejë masa administrative në kundërshtim me ligjet dhe praktikën administrative të atij ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) të sigurojë informacion që nuk mund të merret, sipas ligjeve ose gjatë ecurisë normale të administrimit të atij ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) të sigurojë informacion i cili do të zbulonte çdo sekret tregtar, biznesi, industrial, tregtar ose profesional ose proces tregtar, ose informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politiken publike (rendi publik).

4. Nëse informacioni kërkohet nga një Shtet Kontraktues në përputhje me këtë nen, Shteti tjetër Kontraktues do të përdorë masat e tij të mbledhjes së informacionit për të marrë informacionin e kërkuar, edhe pse ai Shtet tjetër mund të mos ketë nevojë për një informacion të tillë për qëllimet e tij tatimore. Detyrimi që përfshihet në fjalinë pararendëse u nënshtrohet kufizimeve të paragrafit 3, por në asnjë rast këto kufizime nuk interpretohen se lejojnë një Shtet Kontraktues të refuzojë të sigurojë informacion vetëm sepse nuk ka interes të brendshëm në një informacion të tillë.

5. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 3 nuk interpretohen se lejojnë një Shtet Kontraktues të refuzojë të japë informacion, vetëm sepse informacioni mbahet nga një bankë, institucion tjetër financiar, person i caktuar ose person që vepron në një agjenci ose me një kapacitet fiduciar ose për shkak se ka lidhje me interesat e pronësisë të një person.

Neni 25

Anëtarët e misioneve diplomatike dhe të posteve konsullore

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk ndikon në privilegjet fiskale të anëtarëve të misioneve diplomatike ose posteve konsullore, sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 26

E drejta për përfitime

Pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje, një përfitim sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të jepet në lidhje me një zë të ardhurash, nëse është e arsyeshme të arrihet në konkluzion, duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat përkatëse, që marrja e këtij përfitimi ishte një nga qëllimet kryesore të çdo marrëveshjeje ose transaksioni që rezultoi drejtpërdrejt ose indirekt në atë përfitim, përveç nëse përcaktohet se dhënia e këtij përfitimi në këto rrethana do të ishte në përputhje me objektin dhe qëllimin e dispozitave përkatëse të kësaj Marrëveshjeje.



Neni 27
Hyrja në fuqi

1. Qeveritë e Shteteve Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën, përmes kanaleve diplomatike, që kërkesat kushtetuese për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë përmbushur.

2. Marrëveshja hyn në fuqi tridhjetë ditë pas datës së fundit të njoftimeve të referuara në paragrafin 1 dhe dispozitat e saj kanë efekt në të dyja Shtetet Kontraktuese:

a) në lidhje me tatimin e mbajtur në burim, mbi të ardhurat që rrjedhin nga ose pas datës 1 janar, në vitin kalendarik pas vitit në të cilin Marrëveshja hyn në fuqi;

b) në lidhje me tatimet e tjera mbi të ardhurat për tatimet e pagueshme për çdo vit tatimor që fillon me ose pas 1 janarit në vitin e ardhshëm kalendarik pas vitit në të cilin Marrëveshja hyn në fuqi.

7. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni, dispozitat e nenit 24 (Shkëmbimi i informacionit) do të kenë efekt nga data në të cilën Marrëveshja hyn në fuqi, pa marrë parasysh periudhën e tatueshme për të cilën lidhet informacioni.

Neni 28
Ndërprerja

Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi derisa të përfundojë nga një Shtet Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues mund ta përfundojë Marrëveshjen, përmes kanaleve diplomatike, duke njoftuar mbi përfundimin të paktën gjashtë muaj para fundit të çdo viti kalendarik, pas periudhës prej pesë vjetësh nga data në të cilën Marrëveshja hyn në fuqi. Në një rast të tillë, Marrëveshja pushon të ketë efekt në të dyja Shtetet Kontraktuese:

a) në lidhje me tatimin e mbajtur në burim, mbi të ardhurat që rrjedhin nga ose pas datës 1 janar në vitin e ardhshëm kalendarik pas vitit në të cilin është dhënë njoftimi;

b) në lidhje me tatimet e tjera mbi të ardhurat për tatimet e tatueshme për çdo vit tatimor që fillon me ose pas datës 1 janar në vitin e ardhshëm kalendarik pas vitit në të cilin është dhënë njoftimi.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht për të, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje në Stocholm, sot, më 8, dita e qershorit 2022, në gjuhët shqipe, finlandeze dhe angleze, të tria tekstet njësoj autentike.

Në rast mospërputhjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
SË FINLANDËS:

DEKRET
Nr. 33, datë 24.2.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 15/2023, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Finlandës për eliminimin e tatimit të dyfishtë, në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin e shmangien e evazionit tatimor”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 35, datë 24.2.2023

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 7, nenit 8, nenit 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:



1. Rene Lolovic
2. Alban Usein Biçaku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM
Nr. 1, datë 15.2.2023

**MBI PËRCAKTIMIN E METODAVE TË
MARRJES SË MOSTRAVE DHE
ANALIZAVE PËR KONTROLLIN E
NIVELEVE TË MIKROELEMENTEVE
DHE KONTAMINANTËVE TË
PËRPUNIMIT NË PRODUKTET
USHQIMORE¹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të nenit 41, pika 12, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Marrja e mostrave dhe analiza për kontrollin e niveleve të plumbit, kadmium, merkur, kallaj inorganik, arsenik inorganik, 3-monokloropropan-1,2-diol (3-MCPD), estere të acideve yndyrore 3-MCPD, estere të acideve yndyrore glicidil,

hidrokarbure aromatike policiklike (PAH) dhe perklorate të listuara në seksionet 3, 4, 6 dhe 9, të shtojcës në udhëzimin nr. 1, datë 5.2.2016, “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore”, të kryhet në përputhje me shtojcën e këtij udhëzimi.

2. Urdhri nr. 209, datë 15.6.2012, mbi miratimin e rregullores “Mbi metodat e mostrimit dhe analizimit për kontroll zyrtar të niveleve të plumbit, kadiumit, merkurit, kallajit inorganik, 3-mcpd dhe benzo (a) pyrenit në produktet ushqimore”, shfuqizohet.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

¹ Ky udhëzim është përafshuar pjesërisht me rregulloren e Komisionit (KE) nr. 333/2007, e datës 28 mars 2007, që përcakton metodat e marrjes së mostrave dhe analizave për kontrollin e niveleve të elementeve gjurmë dhe të përpunimit të ndotësve në ushqime.



SHTOJCË PJESA A

PËRKUFIZIMET

Për qëllimet e kësaj shtojce, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

'lot': një sasi e identifikueshme ushqimi e dorëzuar në të njëjtën kohë dhe të përcaktuar nga zyrtari që të ketë karakteristika të përbashkëta, (si origjina, varieteti, lloji i paketimit, paketuesi, dërguesi ose shenjat). Në rastin e peshkut, gjithashtu madhësia e peshkut duhet të jetë e krahasueshme;

'nënlot': pjesë e caktuar e një pjese të madhe në mënyrë që të zbatohet metoda e kampionimit në atë pjesë të caktuar. Çdo nënlot duhet të jetë fizikisht i ndarë dhe i identifikueshëm;

'mostër shtesë': një sasi materiali e marrë nga një vend i vetëm në lot ose nënlot;

'mostër përfaqësuese': totali i kombinuar i të gjitha mostrave shtesë marrë nga loti ose nënloti; mostra aggregate do të konsiderohet si përfaqësues i loteve ose nënlotet nga të cilat janë marrë;

'mostra laboratorike': një kampion i destinuar për laborator.

PJESA B

METODAT E MARRJES SË MOSTRAVE

B.1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

B.1.1. Personeli

Marrja e mostrave do të kryhet nga një person i autorizuar nga AKU.

B.1.2. Materiali që do të merret për analizim

Nga çdo lot ose nënlot duhet të merret mostër e veçantë për tu analizuar.

B.1.3. Masat paraprake që duhen marrë

Gjatë marrjes së mostrave, duhet të merren masa paraprake për të shmangur ndryshime, të cilat do të ndikonin negativisht në nivelet e kontaminantëve, që në mënyrë të pafavorshme ndikojnë në përcaktimin analitik ose bëjnë mostrat jopërfaqësuese.

B.1.4. Mostrat shtesë

Mostrat shtesë, nëse është e mundur do të merren në vende të ndryshme të shpërndara në të gjithë lotin ose nënlotin, procedurë e cila regjistrohet në procesverbalin e parashikuar në pikën B.1.8. të kësaj shtojce.

B.1.5. Përgatitja e mostrës përfaqësuese

Mostra përfaqësuese krijohet duke kombinuar mostrat shtesë.

B.1.6. Mostrat për qëllime testimi ose kontestimi

Mostrat për qëllime analizimi ose në raste kontestimi duhet të merren nga mostra përfaqësuese e homogjenizuar, përveç rasteve kur kjo bie ndesh me legjislacionin në fuqi, në lidhje me të drejtat e operatorit të biznesit ushqimor.

B.1.7. Paketimi dhe transporti i mostrave

Çdo mostër duhet të vendoset në një enë sterile dhe hermetike, që ofron mbrojtje të



përshtatshme nga kontaminimi, nga humbja e analiteve, nga adsorbimi në murin e brendshëm të enës (kontejnerit) dhe kundër dëmtimit gjatë transportit. Duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të shmangur çdo ndryshim në përbërjen e mostrës që mund të ndodhë gjatë transportit ose ruajtjes.

Në rast të marrjes së mostrave për analizën e PAH-ve, kontejnerët plastikë duhet të shmangen nëse është e mundur, pasi ato mund të ndryshojnë përmbajtjen e PAH-ve në mostër. Duhet të përdoren kontejnerë qelqi të errët me kapak hermetik, për të mbrojtur në mënyrë të përshtatshme mostrën nga drita. Aty ku kjo është praktikisht e pamundur, të paktën duhet të shmangët kontakti i drejtpërdrejtë i mostrës me material plastik, p.sh. në rastin e mostrave të ngurta duke e mbështjellë kampionin me letër alumini përpara se ta vendosni në enën e marrjes së mostrave.

B.1.8. Vulosja dhe etiketimi i mostrave

Çdo mostër e marrë për përdorim zyrtar duhet të vuloset në vendin e marrjes së mostrave dhe të identifikohet.

Për çdo kampion duhet të mbahet një fletë shoqërimi, me qëllim që çdo lot ose nënlot të identifikohet në mënyrë të qartë (referenca në numrin e lotit duhet të jetë dhënë), duke dhënë datën dhe vendin e marrjes së mostrës së bashku me ndonjë informacion shtesë që mund të jetë në ndihmë të analistit.

B.2. PLANET E MOSTRAVE

B.2.1. Ndarja e loteve në nënlote

Lotet e mëdha do të ndahen në nënlote me kusht që nënlotet të ndahen fizikisht. Për produktet që tregtohen në ngarkesa me shumicë (p.sh. drithërat) zbatohet Tabela 1. Për produktet e tjera do të zbatohet Tabela 2. Duke marrë parasysh që pesha e lotit nuk është gjithmonë një shumëfish i saktë i peshës së nënloteve, pesha e nënlotit mund të kalojë peshën e përmendur me një maksimum prej 20 %.

B.2.2. Numri i mostrave shtesë

Për ushqim, përveç suplementeve ushqimore, erëza ose barishte të thata, kërpudhat, algat ose likenet e thara, mostra përfaqësuese duhet të jetë së paku 1 kilogram ose 1 litër, përveç rasteve kur nuk është e mundur, p.sh. kur mostra përbëhet nga 1 paketë ose njësi. Për shtesat ushqimore, erëzat ose barishtet e thata, kërpudhat e thata, algat ose likenet, mostra përfaqësuese duhet të jetë së paku 100 gram ose 100 mililitra.

Për ushqimin, përveç suplementeve ushqimore, numri minimal i mostrave shtesë që do të merren nga loti ose nënloti duhet të jetë në përputhje me Tabelën 3.

Në rastin e produkteve të lëngëta me shumicë, loti ose nënloti duhet të përzihet plotësisht për aq sa është e mundur dhe për aq sa nuk ndikon në cilësinë e produktit, qoftë me mjete manuale apo mekanike menjëherë përpara marrjes së kampionit. Në këtë rast, një shpërndarje homogjene e kontaminantëve do të supozohet brenda një loti ose nënloti të caktuar. Prandaj, numri i mostrave shtesë nga një lot ose nënlot për të formuar mostrën përfaqësuese duhet të jetë tre.

Kur loti ose nënloti përbëhet nga paketa ose njësi individuale, për ushqimin, përveç suplementeve ushqimore, numri i paketimeve ose njësive (mostrat në rritje) që do të merren për të formuar kampionin e përgjithshëm duhet të jenë në përputhje me Tabelën 4a.



Mostrat shtesë duhet të jenë me peshë/vëllim të ngjashëm. Për ushqimin, përveç suplementeve ushqimore, erëzave ose bimëve të thata, kërpudhave të thata, algave ose likeneve, pesha/vëllimi i një kampioni shtesë duhet të jetë së paku 100 gram ose 100 mililitra, duke rezultuar në një mostër përfaqësuese prej të paktën rreth 1 kilogram ose 1 litër.

Për erëzat ose barishtet e thata, kërpudhat e thata, algat ose likenet, pesha/vëllimi i një kampioni në rritje duhet të jetë së paku 35 gram ose 35 mililitra, duke rezultuar në një mostër përfaqësuese të paktën 100 gram ose 100 mililitra.

Nivelet maksimale për kallaj inorganik zbatohen për përmbajtjen e secilës kanaçe, por për arsye praktike mund të përdoret një metodë e marrjes së mostrave përfaqësuese. Nëse rezultati i testit për një mostër përfaqësuese kanaçesh është më i vogël ose afër nivelit maksimal të kallajit inorganik dhe nëse dyshohet se kanaçet individuale mund të kalojnë nivelin maksimal, atëherë do të kryhen hetime të mëtejshme.

Për suplementet ushqimore, numri dhe madhësia minimale e mostrave shtesë duhet të jetë në përputhje me Tabelën 4b.

Aty ku nuk është e mundur të kryhet metoda e kampionimit të përcaktuar në këtë pikë B.2. për shkak të pasojave të papranueshme tregtare (p.sh. për shkak të formave të paketimit, dëmtimit të lotit) ose kur është praktikisht e pamundur të zbatohet metoda e kampionimit të parashikuar në këtë pikë B.2., mund të zbatohet një metodë alternative e marrjes së mostrave me kusht që është mjaft përfaqësuese për lotin ose nënlotin e kampionuar dhe është plotësisht i dokumentuar. Kjo do të regjistrohet në regjistrin e parashikuar në pikën B.1.8.

Tabela 1

**Nënndarja e loteve në nënlote për produktet e tregtuara
në dërgesat me shumicë**

Pesha e lotit (ton)	Pesha ose numri i nënloteve
$\geq 1\,500$	500 ton
> 300 dhe < 1500	3 nënlote
≥ 100 dhe ≤ 300	100 ton
< 100	-

Tabela 2

**Nënndarja e loteve në nënlote për produktet që nuk tregtohen
në dërgesat me shumicë**

Pesha e lotit(ton)	Pesha ose numri i nënloteve
≥ 15	15-30 ton
< 15	-



Tabela 3

Numri minimal i mostrave shtesë që duhen marrë nga loti ose nënloti i ushqimit, përveç suplementeve ushqimore

Pesha ose vëllimi lotit/nënlotit (në kilogram ose litër)	Numri minimal i mostrave shtesë që duhen marrë
< 50	3
≥ 50 dhe ≤ 500	5
> 500	10

Tabela 4a

Numri i paketimeve ose njësive (mostrat shtesë) që do të merren

për të formuar mostrën përfaqësuese ku loti ose nënloti përbëhet nga pako individuale ose njësi ushqimi, të ndryshme nga suplementet ushqimore

Numri i paketave ose njësive në lot/nënlot	Numri i paketave ose njësive që duhen marrë
≤ 25	të paktën 1 paketë ose njësi
26-100	rreth 5 %, të paktën 2 pako ose njësi
> 100	rreth 5%, maksimumi 10 paketa ose njësi

Tabela 4b

Numri dhe madhësia minimale e mostrave shtesë për suplementet ushqimore

Madhësia e lotit (Numri i paketave)	Numri i paketave (mostrat shtesë) që do të merren për mostër	Madhësia e kampionit shtesë
1-50	1	E gjithë përmbajtja e paketës
51-250	2	E gjithë përmbajtja e paketës
251-1 000	4	Nga çdo paketë me pakicë e marrë për mostër, gjysma e përmbajtjes së paketimit



Madhësia e lotit (Numri i paketave)	Numri i paketave (mostrat shtesë) që do të merren për mostër	Madhësia e kampionit shtesë
> 1 000	4 + 1 pako për 1 000 paketa me pakicë me një maksimum e 25 paketa me pakicë	≤ 10 pako: nga çdo paketë me pakicë, gjysma e përmbajtjes së paketës > 10 pako: nga secila paketë, merret një sasi e barabartë për të rezultuar në një mostër me përmbajtjen e barabartë me 5 pako.
E panjohur (e zbatueshme vetëm për tregtinë elektronike)	1	E gjithë përmbajtja e paketës

B.2.3. Dispozita specifike për marrjen e mostrave nga peshq të mëdhenj

Në rast se loti ose nënloti që do të merret kampion përmban peshq të mëdhenj (peshq individualë që peshojnë më shumë se rreth 1 kg) dhe loti ose nënloti peshon më shumë se 500 kg, kampioni shtesë do të përbëhet nga pjesa e mesme e peshkut. Çdo mostër shtesë duhet të peshojë të paktën 100 g.

B.3. MOSTRIMI NË FAZËN E SHITJES ME PAKICË

Marrja e mostrave të produkteve ushqimore në fazën e shitjes me pakicë do të bëhet aty ku është e mundur në përputhje me dispozitat e kampionimit të përcaktuara në pikën B.2.2 të kësaj shtojce.

Kampionimi i përcaktuar në pikën B.2.2 për shkak të pasojave të papranueshme tregtare (p.sh. për shkak të formave të paketimit, dëmtimit të lotit, etj.) ose kur është praktikisht e pamundur të zbatohet metoda e sipërpërmendur e kampionimit, mund të zbatohet një metodë alternative kampionimi, e cila duhet të jetë përfaqësuese për lotin ose nënlotin e mostrës dhe duhet dokumentuar plotësisht.

PJESA C

PËRGATITJA DHE ANALIZA E MOSTRAVE

C.1. STANDARDET E CILËSISË LABORATORIKE

Laboratorët duhet të jenë në përputhje me dispozitat e nenit 12, të Urdhrit Nr. 382, datë 31.7.2006 Për miratimin e Rregullores “Mbi organizimin e kontrolleve zyrtare të bëra për të verifikuar përputhjen me legjislacionin për ushqimin e njerëzve dhe ushqimin për kafshëve dhe rregullat për shëndetin si dhe mirëqenien e kafshëve”.

Laboratorët do të marrin pjesë në skemat e duhura të testimit të aftësisë, të cilët janë në përputhje me "Protokollin Ndërkombëtar të Harmonizuar për Testimin e Aftësisë së Laboratorëve Analitikë (Kimikë)". (1) Zhvilluar nën kujdesin e IUPAC/ISO/AOAC.

Laboratorët duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë se kanë procedura të brendshme të kontrollit të cilësisë. Shembuj të tillë janë 'Udhëzimet ISO/AOAC/IUPAC mbi kontrollin e brendshëm të cilësisë në Laboratorët e Kimisë Analitike ' (2).



Aty ku është e mundur vërtetësia e analizës do të vlerësohet duke përfshirë materialet e referencës të certifikuara të analizave.

C.2. PËRGATITJA E MOSTRAVE

C.2.1. Masat paraprake dhe konsideratat e përgjithshme

Kërkesa bazë është të merret një mostër laboratorike përfaqësuese dhe homogjene pa futur ndotje dytësore.

I gjithë materiali i mostrës së marrë nga laboratorit do të përdoret për përgatitjen e mostrës laboratorike.

Përputhshmëria me nivelet maksimale të përcaktuara në Udhëzimin Nr. 1, datë 5.2.2016 “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore” të përcaktohet në bazë të niveleve të përcaktuara në mostrat laboratorike.

C.2.2. Procedurat specifike të përgatitjes së mostrës

C.2.2.1. Procedura specifike për plumbin, kadmiumin, merkurin, kallajin inorganik dhe arsenikun inorganik

Analisti duhet të sigurojë që mostrat të mos kontaminohen gjatë përgatitjes së mostrës. Kudo ku është e mundur, aparaturat dhe enët laboratorike që vijnë në kontakt me kampionin nuk duhet të përmbajnë ato metale, që do të përcaktohen por duhet të jenë nga materiale plastike, p.sh. si polipropileni, politetrafluoroetilen (PTFE) etj. Këto duhet të pastrohen me acid për të minimizuar rrezikun e kontaminimit. Për prerjen e skajeve mund të përdoret çelik inox me cilësi të lartë.

Ka shumë procedura specifike të përgatitjes së mostrës të cilat mund jenë të kënaqshme dhe të përdoren për produktet në shqyrtim. Për disa aspekte që nuk mbulohen në mënyrë specifike nga kjo rregullore, Standardi CEN 'Ushqimi. Përcaktimi i elementeve dhe llojeve të tyre kimike. Konsideratat e përgjithshme dhe kërkesat specifike' ⁽¹⁾ është gjetur se është shumë i kënaqshëm, por gjithashtu metodat e tjera të përgatitjes së mostrës mund të jenë po aq të vlefshme.

Në rastin e kallajit inorganik, duhet pasur kujdes që të sigurohet që i gjithë materiali të merret në tretësirë, pasi dihet se ndodhin humbjet, veçanërisht për shkak të hidrolizës në llojet e oksidit të patretshëm të hidratuar Sn(IV).

C.2.2.2. Procedurat specifike për hidrokarburet aromatike policiklike

Analisti duhet të sigurojë që mostrat të mos kontaminohen gjatë përgatitjes së mostrës. Kontejnerët duhet të shpëlahen me aceton ose heksan me pastërti të lartë, përpara përdorimit për të minimizuar rrezikun e kontaminimit. Aty ku është e mundur, aparaturat dhe enët laboratorike që vijnë në kontakt me kampionin duhet të jenë material alumini, qelqi ose çelik inox i lëmuar. Plastika të tilla si polipropileni ose PTFE duhet të shmangen sepse analitet mund të absorbohen në këto materiale.

Për analizën e PAH-ve në kakao dhe produktet e prejardhura nga kakao, përcaktimi i përmbajtjes së yndyrës kryhet në përputhje me AOAC, Metodë zyrtare 963.15 për përcaktimin e përmbajtjes së yndyrës në kokrrat e kakaos dhe produkteve të prejardhura. Mund të aplikohen procedura ekuivalente të përcaktimit të yndyrës, për të cilat mund të demonstrohet se procedura e përcaktimit të yndyrës së përdorur siguron një vlerë të barabartë (ekuivalente) të përmbajtjes së yndyrës.

C.2.3. Trajtimi i mostrës siç është marrë në laborator

Mostra përfaqësuese duhet të bluhet imët (aty ku është e nevojshme) dhe të përzihet



tërësisht duke përdorur një proces që është demonstruar për arritjen e homogjenizimit të plotë.

C.2.4. Mostrat për qëllime testimi ose kontestimi

Mostrat për qëllime testimi ose raste kontestimi duhet të merren nga materiali i homogjenizuar përveç nëse kjo bie ndesh me rregullat për marrjen e mostrave për sa i përket të drejtave të operatorit të biznesit ushqimor.

C.3. METODAT E ANALIZËS

C.3.1. Përkufizimet

Do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

'r' = Përsëritshmëria, vlera nën të cilën diferenca absolute midis rezultateve të një testi të marrë në kushte të përsëritshmërisë (d.m.th. e njëjta mostër, i njëjti operator, i njëjti aparat, i njëjti laborator, dhe intervali i shkurtër kohor) duhet të qëndrojë brenda një probabiliteti specifik (zakonisht 95 %) dhe si rrjedhim $r = 2,8 \times sr$.

's_r' = Devijimi standard i llogaritur nga rezultatet e gjeneruara nën kushtet e përsëritshmërisë.

'RSD_r' = Devijimi standard relativ i llogaritur nga rezultatet e krijuara në kushtet e përsëritshmërisë $[(s_r / \bar{x}) \times 100]$.

'R' = Riprodhueshmëria vlera nën të cilën diferenca absolute midis rezultateve të vetme të testit të marra në kushte riprodhueshmërie (d.m.th. në material identik të marrë nga operatorë në laboratorë të ndryshëm, duke përdorur metodën e testimit të standardizuar), mund të pritët të jetë brenda një probabiliteti të caktuar (zakonisht 95 %); $R = 2,8 \times sR$.

'sR' = Devijimi standard, i llogaritur nga rezultatet në kushtet e riprodhueshmërisë.

'RSD_R' = Devijimi standard relativ i llogaritur nga rezultatet e gjeneruar në kushte riprodhueshmërie $[(s_R / \bar{x}) \times 100]$.

'LOD' = Limiti i zbulimit, përmbajtja më e vogël e matur, nga e cila është e mundur të konkludohet prania e analitit me siguri të arsyeshme statistikore.

'LOQ' = Limiti i kuantifikimit, përmbajtja më e ulët e analitit që mund të matet me siguri të arsyeshme statistikore.

'HORRAT (¹)_r' = RSD_r e vëzhguar r pjesëtuar me vlerën RSD_r të vlerësuar nga ekuacioni (i modifikuar) i Horëitz-it (²) {shih pikën C.3.3.1 ('Shënime për kriteret e performancës')} duke përdorur të supozim $r = 0,66 R$.

HORRAT (¹)_R = RSD_R e vëzhguar pjesëtuar me vlerën RSD_R e vlerësuar nga ekuacioni (i modifikuar) i Horëitz-it (²) {krh. pikën C.3.3.1 ('Shënime për kriterin e performancës ria')}.

'u' = Pasiguria standarde e kombinuar e matjes, e marrë duke përdorur pasiguritë individuale të matjes standarde të lidhura me sasitë hyrëse në një model matjeje (³).

'U' = Pasiguria e zgjeruar e matjes, duke përdorur një faktor mbulimi prej 2, i cili jep një nivel besimi prej afërsisht 95 % ($U = 2u$).



'Uf' = Pasiguria maksimale standarde e matjes.

C.3.2. Kërkesat e përgjithshme

Metodat analitike të përdorura për qëllime të kontrollit të ushqimit duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Aneksit III të Urdhërit Nr. 382 datë 31.07.2006 Për miratimin e rregullores “Mbi organizimin e kontrolleve zyrtare të bëra për të verifikuar përputhjen me legjislacionin për ushqimin e njerëzve e të kafshëve dhe rregullat për shëndetin si dhe mirëqenien e kafshëve”.

Metodat për analizën e kallajit total janë të përshtatshme për kontrollin e nivelet të kallajit inorganik.

Për analizën e plumbit në verë, metodat dhe rregullat e përcaktuara nga OIV (⁴) zbatohet në përputhje me nenin 80(5) të Rregullores (BE) Nr 1308/2013 (⁵).

Metodat për analizën e arsenikut total janë të përshtatshme për qëllimin e shqyrtimit për kontrollin e niveleve të arsenikut inorganik. Nëse përqëndrimi total i arsenikut është nën nivelin maksimal për arsenikun inorganik, nuk është i nevojshëm testimi i mëtejshëm dhe mostra konsiderohet të jetë në përputhje me nivelin maksimal për arsenikun inorganik. Nëse totali i përqëndrimit të arsenikut është në ose mbi nivelin maksimal për arsenikun inorganik, do të kryhet testimi vijues për të përcaktuar nëse përqëndrimi i arsenikut inorganik është mbi nivelin maksimal për të.

C.3.3. Kërkesat specifike

C.3.3.1. Kriteret e performancës

Aty ku nuk ka metoda specifike të përcaktuara në Bashkimin Evropian për përcaktimin e kontaminantëve në ushqime, laboratorët mund të zgjedhin një metodë të validuar (ku duhet të përdorë material reference të certifikuar) ku të provojë plotësimin e kriterëve specifike të performancës të përcaktuara në Tabelat 5 deri 7.

(a) Kriteret e performancës për metodat e analizës për plumbin, kadmiumin, mërkur, kallaj inorganik dhe arsenik inorganik.

Tabela 5

Parametri	Kriteri			
Zbatueshmëria	Ushqimet e specifikuar në pikën 4.3 të shtojcës në Udhëzimin Nr. 1, datë 5.2.2016 “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore”			
Specifikimi	Pa ndërhyrje matricore ose spektrale			
Përsëritshmëria (RSD _r)	HORRAT _r më pak se sa 2 HORRAT _r më pak se 2			
Riprodhueshmëria (RSD _R)	HORRAT _R më pak se 2			
Rimëkëmbja	Dispozitat e pikës D.1.2. aplikoni			
ZOT	= tre të dhjetat e LOQ			
LOQ	Kallaj Inorganik	≤ 10 mg/kg		
	Plumbi	ML ≤ 0,02 mg/kg	0,02 < ML < 0,1 mg/kg	ML ≥ 0,1 mg/kg
		≤ ML	≤ dy të tretat e ML	≤ një e pesta e të ML



Kadmim, mërkur, arsenik inorganik	ML ≤ 0,02 mg/kg	0,02 < ML < 0,1 mg/kg	ML është ≥ 0,1 mg/kg
	≤ dy të pestat e ML	≤ dy të pestat e ML	≤ një e pesta e të ML

(b) Kriteret e performancës për metodat e analizës për esteret e acideve yndyrore 3-monokloro propan-1,2-diol (3-MCPD), 3-MCPD dhe esteret e acidit yndyror glicidil:

- Kriteret e performancës për metodat e analizës për 3-MCPD në ushqimet e specifikuar në pikën 4.3 të shtojcës, në Udhëzimin Nr. 1, datë 5.2.2016 “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore”.

Tabela 6a

Parametri	Kriteri
Zbatueshmëria	Ushqimet e specifikuar në pikën 4.3 të shtojcës në Udhëzimin Nr. 1, datë 5.2.2016 “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore”
Specifikimi	Pa ndërhyrje matricore ose spektrale
Fusha boshllëqe	Më pak se LOD
Përsëritshmëria (RSD _r)	0,66 herë RSD _R siç rrjedh nga ekuacioni (i modifikuar) i Horëitz-it
Riprodhueshmëria (RSD _R)	siç rrjedh nga ekuacioni (i modifikuar) i Horëitz-it
Rifitimi	75-110 %
Limiti i zbulimit (LOD)	≤ 5 µg/kg (në bazë të lëndës së thatë)
Limiti i Kuantifikimit (LOQ)	≤ 10 µg/kg (në bazë të lëndës së thatë)

- Kriteret e performancës për metodat e analizës për 3-MCPD në ushqimet e specifikuar në pikën 4.3 të shtojcës në Udhëzimin Nr. 1, datë 5.2.2016 “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore”.

Tabela 6b

Parametri	Kriteri
Zbatueshmëria	Ushqimet e specifikuar në pikën 4.3 të shtojcës në Udhëzimin Nr. 1, datë 5.2.2016 “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore”
Specifikimi	Pa ndërhyrje matricore ose spektrale
Fusha boshllëqe	Më pak se ZOT



Përsëritshmëria (RSD_r)	0,66 herë RSD_R siç rrjedh nga ekuacioni (i modifikuar) i Horëitz-it
Riprodhueshmëria (RSD_R)	si të përfuara nga ekuacioni (i modifikuar) i Horëitz-it
Rimëkëmbja	75-110 %
Kufiri e Zbulim (LOD)	$\leq 7 \mu\text{g/kg}$
Kufiri e Kuantifikimi (LOQ)	$\leq 14 \mu\text{g/kg}$

- Kriteret e performancës për metodat e analiza për 3-MCPD acid yndyror esteret, të shprehura si 3-MCPD, në ushqimet e specifikuar në pikë 4.3 të shtojcës në Udhëzimin Nr. 1, datë 5.2.2016 “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore”.

Tabela 6c

Parametri	Kriteri
Zbatueshmëria	Ushqimet e specifikuar në pikën 4.3 të shtojcës në Udhëzimin Nr. 1, datë 5.2.2016 “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore”
Specifikimi	Pa ndërhyrje matricore ose spektrale
Përsëritshmëria (RSD_r)	0,66 herë RSD_R siç rrjedh nga ekuacioni (i modifikuar) i Horwitz-it
Riprodhueshmëria (RSD_R)	si të përfuara nga ekuacioni (i modifikuar) i Horwitz-it
Rimëkëmbja	70-125 %
Kufiri e Zbulimit (LOD)	Tre të dhjetat e LOQ
Kufiri e Kuantifikimi (LOQ) për ushqimet e specifikuar në 4.3.1 dhe 4.3.2	$\leq 100 \mu\text{g/kg}$ në vajra dhe yndyrat
Kufiri e Kuantifikimi (LOQ) për ushqimet e specifikuar në 4.3.3 dhe në 4.3.4 me a përmbajtjen e yndyrës $< 40 \%$.	$\leq$ dy të pestat e të ML
Kufiri e Kuantifikimi (LOQ) për ushqimet e specifikuar në 4.3.4 me a yndyrë përmbajtjen $\geq 40 \%$	$\leq 15 \mu\text{g/kg}$ yndyrë

- Kriteret e performancës për metodat e analizës për esteret e acideve yndyrore glicidil, të shprehura si glicidol, në ushqimet e specifikuar në pikën 4.2 të shtojcës në Udhëzimin Nr. 1, datë 5.2.2016 “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore”.



Tabela 6d

Parametri	Kriteri
Zbatueshmëria	Ushqimet e specifikuar në pikën 4.2 të shtojcës në Udhëzimin Nr. 1, datë 5.2.2016 “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore”
Specifikimi	Pa ndërhyrje matricore ose spektrale
Përsëritshmëria (RSD_r)	0,66 herë RSD_R siç rrjedh nga ekuacioni (i modifikuar) i Horwitz-it
Riprodhueshmëria (RSD_R)	siç rrjedh nga ekuacioni (i modifikuar) i Horwitz-it
Rifitimi	70-125 %
Kufiri e Zbulimit (LOD)	Tre të dhjetat e LOQ
Kufiri e Kuantifikimi (LOQ) për ushqimet e specifikuar në 4.2.1 dhe 4.2.2	$\leq 100 \mu\text{g/kg}$ në vajra dhe yndyrat
Limiti i Kuantifikimit (LOQ) për ushqimet e specifikuar në 4.2.3 me përmbajtje yndyre $< 65 \%$ dhe në 4.2.4 me përmbajtje yndyre $< 8 \%$	$\leq$ dy të pestat e të ML
Limiti i kuantifikimit (LOQ) për ushqimet e specifikuar në 4.2.3 me përmbajtje yndyre $\geq 65 \%$ dhe në 4.2.4 me një përmbajtje yndyre $\geq 8 \%$	$\leq 31 \mu\text{g/kg}$ yndyrë

(c) Kriteret e performancës për metodat e analizës për hidrokarburet aromatike policiklike: Katër hidrokarburet aromatike policiklike ndaj të cilave këto kritere aplikohen janë benzo (a) pireni, benz (a) antraceni, benzo (b) fluoranteni dhe kriseni.

Tabela 7

Parametri	Kriteri
Zbatueshmëria	Ushqimet specifikuar në Udhëzimin Nr. 1, datë 5.2.2016 “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore”
Specifikimi	Pa ndërhyrje matricore ose spektrale, verifikimi i zbulimit pozitiv



Përsëritshmëria (RSD_r)	HORRAT _r më pak se sa 2
Riprodhueshmëria (RSD_R)	HORRAT _R më pak se sa 2
Rifitimi	50-120 %
ZOT	$\leq 0,30 \mu\text{g/kg}$ për secilën nga katër substancat
LOQ	$\leq 0,90 \mu\text{g/kg}$ për secilën nga katër substancat

(ç) Kriteret e performancës për metodat e analizës për akrilamidin:

Tabela 8

Parametri	Kriteri
Zbatueshmëria	Të gjitha ushqimet
Specifikimi	Pa ndërhyrje matricore ose spektrale
Fusha bosh	Më pak se kufiri i zbulimit (LOD)
Përsëritshmëria (RSD_r)	0,66 herë RSD_R siç rrjedh nga ekuacioni (i modifikuar) i Horëitz-it
Riprodhueshmëria (RSD_R)	siç rrjedh nga ekuacioni (i modifikuar) i Horëitz-it
Rifitimi	75-110 %
Kufiri e Zbulimit (LOD)	Tre të dhjetat e LOQ
Kufiri e Kuantifikimi (LOQ)	Për ushqimet me nivele standarde $< 125 \mu\text{g/kg}$: $\leq$ dy të pestat e nivelit të standardit, megjithatë nuk kërkohet të jetë më pak se $20 \mu\text{g/kg}$ Për ushqimet me nivel standard $\geq 125 \mu\text{g/kg}$: $\leq 50 \mu\text{g/kg}$

(d) Kriteret e performancës për metodat e analizës për perklorat:

Tabela 9

Parametri	Kriteri
Zbatueshmëria	Të gjitha ushqimet
Specifikimi	Pa ndërhyrje matricore ose spektrale
Përsëritshmëria (RSD_r)	0,66 herë RSD_R siç rrjedh nga ekuacioni (i modifikuar) i Horëitz-it
Riprodhueshmëria (RSD_R)	si të përfuara nga ekuacioni (i modifikuar) i Horëitz-it
Rifitimi	70-110 %
Limiti i Zbulimit (LOD)	Tre të dhjetat e LOQ
Limiti i Kuantifikimit (LOQ)	$\leq$ dy të pestat e të ML

(e) Shënime për kriteret e performancës:

Ekuacioni i Horëitz ⁽¹⁾ (për përqendrimet $1,2 \times 10^{-7} \leq C \leq 0,138$) dhe ekuacioni i modifikuar i Horëitz ⁽²⁾ (për përqendrime $C < 1,2 \times 10^{-7}$) janë ekuacione preçize të përgjithësuara të cilat janë të pavarur nga analiti dhe matrica, por varet vetëm nga përqëndrimi për shumicën e metodave rutinë të analizës.

Ekuacioni (i modifikuar) i Horëitz-it për përqendrime $C < 1,2 \times 10^{-7}$:

$$RSD_R = 22 \%$$

ku:

- RSD_R është devijimi standard relativ i llogaritur nga rezultatet e gjeneruara nën kushtet e riprodhueshmërisë $[(s_R/\bar{X}) \times 100]$
- C është raporti i përqendrimit (dmth $1 = 100 \text{ g}/100 \text{ g}$, $0,001 = 1 \text{ 000 mg}/\text{kg}$). Ekuacioni i modifikuar i Horëitz-it zbatohet për përqendrime $C < 1,2 \times 10^{-7}$.

Ekuacioni Horëitz për përqendrime $1,2 \times 10^{-7} \leq C \leq 0,138$:

$$RSD_R = 2C (-0,15)$$

ku:

- RSD_R është të afërm standarde devijimi i llogaritur nga rezultatet e gjeneruara nën kushtet e riprodhueshmërisë

$$[(s_R/\bar{X}) \times 100]$$

--- C është raporti i përqendrimit (dmth $1 = 100 \text{ g}/100 \text{ g}$, $0,001 = 1 \text{ 000 mg}/\text{kg}$). Tek ekuacioni Horëitz zbatohet në përqendrime $1,2 \times 10^{-7} \leq C \leq 0,138$.

C.3.3.2. Qasja 'përshtatshmëri për qëllim'

Mendoj se duhet të shprehet: Aty ku ekziston një numër i kufizuar i metodave të validuara të analizës si alternativë, mund të përdoret për të vlerësuar përshtatshmërinë e metodës së analizës, Qasja "përshtatshmëri për qëllimin" ⁽¹⁾ Metodave të përshtatshme për kontrollin zyrtar prodhojnë rezultate brenda një pasigurie standarde të matjes (u) më pak se pasiguria standarde maksimale e matjes e llogaritur duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$Uf = (LOD/2)^2 + (aC)^2$$



ku:

- Uf është pasiguria maksimale standarde e matjes ($\mu\text{g/kg}$).
- LOD është limiti i zbulimit të metodës ($\mu\text{g/kg}$). LOD duhet të plotësojë kriteret e performancës të përcaktuara në pikën C.3.3.1 për përqëndrimin e interesit.
- C është përqëndrimi i interesit ($\mu\text{g/kg}$);
- α është një faktor numerik që duhet përdorur në varësi të vlerës së C. Vlerat që do të përdoren janë dhënë në tabelën 10.

Tabela 10

Vlerat numerike që do të përdoren për α si konstante në formulën e përcaktuar në këtë pikë, në varësi të përqëndrimit të interesit

C ($\mu\text{g/kg}$)	α
≤ 50	0,2
51-500	0,18
501-1 000	0,15
1 001-10 000	0,12
$> 10\ 000$	0,1

Analisti do të shënojë "Raportin mbi marrëdhënien midis rezultateve analitike, pasigurisë së matjes, faktorëve të rikuperimit dhe dispozitave të legjislacionit për ushqimin dhe ushqimin dhe kafshët" ⁽¹⁾.

PJESA D

RAPORTIMI DHE INTERPRETIMI I REZULTATEVE

D.1. RAPORTIMI

D.1.1. Shprehja e rezultateve

Rezultatet do të shprehen në të njëjtat njësi dhe në të njëjtat numra të shifrave të rëndësishme si nivelet maksimale të përcaktuara në Udhëzimin Nr. 1, datë 5.2.2016 “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore”.

D.1.2. Llogaritjet e rifitimit

Nëse zbatohet një hap ekstraktimi gjatë metodës analitike, rezultati analitik do të korrigjohet për rifitimin. Në këtë rast duhet të raportohet niveli i rifitimit.

Në rast se nuk zbatohet asnjë hap ekstraktimi në metodën analitike (p.sh. rasti i metaleve), rezultati mund të raportohet i pakorrigjuar për rifitim, nëse provat kryhen duke përdorur materialin e references së certifikuar, me një përqëndrim të njohur, do të arrihet pasiguria e matjes (d.m.th. saktësi e lartë e matjes). Në rast se rezultati raportohet i pakorrigjuar për rifitim, kjo duhet të përmendet.

D.1.3. Pasiguria e matjes

Rezultati analitik do të raportohet si $x \pm U$ ku x është rezultati analitik dhe U është pasiguria e zgjeruar e matjes, duke përdorur një faktor mbulimi prej 2, i cili jep një nivel besimi afërsisht 95% ($U = 2u$).

Analisti duhet të shënojë "Raportin mbi marrëdhënien midis rezultateve analitike, pasigurisë së matjes, faktorëve të rifitimit dhe dispozitave të legjislacionit për ushqimin dhe ushqimin për kafshë" ⁽²⁾.

D.2. INTERPRETIMI I REZULTATEVE

D.2.1. Pranimi i lotit/nënlotit

Loti ose nënloti pranohet nëse rezultati analitik i mostrave të laboratorit nuk e kalon nivelin maksimal përkatës siç përcaktohet në Udhëzimin Nr. 1, datë 5.2.2016 “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore”, duke marrë parasysh pasigurinë e zgjeruar të matjes dhe korrigjimin e rezultatit për rifitimin, nëse është aplikuar një hap ekstraktimi në metodën analitike të përdorur.

D.2.2. Refuzimi i lotit/nënlotit

Loti ose nënloti refuzohet nëse rezultati analitik i mostrës laboratorike tejkalon përtej dyshimit të arsyeshëm nivelin maksimal përkatës, siç përcaktohet në Udhëzimin Nr. 1, datë 5.2.2016 “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore”, duke marrë parasysh pasigurinë e zgjeruar të matjes dhe korrigjimin e rezultatit për rifitimin, nëse një hap ekstraktimi është zbatuar në metodën analitike të përdorur.

D.2.3. Zbatueshmëria

Rregullat aktuale të interpretimit do të zbatohen për rezultatin analitik të marrë nga mostra e analizuar. Në rastin e analizës për qëllime mbrojtjeje ose reference zbatohen standardet sipas legjislacionit në fuqi.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca



UDHËZIM
Nr. 2, datë 17.2.2023

**MBI PROGRAMET E KONTROLLIT PËR
MBETJET E PESTICIDEVE²**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të nenit 43, të pikës 7, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Programet e kontrollit për mbetjet e pesticideve të hartohen si pjesë e planit të kontrollit përkatës. Programi të përditësohet çdo vit.

2. Këto programe të bazohen në rrezik dhe të synojnë vlerësimin e ekspozimit të konsumatorëve në përputhje me nivelet maksimale të mbetjeve të pesticideve në ushqim dhe ushqim për kafshët me origjinë bimë dhe shtazore. Në program duhet të specifikohet si më poshtë:

a) *produktet që do të kampionohen;*
b) *numrin e mostrave që do të merren dhe analizat që do të kryhen;*

c) *pesticidet që do të analizohen;*
ç) *kriteret e aplikuar në hartimin e këtyre programeve, duke përfshirë:*

i. kombinimet pesticide-produkt që do të zgjidhen;

ii. numrin e mostrave të marra për produktet vendëse dhe jovendëse përkatësisht;

iii. konsumi i produkteve si pjesë e dietës kombëtare;

iv. programin e kontrollit; dhe

v. rezultatet e programeve të mëparshme të kontrollit.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

² Ky udhëzim është përafshuar pjesërisht me: rregullore e zbatimit të Komisionit (BE) 2021/1355, e datës 12 gusht 2021, “Mbi programet kombëtare shumëvjeçare të kontrollit për mbetjet e pesticideve që do të vendosen nga shtetet anëtare”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

UDHËZIM
Nr. 28, datë 24.2.2023

**MBI BASHKËPUNIMIN E
STRUKTURAVE TË MINISTRISË PËR
EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME,
MINISTRISË SË BRENDSHME DHE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE
EKONOMISË, PËR GARANCINË
FINANCIARE NË PROCEDURAT E
VLERËSIMIT TË VIZAVE PËR TË HUAJT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; nenit 18, pika 4, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”; si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; me qëllim harmonizimin e procedurave ndërmjet institucioneve përgjegjëse në procesin e përcaktimit të garancisë financiare, në vlerësimin e vizave për të huajt në Republikën e Shqipërisë,

UDHËZIJMË:

**I. INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË
PROCEDURËN E PËRCAKTIMIT TË GA-
RANCISË FINANCIARE NË VLERËSIMIN E
VIZAVE PËR TË HUAJT**

1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse, që bashkëpunojnë në procesin e përcaktimit të garancisë financiare në vlerësimin e vizave për të huajt në Republikën e Shqipërisë, janë:

a) Në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (më poshtë “MEPJ”) – Drejtoria e Çështjeve Konsullore (më poshtë “DÇK”) dhe Postet Konsullore (më poshtë “PDK”) të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit;

b) Në Ministrinë e Brendshme (më poshtë “MB”) – Departamenti për Kufirin dhe



Migracionin në Drejtorinë e Policisë së Shtetit (më poshtë “DKM”);

c) Ministria e Financave dhe Ekonomisë (më poshtë “MFE”).

2. Brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, secili nga autoritetet e sipërpërmendura bashkëvepron me institucionet e tjera për çështjet e trajtimit të aplikimeve për viza, për hyrjen, qëndrimin dhe tranzitim të huajve, sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

II. GARANCIA FINANCIARE

1. Garancia financiare depozitohet në llogarinë bankare të aplikantit nga vetë i huaji që aplikon për vizë, nga garanti i të huajit, ose nga ftuesi i tij në Republikën e Shqipërisë, duke dokumentuar, gjithashtu, nëpërmjet vërtetimit nga banka që nuk janë kryer derdhje të pajustificuara, në këtë llogari bankare, të paktën për 12 muajt e fundit.

2. Shuma e garancisë financiare që duhet të paraqitet në dokumentacionin për pajisjen me vizë nga i huaji, për rastet e përcaktuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të jetë të paktën 5000 (pesë mijë) lekë për ditë qëndrimi të kërkuar në vizë për personat mbi 18 vjeç dhe 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë për shtetasit nën 18 vjeç.

3. Garancia financiare për mbulimin e shpenzimeve të jetesës apo pasojat e një dëmi që mund të shkaktohet nga një veprim ose mosveprim i të huajit, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, për periudhën e vlefshmërisë së vizës, përcaktohet rast pas rasti, për vizat e tipit D, të specifikuara më poshtë:

- a) viza për të trajnuarin pa pagesë;
- b) viza për persona të vetëpunësuar;
- c) viza për punonjës lëvizës digjital;
- d) viza për investitorë;
- e) viza për përdorim të pasurisë së paluajtshme në pronësi;

- f) viza për pensionistë;

4. Në dokumentin e garancisë financiare, duhet të jetë e përcaktuar shuma e bazuar në legjislacion për mbulimin e shpenzimeve të jetesës, si dhe shuma për pasojat e një dëmi që mund të shkaktohet nga një veprim ose mosveprim i të huajit, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, e depozituar në të njëjtën llogari bankare, e cila nuk

mund të tërhiqet nga i huaji ose garantuesi i tij në Republikën e Shqipërisë, deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së vizës.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Brendshme/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSSHËM
Bledar Çuçi

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Olta Xhaçka

MINISTËR I FINANCEVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

URDHËR
Nr. 63, datë 17.2.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 90.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 2.3.2022, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”; referuar vizitës zyrtare të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit në Tokio,

URDHËROJ:

1. Znj. Vilma Bello, zëvendësministër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, të zëvendësojë përkohësisht znj. Mirela Kumbaro Furxhi, ministër i Turizmit dhe Mjedisit, në ushtrimin e kompetencave të saj.

2. Ky urdhër i shtrin efektet e tij nga data 20.2.2023 deri më datë 27.2.2023.



3. Ngarkohet zyra e Arkiv-Protokollit dhe të gjitha drejtoritë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

NJOFTIM
Nr. 2607, datë 24.2.2023

**MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË
MEMORANDUMI MIRËKUPTIMI ME
MBRETËRINË E BASHKUAR TË
BRITANISË SË MADHE DHE
IRLANDËS SË VERIUT**

Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Brendshme dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Brendshme për shkëmbimin e informacionit, për qëllime që lidhen me migracionin”, nënshkruar në Tiranë më 16.5.2022, ka hyrë në fuqi më datë 16.2.2023.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME
Gazmend Turdiu

VENDIM
Nr. 1, datë 23.1.2023

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Enina Kotoni, në datën 18.1.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 9 (Nj) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Jo më pak se një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësuar me autorizim nga Marash Logu.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar me autorizim nga Erind Mërkuri.

DEPUTETJA OLTA XHAÇKA, përfaqësuar me prokurë nga av. Genci Çifligu.

OBJEKTI: Zgjidhja e konfliktit të kompetencave ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10-ta e deputetëve.

Deklarimi i vendimeve nr. 83, datë 17.11.2022, “Për mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka”, dhe nr. 84, datë 17.11.2022, “Për miratimin e raportit të shumicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka”, të Kuvendit të Shqipërisë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 70, 71, 131, shkronja “ç”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 49, 50 dhe 51, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të jo më pak se një të dhjetës së deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, pjesë e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe deputetes Olta Xhaçka, të cilët kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I Rrethanat e çështjes

1. Në datën 20.6.2022, në bazë të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kërkuesi i është drejtuar Kuvendit me mocion për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes së Kuvendit, Olta Xhaçka, duke pretenduar ushtrimin nga kjo e fundit të funksionit të deputetes në kundërshtim me nenin 70, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës.

2. Me urdhrin nr. 57, datë 22.6.2022, Kryetaria e Kuvendit ka urdhëruar: *“1. Thirrjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, datë 24.6.2022, ora 10:30 në Kryesinë e Kuvendit. 2. Rendi i ditës është si më poshtë: Shqyrtimi i mocionit të 1/10 të deputetëve përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka.”*

3. Për shqyrtimin e mocionit të kërkuesit, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin (KRRMI) është mbledhur në datat 24.6.2022, 1.7.2022, 8.7.2022, 15.7.2022, 16.9.2022 dhe 19.10.2022, gjatë të cilave është bërë prezantimi i mocionit, janë paraqitur dokumentet shoqëruese, nismëtarët u janë përgjigjur pyetjeve të KRRMI-së dhe është dëgjuar mendimi i avokatit mbrojtës të deputetes Olta Xhaçka. Në mbledhjen e datës 16.9.2022 është konstatuar përfundimi i shqyrtimit të kërkesës, duke u lënë palëve një afat 2-javor për paraqitjen e raportit përfundimtar, i cili do t'i kalonte më pas për shqyrtim dhe miratim seancës plenare. Në mbledhjen e datës 19.10.2022 janë prezantuar raportet përfundimtare të përgatitura nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste. Në kushtet kur ndërmjet pakicës parlamentare dhe shumicës nuk është rënë dakord për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), raportet i kanë kaluar për shqyrtim seancës plenare të Kuvendit.

4. Me vendimin nr. 83, datë 17.11.2022, Kuvendi ka vendosur mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare në KRRMI, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka (*vendimi nr. 83/2022*), ndërsa me vendimin nr. 84, datë

17.11.2022, ka vendosur miratimin e raportit të shumicës parlamentare në KRRMI, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka (*vendimi nr. 84/2022*).

5. Në datën 18.11.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë sipas objektit, duke kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar mes tij dhe Kuvendit, si rrjedhojë e vendimmarrjeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022.

6. Në datën 5.12.2022 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit në datën 16.12.2022 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

7. Në datën 11.1.2023, subjekti i interesuar, deputetja Olta Xhaçka, ka paraqitur prova shtesë që kanë të bëjnë me publikimin nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve të vendimeve nr. 3/5, datë 29.3.2021, “Për miratimin e statusit “investim/investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit “Dremades Luxury Suites” me subjekt “AG.TCC” dhe nr. 3/9, datë 15.7.2021 të Komitetit të Investimeve Strategjike (*KIS*), “Për një ndryshim në vendimin nr. 3/5, datë 29.3.2021 të KIS, “Për miratimin e statusit “investim/investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit ‘Dremades Luxury Suites’ me subjekt ‘AG.TCC’” (*vendimet nr. 3/5, datë 29.3.2021 dhe nr. 3/9, datë 15.7.2021*), ndërsa në seancën e datës 18.1.2023 ka depozituar kërkesën e saj drejtuar Kryeministrit të vendit, në cilësinë e ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme, për mosmarrjen pjesë në shqyrtimin e projektvendimit, “Për lejimin e përdorimit të brigjeve dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në funksion të realizimit të projektit investues “Dremades Luxury Suites””, me qëllim shmangien e konfliktit të interesit.

II Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuesi** ka kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar mes tij dhe Kuvendit, si rrjedhojë e cenimit nga ky i fundit të së drejtës për të kërkuar konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetit, duke parashtruar:

Për legjitimitimin:



8.1 E drejta e tij për të kërkuar konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetit parashikohet në nenin 70, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës. Në referim të jurisprudencës kushtetuese Kuvendi është i detyruar të vendosë dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatë, e cila është organi i vetëm që ka kompetencë për të shqyrtuar çështjen në themel.

Për themelin e kërkesës:

8.2 Neni 70, pika 2, i Kushtetutës i ka deleguar në ligj rastet e posaçme të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, ndërsa sipas pikës 3 të këtij neni, funksioni i deputetit cilësohet i papajtueshëm me Kushtetutën kur ky i fundit ushtron aktivitet fitimprurës dhe të ardhurat nga ky aktivitet burojnë nga buxheti i shtetit.

8.3 Deputetja Olta Xhaça ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë me funksionin e deputetes, çka duhet të sjellë edhe përfundimin e mandatit të saj. Shoqëria tregtare “AG.TCC” sh.p.k., e administruar dhe me ortak të vetëm bashkëshortin e saj, ka përfutur statusin e investitorit strategjik për një projekt investues në Gjilekë të Bashkisë Himarë, masën mbështetëse të lejit të përdorimit të bregdetit për një periudhë 30-vjeçare, si dhe incentivën e reduktimit të TVSH-së.

8.4. Për operimin e strukturave turistike të projektit, shoqëria “AGTCC Hotel Management” sh.p.k., në emër të partneres së vëllait të deputetes, ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me shoqërinë “AG.TCC” sh.p.k., duke luajtur rolin e një shoqërie të dedikuar. Me vendim të Këshillit të Ministrave është konkretizuar dhënia e së drejtës së përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit për shoqërinë investuese, duke detyruar Bashkinë Himarë të lidhë kontratë me to.

8.5 Sipas nenit 74 të Kodit të Familjes (KF), shoqëria tregtare “AG.TCC” sh.p.k., si dhe të ardhurat e përfitimet e kësaj shoqërie konsiderohen pasuri edhe e deputetes. Lejimi i përdorimit të brigjeve të detit dhe zonës përkatëse të plazhit, në funksion të realizimit të projektit investues strategjik nga shoqëria “AG.TCC” sh.p.k., nënkupton kryerjen e veprimtarive fitimprurëse që burojnë nga pasuria e shtetit, çka është e ndaluar sipas neneve 5, 21, 24, 27, 28, 35 dhe 45 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar (ligji nr. 9367/2005).

8.6 Që në momentin e shpalljes fituese nga KQZ-ja, deputetja Olta Xhaça kishte detyrimin të shmangte çdo rast të papajtueshmërisë me mandatin e deputetit, si në drejtim të ndalimit të përfitimit të fondeve publike nga shoqëria tregtare, ashtu edhe në drejtim të papajtueshmërive të parashikuara në ligjin nr. 9367/2005.

9. **Subjekti i interesuar, Kuvendi,** ka propësuar se:

9.1 Pretendimet e kërkuarit në lidhje me pikën 2 të nenit 70 të Kushtetutës nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues. Gjykata ka kompetencë të vendosë vetëm për rastet e parashikuara në nenin 70, pika 3, të Kushtetutës, kur vetë deputeti, në mënyrë të drejtpërdrejtë, ka shkëlur rregullimin kushtetues të parashikuar në pikën 3, çka gjen pasqyrim edhe në nenin 119/1, pika 2, të Rregullores së Kuvendit. Juridiksioni i Gjykatës, sipas pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, kufizohet për veprimet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

9.2 Në rastin në shqyrtim, në përputhje me jurisprudencën kushtetuese, Kuvendi nuk ka analizuar provat e faktet, kompetencë kjo që i përket Gjykatës, por vetëm ka vlerësuar nëse mocioni i paraqitur plotëson kushtet formale.

9.3 Nga faktet e paraqitura nuk ka rezultuar që deputetja të ketë përfutur vetë pasuri të shtetit ose pushtetit vendor gjatë kohës së ushtrimit të mandatit të deputetit dhe për të e bashkëshortin e saj nuk plotësohen kriteret kushtetuese të parashikuara në nenin 70, pika 3, të Kushtetutës. Duke mos qenë para ndalimeve të kësaj dispozite kushtetuese, Kuvendi nuk kishte kompetencë të vendoste dërgimin e çështjes në Gjykatë. Për rrjedhojë, vendimet e kundërshtuara nuk kanë shkaktuar konflikt kompetence.

9.4 Neni 70, pika 3, i Kushtetutës ndalon ushtrimin e veprimtarive fitimprurëse që burojnë nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor për deputetët. Termi “deputet” në këtë dispozitë kushtetuese është i qartë dhe i kuptueshëm. Interpretimi që kërkuar i bën këtij termi sipas nenit 74 të KF-së e zëvendëson dhe e barazon atë me termin “bashkëshort”. Sipas kësaj qasjeje interpretative, Kuvendi mund të ndryshojë kuptimin e normave kushtetuese me ligj të zakonshëm, çka është e papranueshme, pasi KF-ja nuk mund t'i japë tjetër kuptim normës kushtetuese.



10. *Subjekti i interesuar, deputetja Olta Xhaçka*, ka prapësuar se:

10.1 Kërkuesi nuk legjitimohet në kërkesën e tij sipas objektit, pasi nenet 131, pika 1, shkronja “ç” e 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe neni 54 i ligjit nr. 8577/2000 kanë parashikuar të drejtën e një të pestës së deputetëve për të vënë në lëvizje Gjykatën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave. Neni 70, pika 4, i Kushtetutës i ka dhënë një të dhjetës së deputetëve të drejtën vetëm për të paraqitur mocion. Kjo dispozitë kushtetuese nuk e detyron Kuvendin të miratojë mocionin e pakicës dhe të vendosë dërgimin e çështjes në Gjykatë. Kompetencën për iniciimin, me kërkesë, të gjykimit kushtetues për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit e ka vetëm Kuvendi.

10.2 Kërkesa është paraqitur në Gjykatë jashtë afatit ligjor 3-mujor të parashikuar nga neni 66/a, pika 2, i ligjit nr. 8577/2000, çka bën që kërkesa e tij të mos shqyrtohet nga Gjykata, për shkak të rënies në dekadencë.

10.3 Kërkuesi nuk kërkon gjykimin e konfliktit të kompetencës, por gjykimin e kushtetutshmërisë së shkakut që e ka shkaktuar atë. Gjykata nuk mund të shprehet për thelbin e kërkesës, pasi në gjykimet e konfliktit të kompetencave ajo ka për funksion vetëm zgjidhjen e mosmarrëveshjes, duke shmangur gjykimin për shkakun përcaktues të lindjes së saj.

10.4 Deputetja dhe bashkëshorti i saj nuk kanë kryer veprime që kanë sjellë për pasojë ushtrimin e veprimtarisë fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as kanë fituar pasuri të këtyre. Kriteri formal i kërkuar nga Kushtetuta, që detyron Kuvendin për t’iu drejtuar Gjykatës, nuk ekziston. Nga ana tjetër, Kuvendi nuk ka vendosur për thelbin, por ka bërë vetëm vlerësim të aspekteve formale të mocionit.

10.5 Pavlefshmëria/mbarimi i mandatit të deputetes, sipas kërkesës, i referohet më tepër parashikimeve të nenit 70, pika 2, të Kushtetutës dhe neneve 21 e 24 të ligjit nr. 9367/2005, për shkak të marrjes nga shoqëria në pronësi të bashkëshortit të deputetes të statusit të investitorit strategjik në turizëm dhe dhënies të së drejtës për përdorimin e bregut të detit. Raste të tilla nuk përfshihen në juridiksionin e Gjykatës dhe, për rrjedhojë, Kuvendi nuk mund ta dërgojë çështjen në këtë Gjykatë.

10.6 Neni 70 i Kushtetutës është interpretuar nga kërkuesi në mënyrë të zgjeruar, në shkelje të qëllimit të ligjvënësit dhe detyrimeve të shtetit për garantimin e respektimit të thelbit të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Argumentet e parashtruara janë të përgjithshme dhe lënë hapësira për interpretime abuzive e arbitrare.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

11. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës dhe nenet 49, 50 dhe 51 të ligjit nr. 8577/2000, duke kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, si dhe shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022, të cilat janë bërë shkak për lindjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet tij, si subjekt i veçantë, i parashikuar në nenin 70, pika 4, të Kushtetutës, dhe Kuvendit. Sipas kërkuesit, në zbatim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, Kuvendi duhej t’ia kishte dërguar çështjen Gjykatës, në mënyrë që ajo të shprehej në lidhje me mocionin e tij për papajtueshmërinë me Kushtetutën të mandatit të deputetes.

12. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se neni 70, pika 3, i Kushtetutës zbatohet vetëm në rastet kur vetë deputeti ka kryer veprimtari fitimprurëse. Juridiksioni i Gjykatës, sipas pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, kufizohet për veprimet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni. Pretendimet e kërkuesit në lidhje me parashikimin e pikës 2 të nenit 70 të Kushtetutës nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues.

13. Subjekti i interesuar, deputetja Olta Xhaçka, ka prapësuar se edhe pse kërkuesi ka kërkuar gjykimin e konfliktit të kompetencës, në thelb kërkon konstatimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të mandatit të saj. Gjykata nuk mund të shprehet për shkakun e konfliktit të kompetencës, pasi në gjykime të tilla ajo ka për funksion vetëm zgjidhjen e mosmarrëveshjes, duke shmangur gjykimin për shkakun përcaktues të lindjes së saj. Pavlefshmëria/mbarimi i mandatit të deputetes, sipas kërkesës, u referohet më tepër parashikimeve të nenit 70, pika 2, të Kushtetutës dhe neneve 21 e 24 të ligjit nr. 9367/2005, për



shkak të marrjes nga shoqëria në pronësi të bashkëshortit të deputetes të statusit të investitorit strategjik në turizëm dhe dhënies të së drejtës për përdorimin e bregut të detit. Raste të tilla nuk përfshihen në juridiksionin e Gjykatës dhe, për rrjedhojë, Kuvendi nuk mund ta dërgojë çështjen në këtë Gjykatë.

14. Gjykata ka pohuar se juridiksioni kushtetues e merr përcaktimin e natyrës dhe kufijve të tij drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, sipas të cilit: *“1. Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. 2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.”*. Kjo dispozitë kushtetuese përcakton funksionin themelor të saj, që lidhet me dhënien e drejtësisë kushtetuese nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese, ndërkohë që juridiksioni kushtetues detajohet në dispozitat e tjera të Kushtetutës, ku veçanërisht neni 131 i saj parashikon kompetencën kushtetuese sipas natyrës së çështjes, por pa u kufizuar në të, për sa kohë që Gjykata ka për detyrë të vendosë edhe për çështje që janë të parashikuara shprehimisht në norma të tjera kushtetuese. Nëpërmjet interpretimit që u bën normave ose termave konkretë të Kushtetutës, Gjykata përcakton standardet kushtetuese mbi të cilat duhet të mbështetet veprimtaria e organeve kushtetuese dhe kërkesat në ushtrimin e veprimtarisë së tyre vendimmarrëse (*shih vendimet nr. 38, datë 9.12.2022; nr. 36, datë 4.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore. Kjo dispozitë kushtetuese përfshin jo vetëm mosmarrëveshjet që lindin në sferën e ndarjes klasike të pushteteve (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe pushtet qendror e qeverisje vendore), por edhe ato që mund të lindin midis organesh a subjektesh që nuk bëjnë pjesë, në mënyrë të përcaktuar e kategorike, në secilin prej tyre. Sipas Gjykatës, çdo organ juridiksional, qoftë si institucion ose organ pushteti, në kuptimin klasik administrativ të tij, apo dhe si subjekt që ushtron funksionet në një situatë pavarësie të plotë të garantuar nga Kushtetuta, mund të jetë palë në mosmarrëveshje kompetencash (*shih vendimet nr. 29, datë 21.10.2009; nr. 20, datë 4.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Një mosmarrëveshje kompetence që paraqitet për zgjidhje para Gjykatës duhet të ketë natyrë kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshira në konflikt të jenë nga ato që i njeh Kushtetuta dhe që kompetenca e pretenduar të parashikohet si e tillë. Në këtë mënyrë, gjykimi në Gjykatë përqendrohet pikësepari në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës për sa u takon funksioneve të nivelit kushtetues, duke gjetur dhe cilësuar si të papajtueshëm me Kushtetutën shkakun vendimtar që ka sjellë lindjen e mosmarrëveshjes. Në përfundim, Gjykata vendos se cilit organ të pushtetit i përket kompetenca për të cilën ka lindur mosmarrëveshja. Në këto raste është e domosdoshme të ketë një mosmarrëveshje konkrete, pasi zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk mund të bëhet me kontroll kushtetues *in abstracto* (*shih vendimet nr. 26, datë 25.5.2021; nr. 36, datë 1.6.2015; nr. 4, datë 1.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Sipas Gjykatës, mosmarrëveshja e kompetencës mund të shtrohet në dy raste: kur objekt i mosmarrëveshjes është ndërhyrja me akt normativ në kompetencat e një organi kushtetues, duke sjellë si pasojë pakësimin ose shtimin e kompetencave të tij; kur konflikti i mirëfilltë i kompetencave lidhet me faktin kur një ose disa organe nxjerrin akte që cenojnë sferën e kompetencave të organit tjetër. Në rastin e parë, objekt i mirëfilltë i gjykimit kushtetues është vlerësimi *in abstracto* nëse ky ndryshim i kompetencave ka cenuar parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve. Në rastin e dytë, objekt i mirëfilltë i gjykimit kushtetues është vlerësimi *in concreto* nëse akti ka prekur kompetencat e një organi tjetër (*shih vendimin nr. 26, datë 25.5.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se ekziston një mosmarrëveshje kompetencash midis subjekteve kushtetuese brenda të njëjtit pushtet - një të dhjetës së deputetëve, nga njëra anë, dhe Kuvendit, nga ana tjetër. Ky konflikt ndërmjet subjekteve është konkret dhe *prima facie* ka natyrë kushtetuese, pasi Kuvendi, si interpretues i parë i normës kushtetuese, ka nxjerrë vendimet përkatëse nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022, duke u shprehur për mënyrën se si e kupton normën kushtetuese, mënyrë e cila nga një e dhjeta e deputetëve është kuptuar se kufizon të drejtën kushtetuese të tyre, sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës. Në këto



kushte, në referim të nenit 131, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se ka juridiksion për të marrë në shqyrtim kërkesën e kërkuarit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, sipas objektit.

B. Për legjitimitimin e kërkuarit

19. Kërkuari ka pretenduar se legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës, pasi e drejta e tij për të kërkuar konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimin e mandatit të deputetit parashikohet në nenin 70, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës. Në referim të jurisprudencës kushtetuese, Kuvendi është i detyruar të vendosë dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatë, që është organi i vetëm që ka kompetencë për të shqyrtuar çështjen në themel.

20. Subjekti i interesuar, Kuvendi, nuk ka parashtruar pretendime në lidhje me legjitimitimin e kërkuarit sipas objektit.

21. Subjekti i interesuar, deputetja Olta Xhaçka, ka parashtruar se kërkuari nuk legjitimohet në kërkesën e tij, pasi nenet 131, pika 1, shkronja “ç” dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, si dhe neni 54 i ligjit nr. 8577/2000 kanë parashikuar të drejtën e një të pestës së deputetëve për të vënë në lëvizje Gjykatën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave. Një e dhjeta e deputetëve nuk përbën subjekt kushtetues, pasi neni 70, pika 4, i Kushtetutës i ka dhënë të drejtën vetëm për të paraqitur mocion, i cili, në vetvete, përbën propozim që i drejtohet Kuvendit. Kjo dispozitë kushtetuese nuk e detyron Kuvendin të miratojë mocionin e pakicës dhe të vendosë dërgimin e çështjes në Gjykatë. Kompetencën për iniciimin, me kërkesë, të gjykimit kushtetues për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit e ka vetëm Kuvendi.

22. Gjykata vlerëson të theksojë fillimisht se pavarësisht se si janë zhvilluar procedurat në Kuvend për shqyrtimin e mocionit, i cili ka pasur si qëllim ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes, pavlefshmëria dhe mbarimi i mandatit janë, në thelb, institute të ndryshme, që u referohen shkaqeve dhe procedurave të ndryshme, në kuptim të neneve 69, 70 dhe 71 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në rastin konkret, ashtu sikundër edhe palët ndërgjyqëse pohuan në seancë gjyqësore, thelbi i pretendimeve të parashtruara në mocion është i lidhur me mbarimin e ushtrimit të mandatit të deputetes, nëse konstatohet

papajtueshmëria, sikundër parashikon neni 70 i Kushtetutës.

23. Sipas pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij neni, i cili parashikon se deputetët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre, me mocion të Kryetarit të Kuvendit ose të një të dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatë, e cila konstaton papajtueshmërinë.

24. Gjatë interpretimit të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar parimin se norma e posaçme ka përparësi mbi normën e përgjithshme. Sipas saj, në rastet e procedurave për iniciimin e kontrollit kushtetues të pajtueshmërisë me detyrën dhe vlerësimin të mandatit të deputetit, dispozita e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës përbën normën e posaçme, për rrjedhojë ajo prevalon mbi parashikimin e përgjithshëm të neneve 131 dhe 134 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 72, datë 7.12.2016; nr. 7, datë 24.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Kushtetutëbërësi e ka ngritur në nivel kushtetues të drejtën e pakicës parlamentare (një e dhjeta e deputetëve) për të kërkuar vënien në lëvizje të Gjykatës, si shprehje e ushtrimit të pushtetit të saj kontrollues ndaj shumicës parlamentare. Duke i dhënë asaj një mbrojtje kushtetuese, kushtetutëbërësi ka evituar ndërhyrjen e shumicës në ushtrimin e kësaj të drejte, si dhe diskrecionin e shumicës në interpretimin dhe vlerësimin e saj, rast pas rasti (*shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Vënia në lëvizje e gjykimit kushtetues vetëm për rastin e verifikimit të papajtueshmërisë, sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, konsiderohet një instrument kontrolli ndaj pushtetit ligjvënës që kërkon gjykim nga kjo Gjykatë. Në jurisprudencën e saj, në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se në rast se Kuvendi vihet në lëvizje me mocion të Kryetarit ose një të dhjetës së anëtarëve të tij, në kuptim të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, ai duhet të vendosë dërgimin e çështjes në Gjykatë, që është organi i vetëm që ka kompetencën të shqyrtojë në themel çështjen dhe të vendosë mbi papajtueshmërinë e mandatit të deputetit (*shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se në datën 20.6.2022 kërkuari i është drejtuar



Kuvendit me mocion me objekt: *“Kërkohet ndjekja e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka.”*. Në përfundim, pas shqyrtimit në seancën plenare të datës 17.11.2022 të raporteve të përgatitura nga kërkuesi dhe shumica parlamentare, me vendimet nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022, Kuvendi ka vendosur mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare dhe miratimin e raportit të shumicës.

28. Në kuptim të sa më lart, Gjykata vlerëson se si rrjedhojë e vendimeve të kundërshtuara, ndërmjet kërkuesit, nga njëra anë, dhe Kuvendit, nga ana tjetër, ka lindur një mosmarrëveshje për ushtrimin e kompetencës kushtetuese, konkretisht të së drejtës për mocion të një të dhjetës së deputetëve që detyronte Kuvendin të vendoste dërgimin e çështjes në Gjykatë për shqyrtimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes, përveçse për arsye penguese formale. Pretendimet e kërkuesit se vendimet e Kuvendit nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 kanë krijuar konflikt kompetence, kanë natyrë kushtetuese dhe të drejtat e pretenduara si të cenuara parashikohen drejtpërdrejt nga Kushtetuta, çka përbën argument të mjaftueshëm për të legjitimuar kërkuesin në vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues në kuptim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës.

29. Nën dritën e analizës së mësipërme, Gjykata çmon se pretendimi i subjektit të interesuar, deputetes Olta Xhaçka, se kërkuesi nuk legjitimohet në kërkesën e tij sipas objektit, pasi nenet 131, pika 1, shkronja “ç” dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, si dhe neni 54 i ligjit nr. 8577/2000 kanë parashikuar të drejtën e një të pestës së deputetëve për të vënë në lëvizje Gjykatën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave, është i pabazuar.

30. Nga ana tjetër, Gjykata thekson se për sa u takon procedurave lidhur me mosmarrëveshjet e kompetencave, neni 55 i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 6-mujor për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë nga çasti i lindjes së konfliktit.

31. Subjekti i interesuar, deputetja Olta Xhaçka, ka pretenduar se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor. Sipas saj, në kuptim të nenit 70, pika 3, të Kushtetutës, kërkesa për deklarimin e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit nuk mund të ngrihet në çdo kohë. Neni 66/a i ligjit nr. 8577/2000, që lidhet me papajtueshmërinë e

mandatit të deputetit, ka parashikuar afate konkrete në këtë drejtim.

32. Gjykata vëren se në kundërshtim nga sa pretendohet nga ky subjekt, afati 3-mujor i parashikuar në nenin 66/a, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, që ka të bëjë me papajtueshmërinë në ushtrimin e mandatit të deputetit, nuk gjen zbatim në rastin konkret. Në thelb të mosmarrëveshjes të pretenduar të kompetencave qëndrojnë vendimet nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit për mosmiratimin në KRRMI të raportit të kërkuesit për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka dhe miratimin e raportit të shumicës parlamentare. Këto vendime mbajnë datën 17.11.2022, ndërsa kërkesa është depozituar në Gjykatë në datën 18.11.2022, brenda afatit ligjor të parashikuar për procedurën e gjykimit kushtetues për mosmarrëveshjet e kompetencave.

33. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, në kuptim të kompetencës kushtetuese të parashikuar nga neni 70, pika 4, i Kushtetutës, kërkuesi, si subjekt në konflikt, legjitimohet në kërkesën e tij për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar si rrjedhojë e vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit, përmes të cilave është vendosur mosdërgimi i çështjes në këtë Gjykatë.

C. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës të krijuar mes kërkuesit dhe Kuvendit të Shqipërisë, për shkak të vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit

34. Kërkuesi ka pretenduar se përmes vendimeve të kundërshtuara i është cenuar e drejta e garantuar nga neni 70, pika 4, i Kushtetutës dhe jurisprudenca kushtetuese për vënien në lëvizje, me mocion, të Kuvendit, i cili duhet të vendosë dërgimin e çështjes në Gjykatë për konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes. Sipas tij, gjatë ushtrimit të mandatit deputetja ka kryer veprime në shkelje të pikave 2 dhe 3 të nenit 70 të Kushtetutës.

35. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se nisja e procedurës për t’iu drejtuar Gjykatës ka të bëjë me ato raste kur vetë deputeti, nëpërmjet veprimeve të tij aktive, ka shkelur parashikimin kushtetues të pikës 3, çka gjen pasqyrim edhe në nenin 119/1, pika 2, të Rregullores së Kuvendit. Në rastin në shqyrtim ai nuk ka analizuar provat e faktet, kompetencë kjo që i përket Gjykatës, por



vetëm ka vlerësuar nëse mocioni i paraqitur plotëson kushtet formale.

36. Subjekti i interesuar, deputetja Olta Xhaçka, ka prapësuar se e drejta për të vënë në lëvizje Gjykatën i përket vetëm Kuvendit, ndërsa kërkuesi ka të drejtë vetëm për paraqitjen e mocionit dhe kjo e drejtë e tij nuk e detyron Kuvendin të dërgojë çështjen për shqyrtim në Gjykatë në çdo rast. Neni 70 i Kushtetutës është interpretuar nga kërkuesi në mënyrë të zgjeruar, në shkelje të qëllimit të ligjvënësit dhe detyrimeve të shtetit për garantimin e respektimit të thelbit të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

37. Për të arritur në një përfundim lidhur me ekzistencën ose jo të mosmarrëveshjes së pretenduar, Gjykata analizon se midis cilave organe ka lindur konflikti, cila është kompetenca që ushtrohet nga organi tjetër dhe në ç'mënyrë pengohet ushtrimi i saj ose në ç'mënyrë një organ e ushtron pa të drejtë një kompetencë të një organi tjetër (*shih vendimet nr. 26, datë 25.5.2021; nr. 54, datë 5.12.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Në praktikën e saj Gjykata ka zgjidhur edhe konfliktin e kompetencave të krijuar midis organit kushtetues, nga njëra anë, dhe një pjese të po këtij organi, nga ana tjetër. Në këtë kuptim, edhe pse brenda pushtetit legjislativ, Gjykata i ka njohur pakicës parlamentare autoritetin kushtetues të pavarur dhe të pakufizuar nga vullneti i shumicës, për të ushtruar kompetencat e parashikuara nga Kushtetuta (*shih vendimet nr. 57, datë 23.7.2015; nr. 30, datë 16.5.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Kushtetuta në nenin 70, pika 1 të saj, ka sanksionuar, para së gjithash, natyrën e mandatit përfaqësues të deputetit dhe ndalimin e mandatit detyrues. Gjithashtu, kjo normë kushtetuese, në pikat 2 dhe 3, përcakton rastet e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit, i cili në asnjë rast nuk mund të ushtrojë njëkohësisht asnjë detyrë tjetër shtetërore (përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave), nuk mund të kryejë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojë pasuri që burojnë nga këto të fundit, ndërsa sipas pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, për çdo shkelje të pikës 3 të këtij neni, me mocion të Kryetarit të Kuvendit ose një të dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë (*shih vendimin nr. 29, datë 30.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Në rastin në shqyrtim Gjykata vëren se në datën 28.5.2015 Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim nxitjen dhe tërheqjen e investimeve strategjike. Ligji ka parashikuar krijimin e KIS-it, si organ administrativ kolegjal pranë Këshillit të Ministrave, me kompetencë, ndër të tjera, dhënien e statusit të investitorit strategjik personave juridikë privatë, vendas ose të huaj, të cilët kërkojnë të realizojnë një projekt investues, të kualifikuar si strategjik sipas këtij ligji. Me vendimin nr. 3/5, datë 29.3.2021, KIS-i ka miratuar statusin “investim/investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit “Dremades Luxury Suites” me subjekt “AG.TCC” sh.p.k., në pronësi të bashkëshortit të deputetes, përmes të cilit shoqëria investuese ka përfutur masa mbështetëse për kryerjen e procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përsheptuara; asistencë në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit; mbështetje për konsolidimin e tokës dhe pronës ku ai do të zhvillohet; leje për përdorimin e brigjeve të detit dhe zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit për një afat 30-vjeçar. Me vendimin nr. 3/9, datë 15.7.2021, KIS-i ka miratuar statusin “investim/investitor strategjik procedurë e asistuar” për realizimin e këtij projekti, me subjekt shoqëritë “AG.TCC” sh.p.k. dhe “AGTCC Hotel Management” sh.p.k., për një periudhë 4-vjeçare, përveç afatit të lejimit të përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit. Me VKM-në nr. 137/2022, në miratimin e të cilës deputetja Olta Xhaçka nuk ka marrë pjesë për shkak të konfliktit të interesit, Këshilli i Ministrave ka vendosur lejimin e përdorimit të brigjeve dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në funksion të realizimit të projektit investues strategjik “Dremades Luxury Suites”.

40. Në datën 20.6.2022 kërkuesi i është drejtuar Kuvendit me mocion për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes së Kuvendit Olta Xhaçka, duke pretenduar ushtrimin nga kjo e fundit të funksionit të deputetes në kundërshtim me nenin 70, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës. Në përputhje me Rregulloren e Kuvendit mocioni i ka kaluar për shqyrtim fillimisht KRRMI-së. Në përfundim të shqyrtimit të tij janë përgatitur



raporte përfundimtare nga kërkuesi dhe shumica parlamentare.

41. Në raportin përfundimtar drejtuar KRRMI-së kërkuesi ka pretenduar se deputetja Olta Xhaçka ndodhet në kushtet e pavlefshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes, çka duhet të sjellë edhe përfundimin e tij. Sipas kërkuesit, shoqëria tregtare “AG.TCC” sh.p.k., në pronësi të bashkëshortit të saj, ka përfituar të drejtën për të kryer veprimtari fitimprurëse që burojnë nga pasuria e shtetit dhe e pushtetit vendor, çka bën që deputetja në fjalë të ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë së parashikuar nga neni 70, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se sipas jurisprudencës kushtetuese Kuvendi nuk vë në dyshim mocionin e paraqitur dhe nuk ia nënshtron atë debatit parlamentar, por në zbatim të saj dhe të nenit 119/1 të Rregullores ka detyrimin t’ia dërgojë çështjen Gjykatës (*shih raportin përfundimtar të kërkuesit drejtuar Kryetares së Kuvendit dhe KRRMI-së në datën 10.10.2022, faqet 13, 14, 17, 20*).

42. Nga ana tjetër, sipas shumicës parlamentare, ndërsa neni 70, pika 4, i Kushtetutës ka parashikuar se vënia në lëvizje e Gjykatës bëhet vetëm me vendim të Kuvendit, në marrjen e një vendimi të tillë ai nuk luan vetëm rolin e një noteri, që kthen një mocion në kërkesë drejtuar Gjykatës, pasi në një rast të tillë Kushtetuta do të parashikonte të drejtën e një të dhjetës së deputetëve ose të Kuvendit për t’iu drejtuar vetë Gjykatës, pa pasur nevojë të ndiqej një procedurë parlamentare. Pika 4 e nenit 70 të Kushtetutës i ka njohur Kuvendit të drejtën që, pa i hyrë çështjes në themel, të verifikojë nëse pretendimet e ngritura janë nga ato që parashikohen në nenin 70, pika 3, të Kushtetutës dhe të vendosë për dërgimin e çështjes në Gjykatë. Sipas shumicës, në aktet e depozituara nuk rezulton që për deputeten dhe për bashkëshortin e saj të plotësohen kriteret kushtetuese të parashikuara në nenin 70, pika 3, të Kushtetutës për vënien në lëvizje të Gjykatës, sipas pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës (*shih raportin përfundimtar të deputetëve të shumicës parlamentare drejtuar Kryetares së Kuvendit dhe KRRMI-së në datën 17.10.2022, faqet 29-33*).

43. Gjykata vëren se në mbështetje të nenit 70 të Kushtetutës dhe neneve 13, pika 7, 55 dhe 119/1 të Rregullores së tij, me vendimet nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 Kuvendi ka vendosur mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare dhe miratimin e raportit të shumicës me objekt

konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka, duke vendosur, në thelb, mosdërgimin në Gjykatë të çështjes për konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes.

44. Duke analizuar situatën juridike të krijuar, Gjykata konstaton se shkak i lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet kërkuesit, nga njëra anë, dhe Kuvendit, nga ana tjetër, si subjekte në konflikt, janë vendimet e këtij të fundit. Për rrjedhojë, objekt i vlerësimit të saj janë si vendimi nr. 83/2022, ashtu edhe ai nr. 84/2022, të cilat kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në të drejtën e kërkuesit që, bazuar në mocionin e tij, Kuvendi të vendosë t’i drejtohet Gjykatës. Në këtë kuptim, në çështjen në shqyrtim, detyrë e Gjykatës mbetet zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës përmes shqyrtimit të kushtetutshmërisë të vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit.

45. Sikundër u theksua edhe më lart, Gjykata ka vlerësuar se sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, Kuvendi nuk mund të vërë në diskutim mocionin e paraqitur dhe nuk mund t’ia nënshtrorë atë debatit parlamentar, por vendimmarrja e tij si organ kolegjal është e domosdoshme me qëllim vënien në lëvizje të kësaj Gjykate për t’u shprehur për themelin e çështjes, për sa kohë që pa një vendim të shumicës parlamentare Gjykata nuk mund të shqyrtojë kërkesa të tilla. Vendimmarrja e Kuvendit në raste të tilla është në funksion të legjitimitetit të këtij organi si një nga subjektet që mund të vërë në lëvizje juridiksionin kushtetues (*shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Gjykata vlerëson se domosdoshmëria e një vendimmarrjeje paraprake nga Kuvendi në raste të tilla duhet kuptuar edhe si një shfaqje e parimit të gjithëpranuar të autonomisë parlamentare. Ky parim nënkupton, midis të tjerash, që Kuvendi, si interpretuesi i parë i normës kushtetuese, gjatë zbatimit të saj ka autoritet fillestar për të shqyrtuar dhe gjykuar kërkesat për shkelje të prezumuara të rregullimit të nenit 70, pika 3, të Kushtetutës. Nga ana tjetër, ky parim nuk duhet kuptuar si një mundësi për Kuvendin që, përmes vendimeve të shumicës parlamentare, të kufizojë mundësinë e Gjykatës për t’u shprehur për themelin e çështjes. Kushtetuta e kufizon autonominë parlamentare për mbrojtjen e të drejtave të pakicave parlamentare dhe të deputetëve të veçantë. Për këtë arsye,



Kuvendi në këto raste nuk mund t'i hyjë themelit të çështjes, pra vlerësimi nëse veprimet konkrete të pretenduara të kryera nga deputeti janë të papajtueshme me mandatin e tij, sepse, në të kundërt, do të ndërhynte në kompetencat që kushtetutëbërësi ia ka njohur vetëm Gjykatës.

47. Gjykata ka pohuar se Kuvendi, sipas nenit 75, pika 2, të Kushtetutës, organizohet dhe funksionon sipas Rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve të tij. E drejta e Kuvendit për të miratuar rregullat e organizimit dhe të funksionimit të tij ka të bëjë me parimin themelor të autonomisë procedurale (normative dhe organizative) të tij, sipas të cilit Kuvendi duhet të ketë të drejtën ekskluzive për të rregulluar organizimin e tij, rolin e deputetëve, strukturën dhe procedurat e brendshme. Për shkak të parimit të vetërregullimit të Kuvendit, në parim Rregullorja e tij nuk i nënshtrohet kontrollit kushtetues nga Gjykata. Mosrespektimi i saj e bën veprimtarinë parlamentare antikushtetuese vetëm nëse janë prekur dispozita të nivelit kushtetues, që gjejnë pasqyrim në të, ndërsa për çështje të tjera Rregullorja e Kuvendit nuk mund të jetë objekt kontrolli kushtetues. Gjykata rithekson se Kuvendi është organi që me rregullore interpreton jo vetëm normat kushtetuese, por edhe normat e tjera të rregullores së tij në praktikën e rasteve konkrete. Në rastet kur Kuvendi ka bërë vetë interpretim të normave të rregullores së tij dhe kur këto norma nuk janë të parashikuara drejtpërdrejt nga Kushtetuta, por u takojnë interpretimeve e diskrecionit të atij organi, Gjykata Kushtetuese nuk mund të arrijë në konkluzione të ndryshme (*shih vendimin nr. 1, datë 16.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, ashtu siç pohuan edhe palët në gjykim, rregullimet e posaçme të nenit 119/1 të Rregullores së Kuvendit, sipas të cilave mocioni për të dërguar çështjen në Gjykatë për të konstatuar papajtueshmërinë e veprimtarisë së deputetit i nënshtrohet në Kuvend shqyrtimit juridiko-formal pa debat, përbëjnë reflektim të jurisprudencës kushtetuese mbi nenin 70, pika 4, të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata do ta analizojë procedurën e ndjekur nga Kuvendi në nivel kushtetues, duke mbajtur në konsideratë se mosmarrëveshja e palëve lidhet me kuptimin e ndryshëm të shqyrtimit juridiko-formal të mocionit.

49. Gjykata evidenton se termi “mocion” në Kushtetutë gjendet përveçse në nenin 70, pika 4 edhe në nenin 104 në lidhje me mocionin e besimit ndaj Këshillit të Ministrave dhe në nenin 105 të saj në lidhje me mocionin e mosbesimit ndaj Kryeministrit. Në këtë kuptim, mocioni është një instrument parlamentar që ka për qëllim të nxisë një diskutim në Kuvend për një çështje të caktuar dhe për të cilën duhet të ketë një vendimarrje nga ky i fundit. Pavarësisht se mocioni është një akt parlamentar i “drejtimit politik”, ai ka një pasojë juridike ngushtësisht të lidhur me çështjen në diskutim.

50. Gjykata ripohon se verifikimi dhe vlerësimi i kriterëve juridiko-formale të kërkesave të kësaj natyre është një çështje që i përket Kuvendit, ndërsa vlerësimi i meritës së çështjes, pra nëse me veprimet e tij deputeti ka shkelur parashikimin kushtetues të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, me pasojë konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit, është një çështje që i përket ekskluzivisht Gjykatës. Kjo Gjykatë ka theksuar edhe më parë se është organi i vetëm që ka kompetencën të vendosë nëse veprimet konkrete të një anëtarit të Kuvendit, kundër të cilit është iniciuar procedura për konstatimin e papajtueshmërisë me mandatin, janë në kundërshtim me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 44, datë 7.10.2011; nr. 29, datë 30.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

51. Edhe pse në përmbajtjen e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës nuk është përdorur termi “është i detyruar”, kjo nuk nënkupton se vlerësimi në këtë rast është në kompetencë të Kuvendit, por se vënia në lëvizje e Gjykatës kërkon një vendimarrje të këtij organi, e cila është produkt i seancës plenare, pas respektimit të procedurave parlamentare. Nëse do të pranohej një pushtet i tillë i pakufizuar i Kuvendit, atëherë parashikimi kushtetues do të zhvishej nga qëllimi i tij, çka do të përbënte një abuzim me pushtetin e shumicës dhe do të ishte në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe të balancimit ndërmjet pushteteve. Institucionalizimi i pushtetit të pakicës parlamentare, i materializuar në të drejtën për të kërkuar vënien në lëvizje të Gjykatës, është bërë nga kushtetutëbërësi me qëllim shmangien e qëndrimeve politike nga ana e shumicës parlamentare. Në rast se do të pranohej një interpretim i ndryshëm i kësaj norme, atëherë pakica parlamentare do të diskriminohej në raport



me shumicën parlamentare, për sa kohë që ushtrimi i së drejtës së saj kushtetuese, i garantuar në pikën 4 të nenit 70 të Kushtetutës, do të ishte në diskrecionin e kësaj të fundit (*shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Nën dritën e standardeve të sipërpërmendura, Gjykata rithekson se Kuvendi shqyrton vetëm nëse mocioni i paraqitur ka të bëjë me papajtueshmërinë e mandatit të deputetit. Shqyrtimi juridiko-formal do të thotë që organi juridiksional, në këtë rast Kuvendi, nuk zhvillon hetim për përcaktimin e fakteve, pra nuk shqyrton dhe debaton provat me qëllim përcaktimin e fakteve dhe rrethanave. Në këtë lloj procedure Kuvendi vlerëson *prima facie* nëse pretendimi i paraqitur në mocion është haptazi i pabazuar ose jo. Fakti që pretendimi i parashtruar në mocion nga një e dhjeta e deputetëve ose Kryetari i Kuvendit kundërshtohet nga një pjesë tjetër e deputetëve të Kuvendit, nuk duhet të përbëjë shkak për mosmiratimin e mocionit, sepse qëllimi i shqyrtimit juridiko-formal nuk është të vërtetojë papajtueshmërinë e mandatit të deputetit.

53. Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim, Gjykata konstaton se gjatë procedurës së vlerësimit të raporteve përfundimtare të paraqitura për diskutim në seancën plenare të datës 17.11.2022 nga kërkuesi dhe shumica parlamentare, me vendimet nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 Kuvendi ka vlerësuar se Gjykata nuk mund të investojë në shqyrtimin e çështjes, pasi nuk bëhej fjalë për veprime konkrete të deputetit që përbëjnë shkelje të nenit 70, pika 3, të Kushtetutës.

54. Në këndvështrim të sa më lart, si dhe rrethanave të rastit konkret, Gjykata vëren se Kuvendi nuk mund të vlerësojë në themel nëse deputetja në fjalë, përmes bashkëshortit të saj, ka kryer veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe nëse ka fituar pasuri të këtyre, si dhe nëse veprimet/mosveprimet e deputetes, përmes bashkëshortit të saj, përbëjnë shkelje të pikës 2 ose të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës. Me fjalë të tjera, sipas Gjykatës, çështja e vlerësimit të papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes, e cila nëpërmjet bashkëshortit mund të ketë ushtruar veprimtari fitimprurëse që burojnë nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe të ketë fituar pasuri të këtyre, referuar fakteve, nuk i takon vlerësimit të Kuvendit, por vlerësimit të kësaj Gjykate, pasi ato

(faktet) kërkojnë shqyrtimin në themel, në mënyrë që të mund të përcaktohet nëse duhet të klasifikohen në parashikimet e nenit 70, pika 2 ose nenit 70, pika 3, të Kushtetutës.

55. Gjykata rithekson se në zbatim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit ka të drejtë të paraqesë mocion për konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetit, ndërsa vendimmarrja e Kuvendit është e domosdoshme me qëllim vënien në lëvizje të kësaj Gjykate për t'u shprehur për themelin e çështjes, për sa kohë që pa një vendim të këtij organi Gjykata nuk mund të shqyrtojë kërkesa të tilla.

56. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Kuvendi duhet të kishte pranuar mocionin e kërkuesit dhe të dërgonte çështjen për shqyrtim në këtë Gjykatë, në mënyrë që aspektet e pretenduara si papajtueshmëri të mandatit të deputetes Olta Xhaçka t'i nënshtroheshin vlerësimit kushtetues, pasi gjatë gjykimit kushtetues nuk u verifikua ndonjë pengesë juridiko-formale që mocioni të pengohej nga Kuvendi.

57. Bazuar në këto konsiderata, Gjykata çmon se vendimet e Kuvendit nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 për mosmiratimin e raportit përfundimtar të kërkuesit dhe miratimin e raportit përfundimtar të shumicës parlamentare për papajtueshmërinë e pretenduar të mandatit të deputetes, kanë cenuar të drejtën kushtetuese të një të dhjetës së deputetëve për të mos u penguar mocioni i tyre nga Kuvendi në kushtet e mosverifikimit të pengesave formale.

58. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë të bazuara dhe, si të tilla, duhet të pranohen.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “ç”, si dhe neneve 54, 55, 56, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Zgjidhjen e konfliktit/mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe



subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10-ta e deputetëve.

3. Shfuqizimin e vendimeve nr. 83, datë 17.11.2022, “Për mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka” dhe nr. 84, datë 17.11.2022, “Për miratimin e raportit të shumicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka” të Kuvendit të Shqipërisë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare

Marrë më 23.1.2023.

Shpallur më 22.2.2023.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim

Anëtarë kundër: Ilir Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci.

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen nr. 9 (Nj) 2022 të Regjistrimit Themeltar, me kërkuar jo më pak se një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit, jam kundër qëndrimit të shumicës që ka vendosur të pranojë kërkesën dhe të zgjidhë konfliktin/mosmarrëveshjen e kompetencës ndërmjet Kuvendit dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10-ta e deputetëve, duke shfuqizuar vendimet nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit, si të papajtueshme me Kushtetutën. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, parashtroj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tim kundër në këtë çështje.

2. Kërkuar, 1/10-ta e deputetëve, i është drejtuar Gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar mes tij dhe Kuvendit, si rrjedhojë e cenimit nga ky i fundit i së drejtës për të kërkuar konstatimin e papajtueshmërisë dhe

mbarimit të mandatit të deputetit. Subjekti i interesuar, deputetja Olta Xhaçka, ka parashtruar në prapësimet e saj se kërkuar nuk legjitimohet, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “ç” dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, si dhe nenit 54 të ligjit nr. 8577/2000, pasi 1/10-ta e deputetëve nuk përbën subjekt kushtetues, në kushtet kur neni 70, pika 4, i Kushtetutës i ka dhënë të drejtën vetëm për të paraqitur mocion, që, në vetvete, përbën një propozim që i drejtohet Kuvendit. Kjo dispozitë kushtetuese nuk e detyron Kuvendin të miratojë mocionin e pakicës dhe të vendosë dërgimin e çështjes në Gjykatë, pasi kompetencën për iniciimin, me kërkesë, të gjykimit kushtetues në këtë rast e ka vetëm Kuvendi.

3. Duke iu referuar jurisprudencës kushtetuese, konstatoj se gjatë shqyrtimit të çështjeve të kësaj natyre, me interpretimin që i ka bërë neni 70 të Kushtetutës, Gjykata ka synuar të përcaktojë juridiksionin e saj në lidhje me kontrollin e pajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit. Gjykata, bazuar në nenin 70, pika 3, të Kushtetutës, ka vlerësuar se shmangia e fitimeve/të ardhurave nga buxheti i shtetit është një detyrim që buron drejtpërdrejt nga kjo dispozitë, e cila ndalon shprehimisht jo vetëm kryerjen e veprimtarisë fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose pushtetit vendor, por edhe që “*të fitohen pasuri të këtyrë*”, pavarësisht mënyrës se si fitohen ato. Ndërsa sipas paragrafit 2 të nenit 70 Kushtetuta ua ka deleguar ligjeve të posaçme rastet e papajtueshmërisë, në pikën 3 të kësaj dispozite ka preferuar të vendosë ndalimin në rang kushtetues dhe ta cilësojë si të papajtueshëm me funksionin e deputetit ushtrimin e aktivitetit fitimprurës prej tij, kur të ardhurat nga ky aktivitet burojnë nga buxheti i shtetit. Ky ndalim është i shprehur qartë dhe pa ekuivok nga kushtetutëbërësi, i cili ka pasur si qëllim eliminimin e plotë të shkaqeve për ta konsideruar funksionin e deputetit si një mundësi të mirë për të shtuar burimin e të ardhurave private nëpërmjet pozitës së favorshme që ai ka si anëtar i organit më të lartë përfaqësues. Për çdo shkelje të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, kur kërkohet konstatimi i papajtueshmërisë me mandatin e deputetit, Kuvendi është i detyruar ta dërgojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese, e cila është organi i vetëm që ka kompetencën ta shqyrtojë në themel çështjen. Në raste të tilla hapësira e vlerësimit të Kuvendit lidhet vetëm me verifikimin



e kriterëve juridiko-formale, duke respektuar procedurat parlamentare të parashikuara në Rregulloren e këtij organi (shih vendimet nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 32, datë 3.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese).

4. Në kuptim të sa më sipër, shumica duhej të kishte përcaktuar fillimisht çështjen e juridiksionit të saj, në referim të dispozitës kushtetuese mbi të cilën është mbështetur mocioni dhe është vënë në lëvizje Kuvendi. Kjo merr rëndësi veçanërisht në rastin konkret, për sa kohë që në jurisprudencën kushtetuese janë përcaktuar dy organe të ndryshme që kanë juridiksion për shqyrtimin e rasteve të pajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit, Kuvendi në rastet e pikës 2 të nenit 70 dhe Gjykata Kushtetuese në rastet e pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës.

5. Siç shprehet edhe shumica, në jurisprudencën kushtetuese është vlerësuar, se: *“kushtetutëbërësi e ka ngritur në nivel kushtetues të drejtën e pakicës parlamentare (në këtë rast 1/10-ta e deputetëve) për të kërkuar vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, si shprehje të ushtrimit të pushtetit të saj kontrollues ndaj shumicës parlamentare. Duke i dhënë asaj një mbrojtje kushtetuese kushtetutëbërësi ka evituar ndërhyrjen e shumicës në ushtrimin e kësaj të drejte, si dhe diskrecionin e shumicës në interpretimin dhe vlerësimin e saj rast pas rasti. Në të tilla raste Kuvendi nuk mund të vërë në diskutim mocionin e paraqitur dhe nuk mund t’ia nënshtrijë atë debatit parlamentar, por vendimmarrja e tij si organ kolegjial është e domosdoshme me qëllim vënien në lëvizje të kësaj Gjykate për t’u shprehur për themelin e çështjes, për sa kohë që pa një vendim të shumicës parlamentare Gjykata nuk mund të shqyrtojë kërkesa të tilla. Vendimmarrja e Kuvendit në raste të tilla është në funksion të legjitimitetit të këtij organi si një nga subjektet që mund të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Kuvendi në këto raste nuk mund t’i hyjë themelit të çështjes, pra vlerësimin nëse veprimet konkrete të pretenduara të kryera nga deputeti janë të papajtueshme me mandatin e tij, sepse në të kundërt do të ndërhynte në kompetencat që kushtetutëbërësi ia ka njohur vetëm Gjykatës Kushtetuese. Edhe pse në përmbajtjen e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës nuk është përdorur termi “është i detyruar”, kjo nuk nënkupton se vlerësimi në këtë rast është në kompetencë të Kuvendit, por se vënia në lëvizje e Gjykatës kërkon një vendimmarrje të këtij organi, e cila është produkt i seancës plenare, pas respektimit të procedurave parlamentare. Nëse do të pranohet një pushtet i tillë i pakushtuar i Kuvendit, atëherë parashikimi kushtetues do të zhvishet nga qëllimi i tij, çka do të përbënte një abuzim me pushtetin e shumicës*

dhe do të ishte në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe të balancimit ndërmjet pushteteve. Institucionalizimi i pushtetit të pakicës parlamentare, i materializuar në të drejtën për të kërkuar vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, është bërë nga kushtetutëbërësi me qëllim shmangien e qëndrimeve politike nga ana e shumicës parlamentare. Në rast se do të pranohet një interpretim i ndryshëm i kësaj norme, atëherë pakica parlamentare do të diskriminohet në raport me shumicën parlamentare, për sa kohë që ushtrimi i së drejtës së saj kushtetuese, i garantuar në pikën 4 të nenit 70 të Kushtetutës, do të ishte në diskrecionin e kësaj të fundit.” (shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese).

6. Ky është argumenti mbi të cilin shumica ka konstatuar se ekziston një mosmarrëveshje kompetencash midis subjekteve kushtetuese brenda të njëjtit pushtet, 1/10-ës së deputetëve, nga njëra anë, dhe Kuvendit, nga ana tjetër, pra jo një konflikt mes pushtetesh, i cili *prima facie* ka natyrë kushtetuese. Kjo mosmarrëveshje ka lindur për ushtrimin e kompetencës kushtetuese, konkretisht të së drejtës për mocion të 1/10-ës së deputetëve që detyronte Kuvendin të vendoste dërgimin e çështjes në Gjykatë për shqyrtimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes, përveçse për arsye penguese formale. Sipas saj, pretendimet e kërkuarit se vendimet e Kuvendit nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 kanë krijuar konflikt kompetence, kanë natyrë kushtetuese dhe të drejtat e pretenduara të cenuara parashikohen drejtpërdrejt nga Kushtetuta, çka përbën argument të mjaftueshëm për të legjitimuar kërkuarin në vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues në kuptim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës (shih paragrafin 28 të vendimit).

7. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se një mosmarrëveshje kompetence që paraqitet për zgjidhje para Gjykatës Kushtetuese duhet të ketë natyrë kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshirë në konflikt të jenë nga ato që i njeh Kushtetuta dhe që kompetenca e pretenduar të parashikohet si e tillë. Në këtë mënyrë, gjykimi në Gjykatën Kushtetuese përqendrohet pikësepari në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës për sa u takon funksioneve të nivelit kushtetues (shih vendimet nr. 20, datë 4.5.2007; nr. 29, datë 21.12.2006, të Gjykatës Kushtetuese). Referuar juridiksionit të saj për shqyrtimin e konflikteve të kompetencave, Gjykata ka theksuar se çdo organ juridiksional, qoftë si institucion ose organ pushteti, në kuptimin



klasik administrativ të tij, apo dhe si subjekt që ushtron funksionet në një situatë pavarësie të plotë të garantuar nga Kushtetuta, konsiderohet i legjitimuar për të qenë palë në mosmarrëveshje pushtetesh. Gjatë shqyrtimit të këtyre kërkesave Gjykata analizon kuptimin e standardeve kushtetuese, si edhe pozitën kushtetuese në strukturën institucionale shtetërore të organit që pretendon mosmarrëveshjen, duke u ndalur veçanërisht në kompetencat kushtetuese e ligjore të atij organi, si dhe në ballafaqimin e këtyre kompetencave me ato të organit që pretendohet se ka marrë kompetencën, duke shkaktuar, për rrjedhojë, lindjen e mosmarrëveshjes.

8. Bazuar në këto standarde, në rastin konkret do duhej të ishte përcaktuar dhe arsyetuar nëse në këtë rast janë të pranishme të gjitha elementet e një mosmarrëveshjeje kompetencash. Konkretisht, duhej të përcaktohej se Kuvendi, si pushtet ligjvënës, e ka konsideruar veten kompetent për të vlerësuar dhe vendosur mbi çështje që janë kompetencë e pakicës parlamentare në kuptim të përmbajtjes së nenit 70 të Kushtetutës. Duke iu referuar rastit në shqyrtim, shumica nuk ka arritur të argumentojë se ndërmjet kërkuarit, 1/10-ta e deputetëve, nga njëra anë, dhe Kuvendit, nga ana tjetër, ka lindur në realitet një mosmarrëveshje për ushtrimin e së njëjtës kompetencë kushtetuese. Po ashtu, ajo nuk ka arritur të argumentojë se si e drejta e 1/10-ës të deputetëve konvertohet në një kompetencë kushtetuese, e cila në këtë rast është marrë nga Kuvendi, pra është mohuar ose është ushtruar nga vetë ky i fundit.

9. Siç arsyetohet edhe shumica, mocioni është një instrument parlamentar që ka për qëllim të nxisë një diskutim në Kuvend për një çështje të caktuar dhe për të cilën duhet të ketë një vendimarrje nga ky i fundit. Pavarësisht se mocioni është një akt parlamentar i “drejtimit politik”, ai ka një pasoje juridike ngushtësisht të lidhur me çështjen në diskutim (*shih paragrafin 49 të vendimit*). Referuar përkufizimit që i bëhet mocionit në procedurat parlamentare, ai është një propozim formal nga anëtarët e asamblesë parlamentare që ajo të ndërmarrë veprime të caktuara, pra një procedurë me anë të së cilës propozimet i paraqiten për shqyrtim dhe vlerësim asamblesë.³

10. Edhe në këtë kuptim, vlerësoj se e drejta e pakicës parlamentare, e identifikuar si një grupim që përbën 1/10-ën e deputetëve të Kuvendit, është garantuar në rastin konkret, pasi ajo ka vënë në lëvizje procedurat parlamentare për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit nga deputetja Olta Xhaçka. Përveç kësaj të drejte, e cila është ngritur në nivel kushtetues dhe është e mbrojtur kushtetutshmërisht, nuk është evidentuar nga shumica kompetenca kushtetuese që është cenuar në rastin konkret dhe për më tepër që ajo i përket këtij grupimi parlamentar.

11. Dua të evidentoj në këtë kuptim rastet e komisioneve hetimore, për të bërë dallimin mes kompetencave të natyrës kushtetuese që vihen në diskutim në të dyja rastet. Për sa u përket komisioneve hetimore Gjykata ka pranuar t'i shqyrtojë këto çështje në dritën e konfliktit të kompetencave, duke qenë se në këtë rast diskutohet ushtrimi i kompetencës së hetimit, që ka të bëjë me funksionin ligjvënës dhe atë të kontrollit të Kuvendit dhe që ushtrohet nga vetë pakica parlamentare, e cila përcakton objektin e hetimit, çështjet që do të hetohen dhe e ushtron atë nëpërmjet pjesëmarrjes në komisione dhe kryerjes së veprimeve konkrete hetimore sipas parashikimeve përkatëse ligjore. Në ndryshim nga to, në rastin konkret nuk ka asnjë kompetencë të nivelit kushtetues që është penguar të ushtrojë kërkuari, 1/10-ta e deputetëve. Të vetmet kompetenca të kësaj natyre (*kupto kushtetuese*) janë ajo e Kuvendit për të vlerësuar çështjen (hapësira e këtij vlerësimi) dhe e Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar në themel çështjen. Ndërkohë që mbrojtja kushtetuese e së drejtës së 1/10-ës së deputetëve për të paraqitur mocion nuk përbën argument të mjaftueshëm për të legjitimuar pakicën parlamentare në një konflikt kushtetues.

12. Në këtë situatë shumica duhej të bënte një analizë të hollësishme të kompetencës kushtetuese të secilit organ dhe të shkaqeve që kanë krijuar mosmarrëveshjen e kompetencës ndërmjet dy subjekteve kushtetuese, duke qenë detyrë e kësaj Gjykate zgjidhja e këtyre mosmarrëveshjeve me anë të eliminimit të shkaqeve që i kanë lindur ato. Shumica, duke mos përcaktuar se cila është kompetenca kushtetuese e pakicës parlamentare, pra e subjektit kushtetues që Kushtetuta i ka njohur një të drejtë të caktuar në këtë proces, nuk ka

³ <https://www.britannica.com/topic/motion-parliamentary-procedure>.



arritur as të zgjidhë këtë konflikt të pretenduar nëpërmjet eliminimit të shkaqeve të lindjes së tij.

13. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se organet që zbatojnë normat kushtetuese shfaqen edhe si interpretuesit e parë të normës kushtetuese. Duke iu referuar jurisprudencës kushtetuese të deritanishme, 1/10-ta e deputetëve, si subjekt kushtetues, nuk rezulton t'i jetë drejtuar më parë kësaj Gjykate me kërkesë për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave në raste të ngjashme, duke mos e legjitimuar veten më parë si subjekt në një konflikt të tillë me natyrë kushtetuese. Edhe pse ky subjekt ka marrë pjesë në gjykimin kushtetues në disa çështje që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë e mandatit të deputetit, rezulton që ai të jetë thirrur nga Gjykata si subjekt i interesuar (me kërkesë ose kryesisht) në kuptim të nenit 39, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, si subjekt që ka pasur interes të drejtpërdrejtë në çështje dhe jo si subjekt në mosmarrëveshje për kompetencë, në kuptim të shkronjës “ç” të këtij neni (*shih vendimet nr. 32, datë 3.6.2016; nr. 72, datë 7.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Më konkretisht, në vitin 2016 një grup deputetësh i ka kërkuar Kuvendit konstatimin e mbarimit të mandatit të deputetes V.L., në kuptim të nenit 70, pika 2, të Kushtetutës, kërkesë të cilën Kuvendi ka vendosur të mos e miratojë. Pas shpalljes së vendimit nr. 7, datë 24.2.2016, të Gjykatës, deputetët kërkuar nuk i janë drejtuar Gjykatës drejtpërdrejt me kërkesë për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave, por i kanë përsëritur Kuvendit kërkesën për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese. Në vijim të kësaj kërkesë, si dhe të kërkesës së vetë deputetit për vijimin e procedurës, Kuvendi ka marrë vendim për iniciimin e kontrollit kushtetues (*shih vendimin nr. 93, datë 17.5.2016, të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese*). Në të njëjtën mënyrë, në rastin e mandatit të deputetit R.S., për të cilin Kuvendi kishte vendosur fillimisht mosmiratimin e kërkesës së 20 deputetëve, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, 1/10-ta e deputetëve i është drejtuar sërish Kuvendit për të dërguar çështjen në këtë Gjykatë. Kuvendi, referuar kësaj kërkesë, si dhe kërkesës së vetë deputetit për vijimin e procedurave, ka vendosur të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues, ndërkohë që edhe në këtë rast 1/10-ta e deputetëve nuk ka iniciuar vetë një gjykim për zgjidhjen e konfliktit të

kompetencave (*shih vendimin nr. 72, datë 7.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata ka theksuar se vetëm në lidhje me ndalimin e pikës 3 të nenit 70 kushtetutëbërësi ka parashikuar vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, kurse për sa u takon rasteve të tjera të pajtueshmërisë, sipas paragrafit 2 të nenit 70 të Kushtetutës ose ligjeve tek të cilat ai referon, ajo nuk ka juridiksion. Pra konstatimi i pajtueshmërisë së mandatit të deputetit është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese vetëm në rastet e parashikuara nga neni 70, pika 3, i Kushtetutës, kurse për të gjitha rastet e tjera legjislatori ka parashikuar vetë Kuvendin si institucionin i cili vendos për heqjen ose jo të mandatit të deputetit (*shih vendimin nr. 72, datë 7.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Edhe në rastet e shkeljes së pikës 3 të nenit 70, norma kushtetuese dhe vetë Gjykata janë shprehur se Kryetari i Kuvendit ose 1/10 e anëtarëve të tij janë subjektet që iniciojnë procedurat parlamentare, kurse Kuvendi është subjekti i posaçëm që vë në lëvizje gjykimin kushtetues. Neni 70, pika 4, i Kushtetutës është një dispozitë me karakter procedural, që ka si qëllim të përcaktojë një rregullim të ndryshëm për mënyrën e vënies në lëvizje të kësaj Gjykate në rastet e shkeljes së paragrafit 3. Referuar përmbajtjes së normës kushtetuese rezulton se: Kuvendi vihet në lëvizje për shkeljen e pikave 2 dhe 3 të nenit 70 të Kushtetutës; Kuvendi vihet në lëvizje nga Kryetari i Kuvendit ose 1/10 e anëtarëve të tij; Kuvendi verifikon se çështja përfshihet në pikën 3 të nenit 70 dhe pasi verifikon kriteret formale dërgon çështjen në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton pajtueshmërinë; Kuvendi vlerëson se çështja përfshihet në pikën 2 të nenit 70 Kushtetutës dhe vlerëson vetë në themel çështjen.

17. Duke pasur parasysh sa më sipër, për sa kohë që juridiksioni për shqyrtimin e pajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit është i ndarë, dhe detyrimi për të dërguar çështjen në Gjykatën Kushtetuese vlen vetëm për rastet e pikës 3 të nenit 70, a jemi para një konflikti kompetencash nëse Kuvendi vlerëson vetë çështjen dhe vendos vetë për të? Duke qenë se kërkesa/mocioni për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese pranohet vetëm në rastet kur ai bazohet në pikën 3 të nenit 70, a gëzon të njëjtën mbrojtje kushtetuese e drejta e pakicës



(1/10-ta) në rastet kur kërkohet konstatimi i papajtueshmërisë sipas pikës 2 të këtij neni? Nga ana tjetër, kjo mbrojtje kushtetuese a vlen në të njëjtën mënyrë edhe për Kryetarin e Kuvendit, i cili ka të njëjtën të drejtë si 1/10-ta e deputetëve për të iniciuar procedurën parlamentare? Si subjekt që vë në lëvizje mocionin, duke pasur të njëjtin pozicion kushtetues dhe rol me një grup deputetësh (1/10-ta), a do të mund të ngrinte Kryetari i Kuvendit një konflikt kompetencash përpara Gjykatës, duke pretenduar cenimin e kompetencës së tij kushtetuese për t'iu drejtuar asaj? Këto pyetje do të duhej të ishin shtruar për diskutim dhe të ishin sqaruar nga shumica në vendimin e saj.

18. Sipas shumicës, Kuvendi nuk mund të vlerësojë në themel nëse deputetja në fjalë, përmes bashkëshortit të saj, ka kryer veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe nëse ka fituar pasuri të tyre, si dhe nëse veprimet/mosveprimet e deputetes, përmes bashkëshortit të saj, përbëjnë shkelje të pikës 2 ose të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës. Me fjalë të tjera, çështja e vlerësimit të papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes, e cila nëpërmjet bashkëshortit mund të ketë ushtruar veprimtari fitimprurëse që burojnë nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe të ketë fituar pasuri të këtyre, referuar fakteve, nuk i takon vlerësimit të Kuvendit, por vlerësimit të kësaj Gjykate, pasi ato (faktet) kërkojnë shqyrtimin në themel, në mënyrë që të mund të përcaktohet nëse duhet të klasifikohen në parashikimet e nenit 70, pika 2 ose nenit 70, pika 3, të Kushtetutës (*shih paragrafin 54 të vendimit*). Në rastin konkret Kuvendi duhet të kishte pranuar mocionin e kërkuar dhe të dërgonte çështjen për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, në mënyrë që aspektet e pretenduara si papajtueshmëri të mandatit të deputetes t'i nënshtroheshin vlerësimit kushtetues, pasi gjatë gjykimit kushtetues nuk u verifikua ndonjë pengesë juridiko-formale që mocioni të pengohej nga Kuvendi (*shih paragrafët 56 dhe 57 të vendimit*).

19. Ky qëndrim i shumicës mbart premisat për të krijuar paqartësi jo vetëm në ushtrimin e veprimtarisë parlamentare, por edhe në lidhje me juridiksionin përkatës të Gjykatës Kushtetuese dhe atij të Kuvendit. Gjykata ka vlerësuar se Kuvendi nuk mund t'i hyjë themelit të çështjes vetëm në kuptim të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, që i përket juridiksionit kushtetues. Qëndrimi i

shumicës, duke pranuar kërkesën dhe duke shfuqizuar vendimet e Kuvendit, pa përcaktuar nëse ato janë marrë në kundërshtim me kompetencat e tij ose me jurisprudencën kushtetuese, e cila ka përcaktuar rast pas rasti se cili është organi kompetent për të vendosur për këtë çështje, përbën devijim nga kjo jurisprudencë e konsoliduar, e cila nuk ka pranuar se Gjykata vihet në lëvizje në çdo rast nga Kuvendi dhe se është ajo organi që vlerëson nëse çështja përfshihet në fushën e veprimit të pikës 2 ose të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës. Duke mos arritur të përcaktojë juridiksionin e Gjykatës në këtë çështje, shumica nuk ka arritur të përcaktojë se ka pasur shkelje kushtetuese në procedurën e ndjekur nga Kuvendi. Duke mos përcaktuar se në rastin konkret çështja bën pjesë në juridiksionin kushtetues, nuk është arritur të përcaktohet as konflikti kushtetues dhe për më tepër pozicioni i 1/10-ës në këtë konflikt, pra as e drejta e saj për t'iu drejtuar Gjykatës, e cila lidhet vetëm me procedurën parlamentare të iniciuar sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës.

20. Shumica, bazuar në parimin e autonomisë parlamentare, shprehet më tej, se ai: *“nuk duhet kuptuar si një mundësi për Kuvendin që, përmes vendimeve të shumicës parlamentare, të kufizojë mundësinë e Gjykatës për t'u shprehur për themelin e çështjes. Kushtetuta e kufizon autonominë parlamentare për mbrojtjen e të drejtave të pakicave parlamentare dhe të deputetëve të veçantë. Për këtë arsye, Kuvendi në këto raste nuk mund t'i hyjë themelit të çështjes, pra vlerësimit nëse veprimet konkrete të pretenduara të kryera nga deputeti janë të papajtueshme me mandatin e tij, sepse, në të kundërt, do të ndërhynte në kompetencat që kushtetutëbërësi ia ka njohur vetëm Gjykatës”* (*shih paragrafin 46 të vendimit*).

21. Bazuar në këtë arsyetim konstatohet se, nga njëra anë, shumica ka vlerësuar se është cenuar e drejta e pakicës parlamentare për të kërkuar dërgimin e çështjes në Gjykatë, ndërkohë që ka evidentuar si kompetencë kushtetuese atë të Gjykatës për të shqyrtuar çështjen dhe për të vendosur në lidhje me themelin e saj. Edhe në vlerësimin tim, nëse do të kishim një konflikt kompetencash në këtë rast ai do të ishte mes dy organeve kushtetuese, Kuvendit dhe Gjykatës Kushtetuese, të cilat janë organet e vetme që kanë të drejtë të vendosin mbi këtë çështje, kompetencë kjo që nuk mund të mbrohet në gjykimin kushtetues nga një subjekt i ndryshëm, aq më pak nga 1/10-ta e deputetëve.



22. Duke vlerësuar megjithatë se procedura e zhvilluar nga Kuvendi nuk mund të përjashtohet nga kontrolli kushtetues, vlerësoj se e vetmja mënyrë për të vënë në lëvizje Gjykatën për kontrollin kushtetues është kërkesa e paraqitur në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se duke pasur parasysh statusin kushtetues të Kuvendit si organ përfaqësues i popullit, mund të konkludohet se në parim, kontrolli parlamentar i referohet gjithë aktivitetit shtetëror dhe të gjitha autoriteteve publike. Por një kompetencë e tillë nuk e transformon Kuvendin në një super-organ të pushtetit të shtetit (*shih vendimin nr. 22, datë 5.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Kushtetuta nuk mund të përjashtojë nga kontrolli kushtetues as procedurën që zhvillohet nga Kuvendi për rastet e pajtueshmërisë me mandatin e deputetit.

23. Në vendimin e saj nr. 7, datë 24.2.2016, Gjykata ka vlerësuar se një e pesta e deputetëve, si një nga subjektet e parashikuara në nenin 134 të Kushtetutës, nuk legjitimohet t’i drejtohet drejtpërdrejt Gjykatës për të kërkuar konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit, por në të tilla raste, në pajtim me pikën 4 të nenit 70 të Kushtetutës, Gjykata mund të vihet në lëvizje vetëm me vendim të Kuvendit. Në vlerësimin tim kjo nuk nënkupton se ky subjekt, në përfundim të procedurave parlamentare, nuk mund t’i drejtohet Gjykatës për të kërkuar kontrollin, në pikëpamje të kushtetutshmërisë, të procedurave parlamentare dhe vendimarrjes së Kuvendit. Pra, pika 4 e nenit 70 nuk përbën një pengesë absolute për të iniciuar gjykimin kushtetues, por kërkon shterimin fillimisht të procedurës parlamentare. Jo më kot, me ndryshimet që i janë bërë ligjit nr. 8577/2000, në nenin 66, pika 2, si subjekt kërkuar për shqyrtimin e pajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve është shtuar edhe 1/5-ta e deputetëve, subjekt ky që ka vënë aktualisht në lëvizje Gjykatën, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit, si të papajtueshme me Kushtetutën, si dhe konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka (kërkesa nr. 10 (Nj) 2022 e Regjistrat Themeltar). Për të mos lënë pa kontroll veprimtarinë e Kuvendit dhe duke pasur parasysh rolin e pakicës parlamentare, është vetëm ky subjekt kushtetues që ka të drejtën, në rastet kur Kuvendi nuk vendos në përputhje me normat

kushtetuese dhe jurisprudencën e kësaj Gjykate, të iniciojë një gjykim kushtetues në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës.

24. Për sa më sipër, në rastin konkret Gjykata duhej të kishte vendosur rrëzimin e kërkesës në shqyrtim. Përkundrazi, duke pranuar kërkesën e paraqitur nga 1/10-ta e deputetëve, vendimi i shumicës ka marrë natyrë formale, pasi nuk qartëson pozitën e Kuvendit dhe as juridiksionin të cilit i përket për shqyrtim kjo çështje, por në këtë mënyrë i ka hequr mundësinë Gjykatës që të vlerësojë në themel çështjen tjetër të paraqitur nga 1/5-ta e deputetëve, e cila vlerësoj se është mënyra e vetme për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues në rast se Kuvendi nuk vepron në përputhje me detyrimin kushtetues sipas pikave 3 dhe 4 të nenit 70 të Kushtetutës.

Anëtare: Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e kërkesës së jo më pak se një të dhjetës së deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, pjesë e grupit parlamentar të Partisë Demokratike, me objekt: “1. Zgjidhja e konfliktit të kompetencave ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10 e deputetëve. 2. Deklarimi i vendimeve nr. 83, datë 17.11.2022, “Për mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka” dhe nr. 84, datë 17.11.2022, “Për miratimin e raportit të shumicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka” të Kuvendit të Shqipërisë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, ne, gjyqtarët në pakicë, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica për sa i përket legjitimitetit të kërkuar dhe argumenteve të përdorura në funksion të këtij konkluzioni.

2. Për të arsyetuar mendimin e pakicës është e nevojshme që paraprakisht t’i referohemi qëndrimit të shumicës për zgjidhjen që i ka bërë çështjes në shqyrtim. Kështu, argumentin kryesor për legjitimitetin e kërkuar, shumica e ka bazuar në vendimin nr. 7, datë 24.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit: “Kushtetutëbërësi e ka ngritur në nivel kushtetues të drejtën e pakicës parlamentare”



(një e dhjeta e deputetëve) për të kërkuar vënien në lëvizje të Gjykatës, si shprehje të ushtrimit të pushtetit të saj kontrollues ndaj shumicës parlamentare.” Duke iu referuar të njëjtit vendim, shumica arsyeton “se në rast se Kuvendi vihet në lëvizje me mocion të Kryetarit ose një të dhjetës së anëtarëve të tij, në kuptim të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, ai duhet të vendosë dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila është organi i vetëm që ka kompetencën të shqyrtojë në themel çështjen dhe të vendosë mbi papajtueshmërinë e mandatit të deputetit” (shih paragrafët 25 dhe 26 të vendimit).

3. Në qëndrimin e mbajtur nga shumica, në vlerësimin tonë vlen të evidentohet një çështje thelbësore, ajo lidhur me legjitimitimin e një të dhjetës së deputetëve si një subjekt kushtetues që është cenuar në ushtrimin e kompetencës së tij, çështje kjo që vë në diskutim legjitimitetin e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese.

4. Lidhur me legjitimitimin si subjekt kushtetues të një të dhjetës së deputetëve për të kërkuar zgjidhjen e konfliktit të kompetencave ndërmjet këtij grupimi dhe Kuvendit të Shqipërisë, shumica fillimisht, ka evidentuar jurisprudencën e Gjykatës, sipas së cilës: “24. Gjatë interpretimit të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar parimin se norma e posaçme ka përparësi mbi normën e përgjithshme. Sipas saj, në rastet e procedurave për iniciimin e kontrollit kushtetues të pajtueshmërisë me detyrën dhe vlerësimin të mandatit të deputetit, dispozita e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës përbën normën e posaçme, për rrjedhojë ajo prevalon mbi parashikimin e përgjithshëm të neneve 131 dhe 134 të Kushtetutës (shih vendimet nr. 72, datë 7.12.2016; nr. 7, datë 24.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese). 25. Kushtetutëbërësi e ka ngritur në nivel kushtetues të drejtën e pakicës parlamentare (një e dhjeta e deputetëve) për të kërkuar vënien në lëvizje të Gjykatës, si shprehje të ushtrimit të pushtetit të saj kontrollues ndaj shumicës parlamentare. Duke i dhënë asaj një mbrojtje kushtetuese, kushtetutëbërësi ka evituar ndërhyrjen e shumicës në ushtrimin e kësaj të drejte, si dhe diskrecionin e shumicës në interpretimin dhe vlerësimin e saj rast pas rasti (shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese). 26. Vënia në lëvizje e gjykimit kushtetues vetëm për rastin e verifikimit të papajtueshmërisë sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës konsiderohet një instrument kontrolli ndaj pushtetit ligjvënës që kërkon gjykim nga kjo Gjykatë. Në jurisprudencën e saj në këtë drejtim Gjykata ka theksuar, se në rast se Kuvendi vihet në lëvizje me mocion të Kryetarit ose një të dhjetës së anëtarëve të tij, në kuptim të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, ai duhet të vendosë dërgimin e çështjes në

Gjykatën Kushtetuese, e cila është organi i vetëm që ka kompetencën të shqyrtojë në themel çështjen dhe të vendosë mbi papajtueshmërinë e mandatit të deputetit (shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese). 27. Vënia në lëvizje e gjykimit kushtetues vetëm për rastin e verifikimit të papajtueshmërisë sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës konsiderohet një instrument kontrolli ndaj pushtetit ligjvënës që kërkon gjykim nga kjo Gjykatë. Në jurisprudencën e saj në këtë drejtim Gjykata ka theksuar, se në rast se Kuvendi vihet në lëvizje me mocion të Kryetarit ose një të dhjetës së anëtarëve të tij, në kuptim të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, ai duhet të vendosë dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila është organi i vetëm që ka kompetencën të shqyrtojë në themel çështjen dhe të vendosë mbi papajtueshmërinë e mandatit të deputetit (shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese)”.

5. Shumica argumenton se vendimet e Kuvendit nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 i kanë cenuar një të dhjetës së deputetëve “të drejtën kushtetuese për të mos u penguar mocioni i tyre nga Kuvendi në kushtet e mosverifikimit të pengesave formale” (shih paragrafin 57 të vendimit). Shumica ka vlerësuar, se: “... si rrjedhojë e vendimeve të kundërshtuara, ndërmjet kërkesit, nga njëra anë, dhe Kuvendit, nga ana tjetër, ka lindur një mosmarrëveshje për ushtrimin e kompetencës kushtetuese, konkretisht të së drejtës për mocion të një të dhjetës së deputetëve që detyronte Kuvendin të vendoste dërgimin e çështjes në Gjykatë për shqyrtimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes, përveçse për arsye penguese formale. Pretendimet e kërkesit se vendimet e Kuvendit nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 kanë krijuar konflikt kompetence kanë natyrë kushtetuese dhe të drejtat e pretenduara si të cenuara parashikohen drejtpërdrejt nga Kushtetuta, çka përbën argument të mjaftueshëm për të legjitimuar kërkesin në vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues në kuptim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës” (shih paragrafin 28 të vendimit). Më tej, sipas shumicës, “Kuvendi nuk mund të vërë në diskutim mocionin e paraqitur dhe nuk mund t’ia nënshtrojë atë debatit parlamentar, por vendimmarrja e tij si organ kolegjial është e domosdoshme me qëllim vënien në lëvizje të kësaj Gjykate për t’u shprehur për themelin e çështjes, për sa kohë që pa një vendim të shumicës parlamentare Gjykata nuk mund të shqyrtojë kërkesa të tilla. Vendimmarrja e Kuvendit në raste të tilla është në funksion të legjitimitimit të këtij organi si një nga subjektet që mund të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues (shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese)” (shih paragrafin 45 të vendimit).



6. Ndërkohë, në lidhje me “mocionin”, shumica argumenton, se ai: *“është një instrument parlamentar që ka për qëllim të nxisë një diskutim në Kuvend për një çështje të caktuar dhe për të cilën duhet të ketë një vendimarrje nga ky i fundit. Pavarësisht se mocioni është një akt parlamentar i “drejtimit politik”, ai ka një pasojë juridike ngushtësisht të lidhur me çështjen në diskutim”* (sibh paragrafin 49 të vendimit).

7. Për sa më lart, argumenti kryesor mbi të cilin bazohet konkluzioni i shumicës për legjitimitimin e një të dhjetës së deputetëve është respektimi i të drejtave dhe garancive kushtetuese për pakicën parlamentare. Mendojmë se ka një konfondim nga shumica të jurisprudence kushtetuese në drejtim të rolit dhe funksionit që i është njohur pakicës parlamentare.

8. Në jurisprudence e saj Gjykata ka elaboruar pushtetin e pakicës parlamentare, duke pranuar një të katërtën e deputetëve si një subjekt kushtetues për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar. Gjykata ka vlerësuar se formulimi “është i detyruar”, i përdorur në nenin 77 të Kushtetutës, merr një tjetër kuptim dhe nuk interpretohet në të njëjtën mënyrë me rastin kur Kuvendi ka të drejtë të ngrejë një komision hetimor parlamentar. Përdorimi në Kushtetutë i shprehjes “është i detyruar”, jo vetëm që e vendos Kuvendin në një pozicion disi të veçantë, duke i hequr të drejtën për të vlerësuar vendimarrjen për ngritjen e komisionit hetimor, por, njëkohësisht, institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushtet i pakicës parlamentare (sibh vendimin nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese). Nëpërmjet shprehjes “është i detyruar” Kushtetuta ka evituar, veçanërisht për ngritjen e komisionit, kalimin e çështjes në procedurat e zakonshme të votimit, duke vendosur një balancë ndërmjet shumicës për të vendosur dhe së drejtës së pakicës së cilësuar. Nga ky këndvështrim i problemit, në atë vendim Gjykata ka konkluduar, se: *“e drejta e pakicës vetëm për sa i përket kërkesës për ngritjen e komisionit hetimor mbetet një e drejtë e pakufizuar nga vullneti i shumicës”*.

9. Vlerësojmë se qëndrimi i mbajtur nga Gjykata në vendimin nr. 18, datë 14.5.2003 përbën një jurisprudence kushtetuese, tashmë të konsoliduar, që lidhet me pushtetin e pakicës parlamentare për të ushtruar brenda funksionit të kontrollit parlamentar ngritjen e komisioneve të hetimit parlamentar, por që dallon nga të drejtat e tjera të pakicës parlamentare si pyetjet,

interpelancat, apo mocionet për debat. Mbi këtë kuptim që jurisprudence kushtetuese i ka dhënë pushtetit të pakicës parlamentare, thirrja për ndihmë e kësaj jurisprudence për të analizuar dhe për t'i dhënë të njëjtin kuptim me pushtetin e një të katërtës së deputetëve edhe mocionit të një të dhjetës së deputetëve për fillimin e procedurës që lidhet me verifikimin e rasteve të papajtueshmërisë së deputetit, mendojmë se nuk është në kohezion me jurisprudence e kësaj Gjykate.

10. Rasti në shqyrtim lidhet me verifikimin e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit. Interpretimi i pranuar nga shumica për pikën 4 të nenit 70 të Kushtetutës, se: *“Kuvendi nuk mund të vërë në diskutim mocionin e paraqitur dhe nuk mund t'ia nënshtrojë atë debatit parlamentar...”*, duke i dhënë Kuvendit një rol formal në këtë proces, në të vërtetë i ka hequr mundësinë pakicës parlamentare për të debatuar si në komisionin përkatës, ashtu edhe në seancën plenare.

11. Duke e pajisur një të dhjetën e deputetëve me një pushtet që në fakt Kushtetuta ia ka njohur një të katërtës së deputetëve, mendojmë se qëndrimi i shumicës bie ndesh me jurisprudence e konsoliduar kushtetuese të zgjidhjes së mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushteteve.

12. Shumica mban qëndrimin se ndërmjet një të dhjetës së deputetëve, nga njëra anë, dhe Kuvendit, nga ana tjetër, ka lindur një mosmarrëveshje për ushtrimin e kompetencës kushtetuese, konkretisht të së drejtës për të vënë në lëvizje Gjykatën për konstatimin e mbarimit të mandatit të deputetes. Sipas shumicës, *“pretendimet e kërkuarit se vendimet e Kuvendit nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 kanë krijuar konflikt kompetence kanë natyrë kushtetuese dhe të drejtat e pretenduara si të cenuara parashikohen drejtpërdrejt nga Kushtetuta”*, përbëjnë argument të mjaftueshëm për të legjitimuar kërkuarin për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues në kuptim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës” (sibh paragrafin 28 të vendimit). Ky qëndrim i mbajtur nga shumica, që i ka dhënë legjitimitet një të dhjetës së deputetëve për të vënë në lëvizje Gjykatën, mendojmë se nuk përputhet me jurisprudence e saj ndër vite.

13. Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushteteve është elaboruar gjerësisht nga Gjykata, duke analizuar natyrën e organeve mes të cilave ka lindur mosmarrëveshja, si dhe kompetencën ose mënyrën e ushtrimit të saj nga



organi tjetër. Sipas jurisprudencës kushtetuese, çdo organ juridiksional, qoftë si institucion ose organ pushteti, në kuptimin klasik administrativ të tij, apo edhe si subjekt që ushtron funksionet në një situatë pavarësie të plotë të garantuar nga Kushtetuta, konsiderohet i legjitimuar për të qenë palë në mosmarrëveshje pushtetesh. Thënë këtë, Gjykata ka pranuar si subjekte që legjitimohen në një konflikt pushtetesh jo vetëm organet juridiksionale, por edhe subjekte të tjera, por me kushtin që ato të ushtrjnë funksionet në mënyrë të pavarur. Përfshirja e një të katërtës së deputetëve në rrethin e subjekteve që legjitimohen për të nisur një gjykim kushtetues është bërë duke u nisur në radhë të parë me ushtrimin e këtij funksioni kushtetues në mënyrë të pavarur nga një grupim që ka një qëndrueshmëri edhe për numrin që përfaqëson, gjë të cilën nuk e ka një e dhjeta e deputetëve. Në vlerësimin tonë, përderisa Kushtetuta nuk ia ka dhënë as një të pestës së deputetëve të drejtën për të nisur një gjykim kushtetues për mosmarrëveshje pushtetesh, nuk mundet që këtë të drejtë ta gëzojë një numër edhe më i vogël, siç është një e dhjeta e deputetëve.

14. Nga ana tjetër, përcaktuese sipas jurisprudencës kushtetuese është që sfera e kompetencave të organeve ose subjekteve të konfliktuara duhet të jetë e përkufizuar nga norma kushtetuese (*shih vendimin nr. 29, datë 21.10.2009; nr. 20, datë 4.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Thënë kjo, kushti i dytë për të qenë një subjekt i legjitimuar në një mosmarrëveshje kompetence që paraqitet për zgjidhje para Gjykatës është natyra kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshira në konflikt të jenë nga ato subjekte që i njeh Kushtetuta dhe që kompetenca e pretenduar të parashikohet si e tillë. Pikërisht, kompetenca e një të katërtës së deputetëve që parashikohet në nenin 77 të Kushtetutës nuk mund të barazohet me natyrën, por edhe me qëllimin që ka paraqitja e një mocioni nga një e dhjeta e deputetëve, referuar nenit 70 të Kushtetutës. Sikurse vetë shumica pranon se mocioni është një instrument parlamentar që ka për qëllim të nxisë një diskutim në Kuvend për një çështje të caktuar dhe për të cilën duhet të ketë një vendimmarrje nga ky i fundit. Nga ky pohim del se mocioni, sipas nenit 70 të Kushtetutës, përfaqëson një të drejtë për të vënë në lëvizje Kuvendin për çështje që lidhen me papajtueshmërinë e mandatit të deputetit, për të cilën nga Kuvendi duhet të ketë

një vendimmarrje, lloji i së cilës nuk përcaktohet nga ushtrimi i së drejtës së mocionit. Pra, një e dhjeta e deputetëve ose Kryetari i Kuvendit nuk kanë kompetencë të vendosin dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese. Këtë kompetencë Kushtetuta, në nenin 70, pika 4, ia ka dhënë vetëm Kuvendit, i cili, nga ana tjetër, nuk është i detyruar të vendosë në këtë mënyrë vetëm për shkakun se është vënë në lëvizje nëpërmjet një mocioni të paraqitur nga ndonjë prej subjekteve që Kushtetuta ia ka njohur një të drejtë të tillë.

15. Në vijim, në rastet e shqyrtimit të kërkesave për mosmarrëveshje kompetencash, Gjykata ka vlerësuar të nevojshme të analizojë kuptimin e standardeve kushtetuese, pozitën kushtetuese në strukturën institucionale shtetërore të organit që pretendon mosmarrëveshjen, duke u ndalur veçanërisht në kompetencat kushtetuese e ligjore të atij organi, si dhe në ballafaqimin e këtyre kompetencave me ato të organit që pretendohet se ka marrë kompetencën dhe që ka shkaktuar lindjen e mosmarrëveshjes (*shih vendimin nr. 36, datë 1.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin e paraqitjes së kërkesës nga një e katërta e deputetëve, neni 77 i Kushtetutës ka formuluar qartësisht një kompetencë kushtetuese të këtij subjekti që detyron Kuvendin për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar, ndërkohë sipas nenit 70, pika 4, të saj, paraqitja e mocionit nga një e dhjeta nuk vendos ndonjë detyrim për Kuvendin për të dërguar çështjen në Gjykatën Kushtetuese.

16. Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim rezulton se shumica, ndryshe nga sa është pranuar në jurisprudencën kushtetuese lidhur me pushtetin e një të katërtës së deputetëve për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar, si zbatim i *parimit të betimit me votim pakice*, ka konsideruar mocionin e një të dhjetës së deputetëve si një kompetencë kushtetuese dhe këtë grupim si një subjekt në konflikt.

17. Shumica shkon edhe më tej kur pranon, se: *“vënia në lëvizje e gjykimit kushtetues vetëm për rastin e verifikimit të papajtueshmërisë sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës konsiderohet një instrument kontrolli ndaj pushtetit ligjvënës që kërkon gjykim nga kjo Gjykatë”* (*shih paragrafin 26 të vendimit*). Duke i dhënë mocionit të një të dhjetës së deputetëve, me të cilën fillon procedura e verifikimit të rasteve të papajtueshmërisë së deputetëve, natyrën e pushtetit të pakicës parlamentare, mendojmë se shumica, jo



vetëm që devijon nga qëndrimi që mban jurisprudenca kushtetuese, por pranon në këtë mënyrë se edhe mocioni i Kryetarit të Kuvendit barazohet me një kompetencë kushtetuese. Në fakt, mocioni i një të dhjetës apo edhe i Kryetarit të Kuvendit për pretendime për shkelje të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës nuk është gjë tjetër veçse një kërkesë për fillimin e një procedure verifikimi të rasteve të papajtueshmërisë së deputetit. Në rastin kur Kuvendi mund të vendoste mospranimin e mocionit të paraqitur nga një e dhjeta e deputetëve, sipas nenit 70, atëherë, në vlerësimin tonë, do të hynte në lojë e drejta e një të pestës së deputetëve si një subjekt i parashikuar nga neni 134 i Kushtetutës për të nisur një gjykim kushtetues. Kjo e drejtë kushtetuese e një të pestës së deputetëve është konkretizuar edhe në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese, pikërisht në seksionin “Procedura për shqyrtimin e zgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit të deputetit”, me ndryshimet që janë bërë me ligjin nr. 99/2016, ku në nenin 66, pika 2, tashmë parashikohet se, “Për shqyrtimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve të deputetëve, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Kuvendit ose të një të pestës së deputetëve”. Në këtë mënyrë, në vlerësimin tonë, do të gjente zgjidhje edhe ushtrimi i së drejtës nga pakica parlamentare ndaj një vendimi të Kuvendit që nuk dërgon çështjen në Gjykatën Kushtetuese.

18. Pranimi nga shumica se mocioni i një të dhjetës së deputetëve është i barabartë me pushtetin e pakicës parlamentare (një të katërtës) mendojmë se çon në zgjerimin e rrethit të subjekteve në konflikt edhe te Kryetari i Kuvendit për të kërkuar, në një rast të ngjashëm, zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet tij dhe Kuvendit dhe përse jo edhe të një deputeti të vetëm që ka nismën ligjvënësë. Ndaj, në vlerësimin tonë, qëndrimi i shumicës tejkalon jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës mbi legjitimitimin e subjekteve në konflikt për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës.

19. Parashikimi i nenit 77, pika 2, të Kushtetutës se mbi kërkesën e një të katërtës së deputetëve Kuvendi “është i detyruar të caktojë komision betim”, nuk mund të konsiderohet i njëjlojtë me formulimin e pikës 4, të nenit 70 të saj se “Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes...”. Në vlerësimin tonë, ky është një dallim i ndjeshëm mes këtyre formulimeve kushtetuese. Në fakt, qëndrimi i

mbajtur nga shumica ka marrë referencë nga vendimi nr. 7, datë 24.2.2016, ku ndryshe nga qëndrimet e mëparshme, Gjykata ka arsyetuar, se: “27. Kushtetutëbërësi e ka ngritur në nivel kushtetues të drejtën e pakicës parlamentare (një e dhjeta e deputetëve) për të kërkuar vënien në lëvizje të Gjykatës, si shprehje të ushtrimit të pushtetit të saj kontrollues ndaj shumicës parlamentare. Duke i dhënë asaj një mbrojtje kushtetuese kushtetutëbërësi ka evituar ndërhyrjen e shumicës në ushtrimin e kësaj të drejte, si dhe diskrecionin e shumicës në interpretimin dhe vlerësimin e saj rast pas rast?”.

20. Nisur nga ky qëndrim i mbajtur në rastin e mësipërm, ku Gjykata, nga njëra anë, nuk legjitimon një të pestën e deputetëve për të vënë në lëvizje atë për verifikimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetëve, sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës dhe, nga ana tjetër, në të njëjtin vendim i njehtë një të dhjetës së deputetëve pushtetin e pakicës parlamentare për të nisur një gjykim kushtetues për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushtetit të saj dhe Kuvendit, ne vlerësojmë se paraqitej e domosdoshme për shumicën që të mbante një qëndrim për të konsoliduar jurisprudencën kushtetuese, qoftë edhe duke pranuar ndryshimin e saj.

21. Për sa kohë qëndrimi i mbajtur nga Gjykata në vendimin nr. 7, datë 24.2.2016 nuk është në të njëjtën linjë me jurisprudencën e mëparshme kushtetuese, mendojmë se ky qëndrim do të duhet të korrigjohet. Thënë këtë, kemi në konsideratë se në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar, se: “në aspektin kushtetues është e pamundur dhe e palejueshme që doktrina kushtetuese zyrtare të riuinterpretohet në një mënyrë të tillë që ndryshon sistemin e vlerave të sanksionuara në Kushtetutë, që mohon pajtueshmërinë e vlerave me njëra-tjetrën, që redukton garancitë mbrojtëse të epërsisë së saj në sistemin juridik, që mohon konceptimin e Kushtetutës si një akt i vetëm dhe sistem harmonik, që redukton garancitë e të drejtave dhe lirive të sanksionuara dhe që ndryshon modelin e ndarjes së pushteteve të rregulluara në Kushtetutë. Çdo ndryshim i “precedentëve të Gjykatës Kushtetuese apo korrigjim i doktrinës kushtetuese zyrtare nuk mund të bëhet mbi bazën e faktorëve të rastit, siç mund të jetë edhe ndryshimi i përbërjes së saj” (shih vendimin nr. 21, datë 29.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese). Për sigurimin e vazhdimësisë së jurisprudencës kushtetuese është theksuar se, “Për bën një detyrim për Gjykatën, por, nga ana tjetër, në mënyrë të natyrshme jurisprudenca nuk mund të mos i nënshtrohet edhe evoluimit të saj. Nga kjo



pikëpamje, ekziston përherë mundësia që jurisprudenca, duke u plotësuar përmes konkluzioneve të reja interpretuese edhe të ndryshohet, por Gjykata thekson se një ndryshim i praktikës mund të realizohet nëse ekzistojnë arsye të forta që do ta justifikojnë një ndërmarrje të tillë dhe vetëm në rastet kur kjo është e paevitueshme, objektivisht e domosdoshme, si dhe kushtetutshmërisht e bazuar dhe e arsyetuar” (shtih vendimet nr. 20, datë 1.6.2011; nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 21, datë 29.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

22. Mbi këtë analizë, nisur nga fakti që qëndrimi i mbajtur nga Gjykata në vendimin nr. 7, datë 24.2.2016 duket që ka ndikuar ose detyruar shumicën edhe për zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi, si dhe për sa kohë ky qëndrim nuk është në përputhje me jurisprudencën e saj të mëparshme lidhur me natyrën e subjekteve në konflikt dhe me legjitimitetin e nisjes së një gjykimi kushtetues, ndërsa krijon hapësirë për mbajtjen e qëndrimeve krejt të ndryshme për raste të ngjashme, vlerësojmë se ai duhet të korrigojë duke u ndryshuar qëndrimi lidhur me natyrën e gjykimit sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës. Në vlerësimin tonë, rrethi i subjekteve që legjitimohen për të filluar një gjykim kushtetues janë të përcaktuar shprehimisht nga normat kushtetuese ndaj, në rastin në shqyrtim, një e dhjeta e deputetëve nuk legjitimohet për fillimin e një gjykimi kushtetues për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave.

Anëtarë: Sandër Beci, Ilir Toska

VENDIM

Nr. 2, datë 23.1.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare,
Marsida Xhaferllari	anëtare,
Fiona Papajorgji	anëtare,
Elsa Toska	anëtare,
Sandër Beci	anëtar,
Ilir Toska	anëtar,
Genti Ibrahim	anëtar,
Marjana Semini	anëtare,
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Blerina Basha, më datë 18.1.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare publike

Faqe| 3286

çështjen nr. 10 (Nj) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: NJË E PESTA E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar me autorizim nga Orion Nallbati dhe Franci Nuri.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar me autorizim nga Erind Mërkuri.

DEPUTETJA OLTA XHAÇKA, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga avokati Genci Çifligu.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 83, datë 17.11.2022, “Për mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka”, dhe nr. 84, datë 17.11.2022, “Për miratimin e raportit të shumicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka”, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka.

BAZA LIGJORE: nenet 4, 7, 70, 71, 124, 131, pika 1, shkronja “e” dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 66 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi pretendimet e kërkesit, një grup prej jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe deputetes Olta Xhaçka, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Fillimisht, një grup prej 14 deputetësh të Kuvendit, anëtarë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, në cilësinë e një të dhjetës së deputetëve, me shkresën nr. 2283 prot., datë 20.6.2022, ka paraqitur në Kuvend mocionin me objekt: *“Ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes zonja Olta Xhaçka” (mocioni i parë)*, duke pretenduar ushtrimin nga kjo e fundit të funksionit të deputetes në kundërshtim me nenin 70, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës.

2. Me urdhrin nr. 57, datë 22.6.2022, Kryetarja e Kuvendit ka urdhëruar: *“1. Thirrjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, datë 24.6.2022, ora 10:30 në Kryesinë e Kuvendit. 2. Rendi i ditës është si më poshtë: Shqyrtimi i mocionit të 1/10 të deputetëve përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka.”*

3. Për shqyrtimin e mocionit të këtij grupi deputetësh, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin (*këshilli*) është mbledhur më datë 24.6.2022, por mbledhja është shtyrë për datën 1.7.2022, me qëllim që deputetët të merrnin kohën e nevojshme për t'u njohur me materialet e mocionit.

4. Me shkresën nr. 2402, datë 1.7.2022, një grup tjetër, i përbërë nga 15 deputetë po të pakicës parlamentare, në cilësinë e një të dhjetës së deputetëve, kanë depozituar në Kuvend një kërkesë për mocion, drejtuar këshillit me të njëjtin objekt si më sipër, për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka (*mocioni i dytë*), duke pretenduar ushtrimin nga kjo e fundit të funksionit të deputetes në kundërshtim me nenin 70, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës.

5. Duke vlerësuar se të dyja mocionet kishin të njëjtin objekt dhe pothuajse të njëjtin dokumentacion mbi të cilin mbështeteshin pretendimet e parashtruara, në mbledhjen e datës 8.7.2022 këshilli ka vendosur bashkimin e kërkesave dhe shqyrtimin e tyre në të njëjtën procedurë.

6. Kërkesat dhe dokumentacioni bashkëshoqërues i mocioneve u janë vënë në dispozicion anëtarëve të këshillit dhe deputetes Olta Xhaçka. Gjatë mbledhjeve të këshillit, që kanë vijuar edhe në datat 8.7.2022 dhe 15.7.2022, është bërë prezantimi i mocioneve, janë paraqitur dokumentet shoqëruese, nismëtarët u janë përgjigjur pyetjeve dhe është dëgjuar mendimi i avokatit mbrojtës të deputetes Olta Xhaçka, i cili në mbledhjen e datës 8.7.2022 ka paraqitur parashtrime vetëm për mocionin e parë, ndërsa për të dytin ka kërkuar kohë.

7. Në mbledhjen e këshillit të datës 16.9.2022 është konstatuar përfundimi i shqyrtimit të kërkesës, dhe u është lënë palëve një afat 2-javor për paraqitjen e raportit përfundimtar, i cili do t'i kalonte më pas për shqyrtim e miratim seancës plenare. Në mbledhjen e datës 19.10.2022, përfaqësuesit në këshill të pakicës dhe të shumicës parlamentare kanë prezantuar raportet e tyre. Në raportin e saj pakica parlamentare ka konkluduar se mocioni i paraqitur plotësonte kriteret kushtetuese dhe Kuvendi kishte detyrimin për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), për sa kohë ky mocion kishte të bënte me kryerjen e veprimtarive fitimprurëse që buronin nga pasuria e shtetit, përkatësisht përdorimi i brigjeve të detit për instalimin e stacioneve të plazhit që do të siguronin të ardhura për kompaninë në bashkëpronësi të deputetes Olta Xhaçka dhe bashkëshortit të saj. Nga ana tjetër, shumica parlamentare në raportin e saj ka konkluduar se nga aktet e depozituara prej kërkuësve të të dy mocioneve nuk rezultonte që për deputeten Olta Xhaçka dhe bashkëshortin e saj të plotësoheshin kriteret kushtetuese të parashikuara në pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës (kryerja e veprimtarisë fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit dhe e pushtetit vendor dhe përfitimi i pasurive të këtyre të fundit) për vënien në lëvizje të Gjykatës sipas përcaktimeve të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës. Në kushtet kur ndërmjet përfaqësuesve të pakicës parlamentare dhe asaj të shumicës nuk është rënë dakord për dërgimin e çështjes në Gjykatë, raportet i kanë kaluar për shqyrtim seancës plenare të Kuvendit.

8. Me vendimin nr. 83, datë 17.11.2022, Kuvendi ka vendosur: *“Mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta*



Xhaçka” (vendimi nr. 83/2022), ndërsa me vendimin nr. 84, datë 17.11.2022, Kuvendi ka vendosur: *“Miratimin e raportit të shumicës parlamentare në Kështillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka”* (vendimi nr. 84/2022).

9. Me kërkesën e datës 18.11.2022, një grup prej 14 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjektit kushtetues një e dhjeta e deputetëve, në kuptim të pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës të krijuar mes tij dhe Kuvendit, të shkaktuar nga vendimmarrjet nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022, si dhe shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën, të këtyre akteve, të cilat janë bërë shkak për lindjen e këtij konflikti me natyrë kushtetuese.

10. Po më datë 18.11.2022, një grup tjetër prej 28 deputetësh të Kuvendit (*kërkuesi*), në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve, ka vënë në lëvizje Gjykatën për shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën, të vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit, si dhe konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka (*çështja objekt shqyrtimi*). Në lidhje me këtë kërkesë, Kolegji i Gjykatës më datë 7.12.2022 vendosi kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit më datë 16.12.2022 vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuesi** ka paraqitur, në mënyrë të përmbledhur, pretendimet si vijon:

11.1 Për juridiksionin e Gjykatës

11.1.1 Duke qenë se kërkitimi kryesor është shkëlja e nenit 70, pika 3, të Kushtetutës nga deputetja Olta Xhaçka, kërkuesi, bazuar në nenin 70, pika 4, të Kushtetutës, i është drejtuar fillimisht Kuvendit, i cili me vendimet nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 ka vendosur mosdërgimin e çështjes në Gjykatë. Për rrjedhojë, kërkuesi mund t'i drejtohet drejtpërdrejt Gjykatës për shfuqizimin e këtyre vendimeve dhe nëse pranohet ky kërkitim, duhet të pranohet edhe kërkitimi i dytë që lidhet me konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të

deputetes Olta Xhaçka. Në këto kushte, kjo çështje bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

11.2 Për legjitimitimin e kërkuesit

11.2.1 Kushtetuta ka njohur dy mënyra për vënien në lëvizje të Gjykatës për konstatimin e papajtueshmërisë së ushtrimit të funksionit të deputetit: ajo e parashikuar nga neni 70 i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata vihet në lëvizje me vendim të Kuvendit për shkeljet e pikës 3 të kësaj dispozite; ajo e parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “e” dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, ku me kërkesë të një të pestës së deputetëve Gjykata vendos për çështjet që lidhen me papajtueshmërinë e ushtrimit të funksionit të deputetit. Ky mekanizëm i dytë kushtetues përdoret për pretendimet në lidhje me ushtrimin e mandatit në kundërshtim me nenin 70, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës dhe në bazë të tij kërkuesi legjitimohet.

11.3 Për themelin e pretendimeve

11.3.1 Shumica parlamentare, duke vendosur mosdërgimin e çështjes në Gjykatë, ka abuzuar me pushtetin e saj, pasi ka vepruar në kundërshtim me parimin e ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve dhe interpretimin që i ka bërë jurisprudenca kushtetuese nenit 70, pika 4, të Kushtetutës. Deputetja Olta Xhaçka ka shkëlur përcaktimet e pikës 2 të nenit 70 të Kushtetutës, për shkak se ka qenë në kushtet e konfliktit të interesave, por edhe të pikës 3 të nenit 70, duke përfutur drejtpërsëdrejti të ardhura ose përfitime të tjera materiale nga pasuri/të mira publike.

11.3.2 Deputetja ka papajtueshmëri me detyrën, për shkak se subjekti privat i zotëruar nga bashkëshorti i saj ka ndërvepruar me organe shtetërore, duke përfutur disa të drejta dhe të mira publike nga veprimtaria e organeve publike që i kanë njohur statusin e investitorit strategjik. Për rrjedhojë, për shkak të cilësisë si bashkëshorte/subjekt i lidhur, edhe deputetja ka përfutur të mira materiale nga pasuria publike. Konkretisht, subjekti privat në pronësi të bashkëshortit të deputetes nga vendimi nr. 3/56, datë 29.3.2021 i KIS-it do të përfutojë: përdorimin për 30 vjet të brigjeve të detit, që janë pasuri publike; mbështetjen për kryerjen e procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përsheptuara; asistencën mbështetëse në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit; masën mbështetëse për



konsolidimin e tokës dhe pronësinë ku do zhvillohet projekti; aksesin në infrastrukturë; përfitimin e procesit të regjistrimit fillestar të zonës nga organet shtetërore falas dhe me procedurë të përshpejtuar.

11.3.3 Sipas dispozitave të Kodit të Familjes që rregullojnë regjimin martesor, çdo e ardhur e secilit bashkëshort pas martese konsiderohet si pjesë e bashkësisë ligjore. Veprimtaria tregtare e bashkëshortit të deputetes për ndërtimin e kompleksit turistik konsiderohet veprimtari tregtare e iniciuar pas martese, rrjedhimisht deputetja, si bashkëshorte, prezumohet bashkëpronare dhe përfituese e drejtpërdrejtë e çdo përfitimi ose të ardhure që vjen nga kjo veprimtari.

11.3.4 Paragrafi 3 i nenit 70 të Kushtetutës nuk mund të lexohet i shkëputur nga paragrafët e tjerë të këtij neni dhe në rastin konkret nuk mund të pretendohet se nuk janë shkelur edhe dispozitat ligjore të posaçme, sikundër janë ato të ligjit nr. 9637, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (*ligji nr. 9637/2005*), duke pasur parasysh pozicionin e saj si ministre, sikundër edhe faktin se ka marrë pjesë në një vendimmarrje të Këshillit të Ministrave që ka favorizuar dukshëm bashkëjetuesen e vëllait të saj, pra një familjare të drejtpërdrejtë.

12. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, në prapësimet e tij ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

12.1 Për juridiksionin e Gjykatës

12.1.1 Gjykata ka juridiksion vetëm për pretendimet për cenimin e pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, kurse rastet e parashikuara në pikën 2 të kësaj dispozite nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, i cili është i kufizuar vetëm në verifikimin e veprimtarisë fitimprurëse që kryhet drejtpërdrejt nga vetë deputeti. Ky qëndrim është mbajtur edhe në jurisprudencën kushtetuese.

12.2 Për legjitimitimin e kërkesës

12.2.1 Kërkuesi nuk legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës, pasi pavarësisht se parashikohet si subjekt në nenin 134 të Kushtetutës, në këtë rast gjen zbatim neni 70, pika 4, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata vihet në lëvizje vetëm me vendim të Kuvendit. Parashikimi i nenit 66, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 nuk duhet kuptuar si një e drejtë e pakushtëzuar, pasi sipas kësaj dispozite 1/5-ta e deputetëve vihet në lëvizje vetëm nëse Kuvendi

nuk vepron sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës. Në rastin konkret nuk jemi përpara kësaj situatë, pasi Kuvendi e ka shqyrtuar kërkesën për mocion të paraqitur nga deputetët.

12.2.2 Kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor të parashikuar në nenin 66/a, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, pra është paraqitur pas 3 muajve nga konstatimi i cenimit.

12.3 Për themelin e pretendimeve

12.3.1 Pika 3 e nenit 70 të Kushtetutës referon te përfitimi i pasurisë shtetërore drejtpërdrejt nga deputeti dhe jo nga të afërmit ose persona të tjerë të lidhur me të. Në këtë kuptim, ajo që Kushtetuta i ndalon deputetit është veprimtaria ekonomike që buron nga pasuria shtetërore ose e pushtetit vendor. Pra, që të kemi cenim të nenit 70, pika 3, të Kushtetutës, duhet të jetë vetë deputeti që në mënyrë të drejtpërdrejtë të kryejë veprimtari fitimprurëse, ndërkohë që deputetja Olta Xhaçka nuk ka përfituar drejtpërdrejt nga pasuria shtetërore ose ajo e pushtetit vendor.

12.3.2 Vendimet nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit janë marrë në zbatim të Kushtetutës dhe Rregullores së këtij organi. Kriteri formal i kërkuar nga Kushtetuta për të detyruar Kuvendin që t’i drejtohet Gjykatës për pavlefshmërinë/mbarimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka nuk ekziston, për shkak se nuk provohet fakti që prej saj të jetë kryer ndonjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as që të ketë fituar pasuri të këtyre të fundit.

13. Subjekti i interesuar, deputetja Olta Xhaçka, ka prapësuar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

13.1 Për juridiksionin e Gjykatës

13.1.1 Kërkuesi ka kundërshtuar në Gjykatë vendimet nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit, të cilat për nga natyra janë akte individuale dhe, si të tilla, nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues.

13.1.2 Rastet e parashikuara në pikën 2 të nenit 70 të Kushtetutës nuk hyjnë në juridiksionin e kësaj Gjykate. Kuvendi i drejtohet Gjykatës në ato raste kur pretendohet papajtueshmëria e mandatit si pasojë e shkeljes vetëm të paragrafit 3 të nenit 70 të Kushtetutës, pra kur vetë deputeti, me veprimet e tij, shkel ndalimin kushtetues të parashikuar në këtë dispozitë, duke kryer veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor



apo fiton pasuri të këtyre organeve. Vetëm në lidhje me këtë ndalim Kushtetuta ka parashikuar në pikën 4 të nenit 70 të saj vënien në lëvizje nga Kuvendi të gjyqimit kushtetues. Në mocionin e paraqitur në Kuvend, por edhe në kërkesën në shqyrtim, rezulton e provuar se shkeljet e pretenduara nuk janë kryer nga vetë deputetja Olta Xhaçka, për rrjedhojë nuk ka pasur ushtrim prej saj të veprimtarisë fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit, ndaj nuk jemi para rastit të parashikuar nga pika 3 e kësaj dispozite.

13.2 Për legjitimimin e kërkuar

13.2.1 Kushtetuta ka parashikuar dy mekanizma për të vënë në lëvizje Gjykatën, sipas nenit 70, pika 4 dhe sipas neneve 131, pika 1, shkronja “e” dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të saj. Sipas jurisprudencës kushtetuese, për rastet e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit ajo vihet në lëvizje vetëm me vendim të Kuvendit. Për sa kohë që Gjykata nuk është vënë në lëvizje sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, kërkuar nuk legjitimohet në kërkesën e tij. E drejta e 1/5-s së deputetëve për t’iu drejtuar Gjykatës, e parashikuar në nenin 66 të ligjit nr. 8577/2000, ka të bëjë me rastet e tjera të papajtueshmërisë së mandatit dhe nuk i përket rasteve të parashikuara nga neni 70, pika 3, i Kushtetutës.

13.2.2 Kërkesa është paraqitur jashtë afatit 3-mujor të përcaktuar në nenin 66/a, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, afat që fillon nga konstatimi i cenimit të papajtueshmërisë. Fitimi i statusit “investitor strategjik”, procedurë e asistuar prej shoqërisë “AG. TCC” sh.p.k. dhe i fitimit nga shoqëria “AGTCC HOTEL MANAGEMENT” sh.p.k. nëpërmjet VKM-së nr. 137/2022 është bërë e njohur botërisht më datë 2.3.2022 kur ky vendim është miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ky fakt është publikuar edhe nga BIRN-i më datë 2.3.2022. VKM-ja nr. 137/2022 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 37, datë 9.3.2022. Gjithashtu, njëri prej deputetëve nënshkrues të kërkesës i ka publikuar shkeljet e pretenduara nga deputetja Olta Xhaçka në faqen e tij në rrjetin social “Facebook” më datë 9.3.2022. Paraqitja e mocionit në Kuvend më datë 20.6.2022 nuk rivendos të drejtën e humbur për shkak të rënies së saj në dekadencë, pasi edhe paraqitja e këtij mocioni është bërë tej afatit të parashikuar nga neni 66/a i ligjit nr. 8577/2000.

13.3 Për themelin e pretendimeve

13.3.1 Vendimet nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit janë marrë në përputhje me parashikimet e Kushtetutës dhe me jurisprudencën kushtetuese. E gjithë sipërfaqja e truallit ku do të zhvillohet projekti për ngritjen e strukturës turistike është 100% në pronësi dhe me të drejta zhvillimore të shoqërisë “AG. TCC” sh.p.k., e cila këtë pronë e ka fituar nëpërmjet kontratave me subjekte private. Nuk rezulton që shoqëria “AG. TCC” sh.p.k. të ketë ushtruar, në kuptim të nenit 70, pika 3, të Kushtetutës, ndonjë veprimtari fitimprurëse me organet e pushtetit qendror ose vendor. Po kështu, nuk rezulton të jetë fituar ndonjë pasuri prej deputetes Olta Xhaçka ose prej shoqërisë “AG. TCC” sh.p.k., kuotat e së cilës, në kohën e kryerjes së këtyre veprimeve, zotëroheshin nga bashkëshorti i saj, shtetasi A.G.

13.3.2 Projekti Dreamades Luxury Suites investohet tërësisht me financim privat dhe është tërësisht në pronësi të shoqërisë “AG. TCC” sh.p.k., ndërsa përdorimin e plazhit, sipas VKM-së nr. 137/2022, e ka marrë një shoqëri tjetër, “AGTCC HOTEL MANAGEMENT”, e cila nuk rezulton të jetë në pronësi të bashkëshortit të deputetes dhe as në pronësi të saj. Vetë kërkuar pranon se përfitues i kontratës për përdorimin e bregut të detit nuk është subjekti tregtar në pronësi të bashkëshortit të deputetes.

13.3.3 Sipas ligjit nr. 55/2015 statusi i investitorit strategjik nuk konsiderohet ushtrim i veprimtarisë fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as fitim i ndonjë pasurie nga këto organe. Investimi është konsideruar strategjik vetëm për shkak të plotësimit të kriterëve ligjorë nga subjekti përfitues. Ndërkohë që ligji nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, nuk ndalon personat e lidhur me deputetin të ushtrojnë veprimtari private, por kufizon këtë të fundit në lidhje me interesin privat.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

14. Kërkuar ka parashtruar se çështja objekt shqyrtimi i takon juridiksionit të kësaj Gjykate, pasi ajo lidhet me shfuqizimin e vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit, si rezultat i të cilave



është vendosur mosdërgimi në Gjykatë i çështjes së konstatimit të papajtueshmërisë së mandatit të deputetes Olta Xhaçka, në një kohë kur Kuvendi është vënë në lëvizje me mocion sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës dhe pretendimi kryesor i mocionit ka qenë shkelja e nenit 70, pika 3, të Kushtetutës nga ajo deputete. Në këto kushte, kërkuesi mund t'i drejtohet drejtpërdrejt Gjykatës dhe nëse kjo e fundit pranon kërkimin në lidhje me shfuqizimin e vendimeve të kundërshtuara, rrjedhimisht duhet të pranojë edhe kërkimin e dytë që lidhet me papajtueshmërinë e mandatit të deputetes, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës.

15. Sipas subjektit të interesuar, Kuvendit, Gjykata ka juridiksion vetëm për pretendimet për cenimin e pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, kurse rastet e parashikuara në pikën 2 të kësaj dispozite nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, i cili është i kufizuar vetëm në verifikimin e veprimtarive fitimprurëse që kryhen nga vetë deputeti në mënyrë të drejtpërdrejtë, qëndrim ky i mbajtur edhe në jurisprudencën kushtetuese.

16. Sipas subjektit të interesuar, deputetes Olta Xhaçka, vendimet nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit, të kundërshtuara nga kërkuesi, për nga natyra janë akte individuale, e si të tilla, nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues. Po ashtu, edhe rastet e papajtueshmërisë të parashikuara në pikën 2 të nenit 70 të Kushtetutës nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues. Kuvendi i drejtohet Gjykatës në ato raste kur pretendohet papajtueshmëria e mandatit si pasojë e shkeljes vetëm të paragrafit 3 të nenit 70 të Kushtetutës, pra kur vetë deputeti, me veprimet e tij, shkel ndalimin kushtetues të parashikuar në këtë dispozitë, duke kryer veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor, apo fiton pasuri të këtyre organeve. Vetëm në lidhje me këtë ndalim Kushtetuta ka parashikuar në pikën 4 të nenit 70 të saj vënien në lëvizje nga Kuvendi të gjykimit kushtetues. Në vetë mocionin e paraqitur në Kuvend, por edhe në kërkesën në shqyrtim, rezulton e provuar se shkeljet e pretenduara nuk janë kryer nga vetë deputetja Olta Xhaçka, për rrjedhojë nuk ka pasur ushtrim prej saj të veprimtarisë fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit, ndaj nuk jemi para rastit të parashikuar nga pika 3 e kësaj dispozite.

17. Nisur nga natyra e pretendimeve të palëve, Gjykata do të analizojë fillimisht çështjen e

juridiksionit të saj kushtetues. Në këtë këndvështrim, referuar objektit të kërkesës në shqyrtim, vërehet se kërkuesi ka ngritur dy kërtime, atë për shfuqizimin e vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit (*kërkimi i parë*) dhe konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka (*kërkimi i dytë*). Për rrjedhojë, ajo do të vlerësojë çështjen e juridiksionit kushtetues veçmas për secilin nga këto kërtime të parashtruara asaj.

18. Në lidhje me *kërkimin e parë* Gjykata vëren se shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i dy vendimeve të Kuvendit ngrihet mbi pretendimin se ky i fundit, përmes shumicës parlamentare, ka vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 70 të Kushtetutës, që përcakton detyrimin e tij për dërgimin e çështjes në Gjykatë, sikurse është kërkuar në mocionin e paraqitur nga një e dhjeta e anëtarëve të tij. Sipas kërkuetit, shumica parlamentare, duke vendosur mosdërgimin e çështjes në Gjykatë, ka abuzuar me pushtetin e saj, pasi ka vepruar në kundërshtim me parimin e ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve dhe interpretimin që i ka bërë jurisprudenca kushtetuese nenit 70, pika 4, të Kushtetutës.

19. Gjykata konstaton se në të njëjtën ditë përpara saj janë regjistruar 2 kërkesa, me kërkuet një grup deputetësh të Kuvendit. Përveç kërkesës objekt shqyrtimi, një grup tjetër prej 14 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e 1/10-s së deputetëve, ka paraqitur kërkesë me objekt: “*Zgjidhja e konfliktit të kompetencave ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10 e deputetëve. Deklarimi i vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit të Shqipërisë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.*”. Kjo kërkesë është marrë në shqyrtim nga Gjykata në seancën plenare të datës 18.1.2022 dhe, në përfundim të shqyrtimit, me vendimin nr. 1, datë 23.1.2023, ajo ka vendosur: “*Pranimin e kërkesës. Zgjidhjen e konfliktit/mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10 e deputetëve. Shfuqizimin e vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit të Shqipërisë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.*” (shih vendimin nr. 1, datë 23.1.2023 të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë vendim, Gjykata ka arritur në përfundimin se dy vendimet e Kuvendit për mosmiratimin e raportit përfundimtar të kërkuetit dhe miratimin e raportit përfundimtar të



shumicës parlamentare, mbi papajtueshmërinë e pretenduar të mandatit të deputetes, objekt edhe i *kërkimit të parë* në këtë gjykim, janë të papajtueshme me Kushtetutën për shkak se kanë cenuar të drejtën kushtetuese të një të dhjetës së deputetëve për të mos u penguar mocioni i tyre nga Kuvendi në kushtet e mosverifikimit të pengesave formale.

20. Në rrethanat si më lart, Gjykata vëren se edhe pse në atë kërkesë të grupit prej 14 deputetësh është kërkuar specifikisht zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave, në thelb pretendimet e parashtruara dhe të shqyrtuara nga Gjykata kanë të bëjnë me të njëjtin proces të zhvilluar nga Kuvendi, që lidhet me konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka, që është objekt edhe i këtij gjykimi kushtetues, dhe me të njëjtën vendimmarrje të tij, pra vendimet nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022, që janë objekt kundërshtimi i kërkesës në shqyrtim.

21. Në kushtet kur me vendimin nr. 1/2023 Gjykata ia ka nënshtruar kontrollit të saj kushtetues vendimet e Kuvendit nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022, duke i shfuqizuar ato si të papajtueshme me Kushtetutën, pikërisht për sa kërkohet nëpërmjet *kërkimit të parë* në këtë shqyrtim, ajo vlerëson se ky kërkim tashmë ka mbetur pa objekt. Ndaj në mungesë të lëndës, shqyrtimi i *kërkimit të parë*, në rastin konkret, nuk mund të vazhdojë dhe për këtë shkak ai duhet të pushohet.

22. Lidhur me këtë përfundim Gjykata vlerëson se në kushtet kur një situatë e tillë nuk gjen rregullim të shprehur në ligjin e saj organik (ligjin nr. 8577/2000) dhe në rregulloren e saj (rregulloren për procedurat gjyqësore), në përputhje me nenin 1, pika 2, të ligjit organik bëhen të zbatueshme dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, në konsideratë të natyrës ligjore të çështjes. Duke qenë se natyra e çështjes i për afrohet lëndës administrative, Gjykata i referohet ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, i cili ndonëse nuk rregullon drejtpërdrejt situatën konkrete, në nenin 1, pika 2, të tij përcakton se me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe, dispozitat e tij plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile (KPC). Nisur nga kjo, Gjykata vlerëson se në rastin në shqyrtim janë të zbatueshme dispozitat e KPC-së, pikërisht neni 299, shkronja “c”, sipas të cilit

gjykata vendos pushimin e gjykimit kur ai nuk mund të vazhdojë.

23. Për sa i përket *kërkimit të dytë* të objektit të këtij gjykimi kushtetues, që lidhet me konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka, Gjykata vëren se për papajtueshmërinë e pretenduar kërkuesi u referohet ndalimeve sipas pikës 2 dhe atyre sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës. Ndaj ky kërkim në vetvete përmban dy të tillë, të cilët do të analizohen veçmas.

24. Për sa i përket nënkërkimit për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka për shkelje të ndalimeve sipas pikës 2 të nenit 70 të Kushtetutës, Gjykata mban në vëmendje jurisprudencën e saj.

25. Gjykata ka pohuar se parashikimi nga kushtetutëbërësi i rasteve të papajtueshmërive që lidhen me mandatin e deputetit përbën një garanci për respektimin e parimit të ndarjes së pushteteve, pavarësisë në ushtrimin e mandatit parlamentar, si dhe evitimin e konflikteve të interesave. Ndërsa sipas pikës 2 të nenit 70 Kushtetuta ua ka deleguar ligjeve të posaçme rastet e papajtueshmërisë, në pikën 3 të kësaj dispozite ka preferuar të vendosë ndalimin në rang kushtetues (*shih vendimin nr. 44, datë 7.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se bazuar në paragrafin 4 të nenit 70 të Kushtetutës dhe jurisprudencën kushtetuese, ajo ka juridiksion për rastet e vlerësimit të papajtueshmërisë me mandatin për shkelje të paragrafit 3 të nenit 70, kur vetë deputeti me veprimet e tij shkel ndalimin kushtetues të parashikuar në këtë dispozitë, pra nëse kryen veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor, ose fiton pasuri të këtyre. Vetëm në lidhje me këtë ndalim kushtetutëbërësi ka parashikuar vënien në lëvizje të Gjykatës, sipas paragrafit 4 të nenit 70, e cila në raste të tilla është organi që ka kompetencën për të shqyrtuar në themel çështjen. Për sa u takon rasteve të tjera të papajtueshmërisë, sipas paragrafit 2 të nenit 70 të Kushtetutës ose ligjeve tek të cilat ai referon, Gjykata nuk ka juridiksion për shqyrtimin e tyre (*shih vendimin nr. 72, datë 7.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjykata vlerëson të sjellë në vëmendje se kushtetutëbërësi në dispozita të veçanta kushtetuese ka konsideruar rregullimin e rasteve të papajtueshmërisë së anëtarëve të organeve



kushtetuese kolegjiale, të cilat i ka përcaktuar si çështje të juridiksionit të tyre. Përfundimisht, në mënyrë të shprehur, për raste të caktuara papajtueshmërie, Kushtetuta ka përcaktuar se ato i përkasin juridiksionit të Gjykatës. Në nenin 70, pika 4, Kushtetuta ka përcaktuar se i përkasin juridiksionit të Gjykatës vetëm rastet e papajtueshmërisë sipas pikës 3 të saj, duke lënë kështu të kuptohet se papajtueshmëritë sipas pikës 2 të kësaj dispozite janë çështje që i përkasin Kuvendit.

28. Sipas kërkesës, çështjet që lidhen me papajtueshmërinë në ushtrimin e mandatit të deputetit, Kushtetuta i ka parashikuar në kompetencat që i janë dhënë Gjykatës sipas nenit 131, pika 1, shkronja “e” të saj. Gjykata e vlerëson të pambështetur këtë pretendim.

29. Lidhur me juridiksionin e saj për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve me natyrë kushtetuese, Gjykata ka pohuar se juridiksioni kushtetues e merr përcaktimin e natyrës dhe kufijve të tij drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, që përcakton funksionin themelor të saj dhe që lidhet me dhënien e drejtësisë kushtetuese nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese, ndërkohë që juridiksioni kushtetues detajohet në dispozitat e tjera të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 36, datë 4.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata ka pohuar po ashtu se nenet 131 dhe 134 të Kushtetutës nuk mund të lexohen të shkëputura nga dispozitat e tjera kushtetuese materiale ose procedurale, të cilat përkufizojnë kompetencën, si dhe përcaktojnë mekanizmin dhe procedurën për vënien në lëvizje të Gjykatës. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se normat kushtetuese nuk mund të interpretohen si norma të izoluar, por duhen parë në harmoni me normat e tjera kushtetuese. Një qëndrim i tillë bazohet në faktin se asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete, pasi çdo dispozitë kushtetuese duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese, kjo për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik, pa kontradikta të brendshme. Në leximin e Kushtetutës nevojitet harmonizimi i tekstit të saj integral dhe pajtimi i atyre dispozitave që mund të duket se krijojnë përplasje mes tyre (*shih vendimet nr. 36, datë 4.11.2021; nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 29, datë*

30.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se çdo normë kushtetuese ka një lidhje të caktuar me normat e tjera dhe, së bashku, ato formojnë një tërësi normash të harmonizuar. Çdo normë e Kushtetutës duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese. Kjo për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik. Natyra e Kushtetutës, koncepti i kushtetutshmërisë, nënkupton që ajo nuk mund të ketë kontradikta të brendshme. Për pasojë, asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete (*shih vendimet nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 8, datë 8.3.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata ka theksuar se pika 2 e nenit 70 të Kushtetutës përbën një rregullim specifik dhe bazuar në rregullin interpretues, sipas të cilit norma specifike ka përparësi mbi normën e përgjithshme (*shih vendimin nr. 2, datë 3.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese*), kjo dispozitë ka përparësi mbi nenin 131, pika 1, shkronja “e”, i cili përmban një rregullim të përgjithshëm, ku listohen kompetencat e Gjykatës (*shih vendimin nr. 72, datë 7.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Për sa më lart, Gjykata vëren se në shkronjën “e” të nenit 131, të Kushtetutës përcaktohet kompetenca e Gjykatës për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre. Përcaktimi në këtë mënyrë i kompetencës së Gjykatës është i përgjithshëm, pasi nuk identifikon çështjet/mosmarrëveshjet kushtetuese konkrete, të cilat, nga ana tjetër, i përkasin juridiksionit të saj. Ndaj, kjo dispozitë nuk mund të interpretohet se përcakton në mënyrë shteruese juridiksionin e Gjykatës, por ajo duhet të interpretohet në harmoni me normat e tjera kushtetuese, të cilat përmbajnë rregullime specifike për çështje që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të atyre funksionarëve publikë që bën fjalë kjo dispozitë.

33. Në kushtet kur për nënkërkimin e konstatimit të papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka për shkelle të ndalimeve sipas pikës 2 të nenit 70 të Kushtetutës,



Gjykata vlerëson se nuk ka juridiksion, shqyrtimi i këtij nënkërkimi nuk mund të vazhdojë dhe për këtë shkak ai duhet të pushohet.

34. Për sa i përket nënkërkimit për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka për shkelje të ndalimeve sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, Gjykata konstaton se ai ka marrë përgjigje në vendimin e saj nr. 1/2023. Si më lart u parashtrua, në këtë vendim, në koherencë me jurisprudencën e saj, Gjykata ka ritheksuar se në zbatim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit ka të drejtë të paraqesë mocion për konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetit, ndërsa vendimarrja e Kuvendit është e domosdoshme me qëllim vënien në lëvizje të kësaj Gjykate për t'u shprehur për themelin e çështjes, për sa kohë që pa një vendim të këtij organi Gjykata nuk mund të shqyrtojë kërkesa të tilla (*shih paragrafin 55 të vendimit*). Ndërkohë, pika 4 e nenit 70 të Kushtetutës përcakton se për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të Kryetarit të Kuvendit ose të një të dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatë, e cila konstaton papajtueshmërinë. Pra, konstatimi i papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetit për shkelje të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës është një çështje që i përket juridiksionit të Gjykatës, juridiksion ky që aktivizohet vetëm me kërkesë të Kuvendit. Për sa kohë që ky i fundit nuk ka vendosur për dërgimin e çështjes në Gjykatë, juridiksioni i saj për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka për shkelje të ndalimeve sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, nuk është aktivizuar.

35. Në situatën kur për *kërkimin e dytë*, njëri nga nënkërkimet nuk i përket juridiksionit kushtetues, ndërsa për nënkërkimin tjetër juridiksioni kushtetues nuk është aktivizuar ende sipas parashikimeve kushtetuese, Gjykata vlerëson se shqyrtimi i këtij kërkimi (*kërkimit të dytë*) nuk mund të vazhdojë dhe për këtë shkak ai duhet të pushohet.

36. Edhe për këtë përfundim gjykata mban në konsideratë sa është parashtruar në paragrafin 22 të këtij vendimi në lidhje me ligjin e zbatueshëm për këtë situatë, duke vërejtur se për zbatim thirret përsëri shkronja “c” e nenit 299 të KPC-së. Sipas

kësaj dispozite, gjykata vendos pushimin e gjykimit kur çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor.

37. Në përfundim, Gjykata vlerëson se çështja në shqyrtim para saj, e vënë në lëvizje nga jo më pak se një e pesta e deputetëve, duhet të pushohet në tërësi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 70 dhe 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës, si dhe neneve 1, 66 e vijues dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 23.1.2023.

Shpallur, më 22.2.2023.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahim

Anëtarë pjesërisht kundër: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen nr. 10 (Nj) 2022 të Regjistrat Themeltar, me kërkesë jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit dhe konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka, jam kundër qëndrimit të shumicës vetëm për sa i përket pushimit të gjykimit të çështjes në lidhje me kërkimin e dytë. Në vijim parashtroj qëndrimin tim, i cili është në vijimësi të qëndrimit në pakicë të mbajtur në vendimin nr. 1, datë 23.1.2023, me të cilin Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës së paraqitur nga 1/10-ta e deputetëve, duke shfuqizuar vendimet e mësipërme të Kuvendit.

2. Në lidhje me kërkimin e parë shumica ka vlerësuar se në kushtet kur me vendimin nr. 1, datë



23.1.2023 Gjykata ia ka nënshtruar kontrollit kushtetues vendimet e Kuvendit nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022, duke i shfuqizuar ato si të papajtueshme me Kushtetutën, ky kërkim tashmë ka mbetur pa objekt, ndaj, në mungesë të lëndës, shqyrtimi i kërimit të parë në rastin konkret nuk mund të vazhdojë dhe për këtë shkak ai duhet të pushohet (*shih paragrafin 21 të vendimit*).

3. Fillimisht, dua të theksoj se në rastin konkret nuk jemi para një konflikti kompetencash dhe çështja jo vetëm që nuk është parashtruar si e tillë, referuar pretendimeve të kërkuarit, por as nuk është mbështetur mbi këtë bazë ligjore, neni 131, pika 1, shkronja “ç”, i Kushtetutës. Përkundrazi, kërkesa është mbështetur në përcaktimet e nenit 70, pika 3, i lidhur me ato të nenit 131, pika 1, shkronja “e”, i parë së bashku me nenin 134, pika 1, shkronja “c” të Kushtetutës. Gjykata, në vendimin nr. 1, datë 23.1.2023, ka pranuar një kërkesë për konflikt kompetencash të 1/10-s të deputetëve, duke arsyetuar se ajo ishte subjekt në konflikt dhe se Kuvendi i kishte cenuar të drejtën për të kërkuar dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese. Edhe në çështjen e vënë në lëvizje nga 1/5-ta e deputetëve, shumica sërish ka konstatuar një konflikt kompetencash brenda të njëjtit organ, në dukje mes 1/5 të deputetëve dhe vetë Kuvendit, duke krijuar kështu konfuzion në lidhje me organin që përfundimisht është subjekti në konflikt (1/10-ta apo 1/5-ta) dhe të kompetencës kushtetuese që është prekur/cenuar/kufizuar, për të cilën konstatoj se në asnjë nga këto dy vendime nuk është arritur të përcaktohet në kuptimin që asaj i ka dhënë jurisprudenca kushtetuese.

4. Megjithatë, në lidhje me këtë kërkim i bashkohem qëndrimit të shumicës për pushimin e gjykimit, për sa kohë që vendimet e kundërshtuara të Kuvendit janë bërë objekt shqyrtimi nga Gjykata dhe janë shfuqizuar nga ajo si të papajtueshme me Kushtetutën.

5. Në lidhje me kërkimin e dytë të objektit të kërkesës, ai për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka, shumica ka evidentuar se u referohet ndalimeve sipas pikës 2 dhe ato sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës dhe duke vlerësuar se përmban dy nënkërkime i ka analizuar ato veçmas. Sipas shumicës, në kushtet kur për nënkërkimin e konstatimit të papajtueshmërisë në ushtrimin e

mandatit të deputetes Olta Xhaçka për shkelje të ndalimeve sipas pikës 2 të nenit 70 të Kushtetutës, Gjykata nuk ka juridiksion, shqyrtimi i këtij nënkërkimi nuk mund të vazhdojë dhe për këtë shkak ai duhet të pushohet (*shih paragrafin 33 të vendimit*). Kurse për sa i përket nënkërkimit sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, shumica ka vlerësuar se ai ka marrë përgjigje në vendimin nr. 1, datë 23.1.2023 dhe se juridiksioni i Gjykatës aktivizohet vetëm me kërkesë të Kuvendit. Në kushtet që juridiksioni kushtetues nuk është aktivizuar ende, shqyrtimi i këtij kërkitimi nuk mund të vazhdojë dhe për këtë shkak ai duhet të pushohet (*shih paragrafët 34 dhe 35 të vendimit*).

6. Në vlerësimin tim, në lidhje me sa më sipër duket se ka një mungesë koherence në vendimmarrjen e Gjykatës në shqyrtimin e këtyre dy kërkesave. Në qëndrimin tim në pakicë në vendimin nr. 1, datë 23.1.2023 kam ngritur pikërisht shqetësimin se Gjykata nuk ka bërë një ndarje të qartë të juridiksionit të saj, e cila do të përcaktonte edhe konfliktin e pretenduar kushtetues. Më konkretisht, në thelb kam vlerësuar se për sa kohë që nuk është përcaktuar nëse çështja e parashtruar nga 1/10-ta e deputetëve bie nën ombrellën e mbrojtjes së pikës 2 ose të pikës 3 të nenit 70, kthimi i çështjes në Kuvend sjell paqartësi edhe në vetë qëndrimin që duhet të mbajë ai organ.

7. Përtej kësaj, duke vijuar me analizën e jurisprudencës kushtetuese dhe të kuadrit kushtetues e ligjor, jam shprehur se e vetmja mënyrë që Gjykata të përfshihet në një proces kushtetues të kontrollit të pajtueshmërisë së mandatit, është nëse vetë Kuvendi, si subjekt që përcaktohet nga neni 70, pika 4, i Kushtetutës, ose 1/5-ta e deputetëve, si një subjekt i pakushtëzuar që i lind kjo e drejtë në kuptim të përmbajtjes së neneve 131, pika 1, shkronja “e” dhe 134, pika 1, shkronja “c”, por tashmë i cituar si subjekt në nenin 66, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, vë në lëvizje këtë lloj gjykimi kushtetues.

8. Në përmbajtjen e mëparshme, neni 66, pika 3, i ligjit nr. 8577/2000 parashikonte se kërkesa për papajtueshmëri mund të paraqitej në Gjykatë nga Kuvendi për sa kohë vazhdonte mandati i deputetit. Ndryshimet kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016, kanë prekur edhe ligjin nr. 8577/2000 dhe aktualisht neni 66 ka këtë përmbajtje: “1. Për shqyrtimin e zgjedhshmërisë së deputetëve, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Presidentit të



Republikës, të jo më pak se një të pestës së deputetëve të Kuvendit ose të partive politike. 2. Për shqyrtimin e papajftueshmërisë në ushtrimin e funksioneve të deputetëve, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Kuvendit ose të një të pestës së deputetëve. 3. Gjykata Kushtetuese verifikon, sipas Kushtetutës, zgjedhjen e deputetëve, me kërkesë të partisë politike ose të kandidatit të pavarur për deputet.”.

9. Ky parashikim ligjor është miratuar më datë 6.10.2016 dhe ka hyrë në fuqi pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 7, datë 24.2.2016, me të cilin ajo ka interpretuar nenin 70 të Kushtetutës. Përcaktimi në mënyrë të shprehur i 1/5-s të deputetëve si subjekt kërkuar për shqyrtimin e papajftueshmërisë në ushtrimin e funksionit të deputetit në qëndrimin tim është mekanizmi zhbllokues për të evituar çdo vendimarrje me natyrë politike dhe për të mos lejuar që diskrecioni i Kuvendit në vlerësimin e natyrës së çështjes, sipas pikës 2 ose pikës 3 të nenit 70, të ngelet jashtë çdo kontrolli kushtetutshmërie.

10. Kjo e drejtë e subjektit kushtetues 1/5-ta e deputetëve të Kuvendit është e lidhur me rolin që ka ky subjekt i pakushtëzuar, i parashikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, në mbrojtjen e interesit publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret. Gjykata ka theksuar se interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar (*shih vendimin nr. 55, datë 27.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Përdorimi i lidhëses “ose” në pikën 2 të nenit 66 të ligjit nr. 8577/2000, nga ana tjetër, nuk lejon krijimin e premisave që kjo e drejtë të krijojë përplasje ose të mbivendoset me detyrimin e Kuvendit për t’iu drejtuar Gjykatës. Kjo e drejtë e këtij subjekti (1/5 e deputetëve) synon të garantojë kontrollin jo vetëm të veprimtarisë së Kuvendit, por edhe respektimin e parimeve kushtetuese në ushtrimin e mandatit nga deputeti në rastet kur shumica parlamentare vepron në kundërshtim me normën kushtetuese.

12. Për sa më sipër, në linjë me argumentet e mia në qëndrimin në pakicë në vendimin nr. 1, datë 23.1.2023 të Gjykatës, duke qenë se 1/10-ta e deputetëve të Kuvendit nuk ka asnjë legjitimitet për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, Gjykata

duhej të vendoste rrëzimin e asaj kërkesë dhe të merrte në shqyrtim në themel kërkesën në shqyrtim të paraqitur nga 1/5-ta e deputetëve të Kuvendit. Vetëm në këtë mënyrë ajo do të mund të vijonte më tej me shqyrtimin në themel të çështjes, pa pasur nevojë të presë të investohet sërish nga Kuvendi.

13. Gjykata i kishte të gjitha mundësitë që, në varësi të shkëlqes së deputetit, sipas pikës 2 ose sipas pikës 3 të nenit 70, të përcaktonte në mënyrë të qartë dhe përfundimtare edhe juridiksionin të cilit i përket kjo çështje. Me fjalë të tjera, nëse do të arrinte në përfundimin se ndodhej para veprimit të pikës 2 të nenit 70 të Kushtetutës, Gjykata do ta kthente përfundimisht çështjen në Kuvend, duke e detyruar atë të shprehet për bazueshmërinë e saj, ndërkohë që nëse do të vlerësonte se çështja bie në fushën e veprimit të pikës 3 të nenit 70 do ta shqyrtonte atë në themel, duke dhënë vendim përfundimtar për pajftueshmërinë në ushtrimin e funksionit nga deputetja Olta Xhaçka.

14. Në përfundim, vlerësoj se Gjykata nuk duhej të kishte vendosur pushimin e gjykimit në lidhje me kërkimin e dytë, atë për konstatimin e papajftueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka, por duhej të kishte vijuar me shqyrtimin e tij dhe të shprehej për themelin e pretendimeve të kërkuar.

Anëtare: **Sonila Bejtja**

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të vënë në lëvizje nga një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë (*kërkuar*), me objekt “*Shfuqizimin e vendimeve nr. 83/2022, datë 17.11.2022 dhe nr. 84, datë 17.11.2022 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si të papajftueshme me Kushtetutën. Konstatimin e papajftueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka*”, jam pjesërisht kundër vendimit të shumicës për pushimin e gjykimit të çështjes. Qëndrimi kundër lidhet me pushimin e gjykimit të kërimit për papajftueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka, pasi vlerësoj se ky kërkim duhet të shqyrtohej në themelin e tij dhe të merrte përgjigje përfundimtare nga Gjykata. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin



përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, parashtroj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin pjesërisht kundër.

2. Shumica ka parashtruar se kërkitimi për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes është bazuar në dy shkaqe të ndara kushtetuese: i) për shkelje të ndalimeve sipas pikës 2 të nenit 70 të Kushtetutës; ii) për shkelje të ndalimeve sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës. Të dyja këto shkaqe kushtetuese janë analizuar veçmas. Kështu, për sa i përket shkakut të parë kushtetues, shumica ka konkluduar se referuar shkronjës “e” të nenit 131 të Kushtetutës, Gjykata nuk ka juridiksion dhe për këtë shkak shqyrtimi duhet të pushohet (*shih paragrafin 33 të vendimit*). Kurse lidhur me shkakun e dytë ka konkluduar se juridiksioni i Gjykatës aktivizohet vetëm me kërkesë të Kuvendit dhe për sa kohë ky i fundit nuk ka vendosur dërgimin e çështjes pranë saj, ai nuk është aktivizuar (*shih paragrafin 34, po aty*). Në këtë situatë, shumica ka vlerësuar se shqyrtimi i kërkitimit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes nuk mund të vazhdojë, ndaj ai duhet të pushohet (*shih paragrafin 35, po aty*), pa u shqyrtuar bazueshmëria në themel e tij.

3. Në parantezë vlen të evidentohet se Mbledhja e Gjyqtarëve i kishte verifikuar të përmbushura kriteret paraprake të pranueshmërisë, përfshirë ekzistencën e juridiksionit, për shqyrtimin në themel të çështjes më datë 16.12.2022 dhe kishte vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare (*shih paragrafin 10 të vendimit*). Në seancë plenare nuk u verifikua ndonjë rrethanë e re ose e ndryshuar mbi kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkitimit për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës. Për rrjedhojë, nuk u verifikua situata që vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve për shqyrtimin në themel të kësaj çështjeje të kishte ndryshuar, ndaj nuk pajtohem me qëndrimin e shumicës se Gjykatës i mungon juridiksioni për zgjidhjen e këtij kërkitimi.

4. Në këtë drejtim duhet theksuar se dhënia e vendimit nr. 1, datë 23.1.2023 të Gjykatës Kushtetuese nuk përbën rrethanë të re, me rëndësi përcaktuese për fatin e shqyrtimit në themel të çështjes në fjalë, pasi, në thelb, me anë të këtij vendimi Gjykata ka zgjidhur një mosmarrëveshje kushtetuese midis subjekteve të ndryshme, me

objekt dhe shkak të ndryshëm kushtetues. Thënë ndryshe, ndonëse konteksti i fakteve lidhej me të njëjtat dyshime se deputetja kishte kryer veprimtari në shkelje të Kushtetutës, Gjykata, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “ç” të Kushtetutës, me vendimin nr. 1, datë 23.1.2023, i është përgjigjur në themel konfliktit të kompetencave kushtetuese, duke treguar rolin dhe funksionin kushtetues të një të dhjetës së deputetëve dhe Kuvendit në procedurën e nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, për shkak të nxjerrjes prej Kuvendit të dy vendimeve, me të cilat nuk iu hap rruga mocionit të një të dhjetës së deputetëve. Në çështjen konkrete, ndonëse ekziston i njëjti kontekst faktesh mbi dyshimet për veprimtarinë e deputetes, gjykimi kushtetues është i ndryshëm, pasi kërkuës paraqitet një e pesta e deputetëve dhe objekti lidhet me papajtueshmërinë e funksionit të deputetes sipas nenit 131, pika 1, shkronja “e”, për shkak të veprimeve të kësaj të fundit, që kërkuësi pretendon se janë në shkelje të Kushtetutës.

5. Për ta paraqitur më thjesht argumentin, mund të përdoret analogjia në procedurë. Kështu, Gjykata nuk mund të pushojë gjykimin kushtetues të vënë në lëvizje nga një subjekt i pakushtëzuar për kontrollin e një akti normativ, me arsyetimin se i njëjti akt ka qenë objekt kundërshtimi i një ankimi kushtetues individual, për të cilin Gjykata nuk është shprehur në themel, pasi ka urdhëruar rigjykimin e çështjes nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

6. Nën këtë analizë, më duhet të ritheksoj se kërkitimi për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes i plotëson të gjitha kriteret paraprake të pranueshmërisë dhe zgjidhjes në themel të tij me vendim përfundimtar nga Gjykata, për arsyet e mëposhtme:

7. *Së pari*, kërkuësi legjitimohet *ratione personae*, pasi një e pesta e deputetëve parashikohet si subjekt kushtetues në nenin 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës që ka të drejtë të vërë në lëvizje juridiksionin kushtetues për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret. Interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar (*shih vendimet nr. 18, datë 7.7.2022; nr. 41, datë 16.5.2017; nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 19, datë 15.4.2015; nr. 59, datë 23.12.2014, nr. 18, datë*



29.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese). Për më tepër, me ndryshimet e vitit 2016 që iu bënë ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, në kuadër të reformës në drejtësi, është parashikuar shprehimisht se një e pesta e deputetëve mund të vërë në lëvizje këtë lloj gjykimi kushtetues, krahas Kuvendit (neni 66, pika 2, i ligjit nr. 8577/2000). Mbi bazën e këtij arsyetimi, ndaj vlerësim të ndryshëm me shumicën, e cila shprehet se juridiksioni kushtetues për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit për shkelje të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës aktivizohet vetëm me kërkesë të Kuvendit (*shih paragrafin 34 të vendimit*), pasi në thelb ky argument krijon jurisprudencë për ta shndërruar një të pestën e deputetëve në subjekt të kushtëzuar dhe nuk konsideron interesin publik, të cilin mbart dhe përfaqëson në nivel kushtetues një e pesta e deputetëve.

8. *Së dyti*, kërkuksi legjitimohet *ratione temporis*, pasi e ka paraqitur kërkesën duke respektuar të tria llojet e afateve të parashikuara nga neni 66/a, pika 2, i ligjit nr. 8577/2000. Konkretisht, në kohën e paraqitjes së kërkesës për papajtueshmërinë e funksionit të deputetes, kjo e fundit vazhdon mandatin e deputetes. Përfundimi i rregullt i mandatit të deputetes është i pritshëm të ndodhë me zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin në vitin 2025, që tregon se kërkesa nuk është paraqitur në Gjykatë 6 muajt e fundit të mandatit të saj. Po ashtu, kërkesa ka respektuar edhe afatin ligjor “3 muaj nga konstatimi i papajtueshmërisë”, pasi, siç u pohua edhe nga palët në seancë plenare, veprimtaria tregtare që kërkuksi i atribuon deputetes nuk është ndërprerë ende. Kjo do të thotë se fakti i parashtruar nga kërkuksi si shkak i papajtueshmërisë së mandatit të deputetes, përbën një situatë vazhduese, në të cilën afati ligjor, si rregull, fillon të ecë ditën kur situata vazhduese përfundon.

9. *Së treti*, kërkuksi legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi sipas nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese të vendosë për themelin e çështjes nëse deputeti ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë me mandatin. Në shtesë të argumenteve të dhëna më lart (*shih paragrafin 4 të këtij mendimi pakice*), më duhet të theksoj se, bazuar në parimin e kushtetutshmërisë dhe të shtetit të së drejtës, nuk pajtohem me shumicën që ka konkluduar se çështja duhet të pushohet për shkak

se mungon juridiksioni kushtetues për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes për shkelje të ndalimeve sipas pikave 2 dhe 3 të nenit 70 të Kushtetutës.

10. Gjykata është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës i detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese (*shih vendimet nr. 60, datë 16.9.2016; nr. 25, datë 28.4.2014; nr. 23, datë 8.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Të gjitha organet, të parashikuara ose jo në Kushtetutë, duhet t'i nënshtrohen parimit të kushtetutshmërisë dhe atij të ligshmërisë, pasi vetëm në këtë mënyrë garantohet shteti i së drejtës. Megjithatë, shteti i së drejtës nuk konsiston vetëm në detyrimin për zbatimin e tërësisë së normave juridike nga organet shtetërore, por në sigurimin e kontrollit gjyqësor se si autoritetet respektojnë këto norma juridike (*shih vendimin nr. 29, datë 2.7.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Nën dritën e këtyre standardeve, papajtueshmëria e funksionit të deputetit është çështje e pastër kushtetuese dhe shqyrtimi kushtetues i saj garanton shtetin e së drejtës, pasi mundëson kontrollin gjyqësor mbi veprimtarinë e deputetes, në cilësinë e funksionarit publik dhe më tej edhe mbi veprimtarinë e vetë Kuvendit. Një qasje e kundërt krijon mundësi për arbitraritet dhe mungesë kontrolli gjyqësor të arbitraritetit, në veçanti kur deputeti është pjesë e shumicës parlamentare. Është e vërtetë që për Kuvendin vepron parimi i autonomisë parlamentare, në kuptimin që ai duhet të shqyrtojë çështjen e papajtueshmërisë në instancë të parë, por, siç tregojnë faktet e çështjes konkrete, të pohuara edhe prej palëve në seancë plenare, ndonëse shumica e anëtarëve të Kuvendit vlerësoi se veprimet që i atribuoheshin deputetes binin në fushën e zbatimit të nenit 70, pika 2, të Kushtetutës, Kuvendi nuk e vijoi këtë procedurë, por, në fakt, e përfundoi shqyrtimin parlamentar pa ndonjë vendim themeli mbi rastin.

12. Për sa më lart, çmoj se kërkimi për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes i plotësonte të gjitha kriteret paraprake të pranueshmërisë, ndaj Gjykata duhet ta shqyrtonte në themel atë dhe të jepte vendim përfundimtar.

Anëtare: Marsida Xhaferllari

**MENDIM PAKICE**

1. Një grup prej jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë me objekt: *“Shfuqizimi i vendimeve nr. 83, datë 17.11.2022 ‘Për mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka’ dhe nr. 84, datë 17.11.2022 ‘Për miratimin e raportit të shumicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka’ të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimi i papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka.”* Gjykata, pasi ka analizuar çështjen e juridiksionit të saj kushtetues në lidhje me dy kërkimet e ngritura nga kërkuuesi, ka vendosur pushimin e gjykimit.

2. Për sa i përket *kërimit të parë*, për shfuqizimin e vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit, duke qenë se Gjykata ka shqyrtuar më parë të njëjtin proces të zhvilluar nga Kuvendi, pra për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka dhe me vendimin nr. 1, datë 23.1.2023 ka vendosur se vendimet e lartpërmendura janë të papajtueshme me Kushtetutën (*shih paragrafin 19 të vendimit*), është vlerësuar se ky kërkim tashmë ka mbetur pa objekt dhe për këtë shkak shqyrtimi i tij duhet të pushohet (*shih paragrafin 21 të vendimit*).

3. Në lidhje me *kërkimin e dytë*, për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka, shumica, bazuar në jurisprudencën kushtetuese (*shih vendimin nr. 72, datë 7.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*), ka vlerësuar se Gjykata nuk ka juridiksion për shqyrtimin e çështjeve sipas paragrafit 2 të nenit 70 të Kushtetutës. Ndërkohë, sipas shumicës, Gjykata ka juridiksion për rastet e vlerësimit të papajtueshmërisë me mandatin për shkelle të paragrafit 3 të nenit 70 të Kushtetutës, për të cilat kushtetutëbërësi ka parashikuar vënien në lëvizje të saj (Gjykatës), sipas paragrafit 4 të po këtij neni (*shih paragrafin 26 të vendimit*). Gjithsesi, duke qenë se juridiksioni kushtetues për këto çështje, sipas paragrafit 4 të nenit 70 të Kushtetutës, aktivizohet vetëm me kërkesë të Kuvendit, shumica ka arritur në përfundimin se për sa kohë që ky i fundit nuk ka vendosur për dërgimin e çështjes në Gjykatë,

shqyrtimi i këtij kërkitimi nuk mund të vazhdojë dhe për këtë shkak duhet të pushohet (*shih paragrafët 34-35 të vendimit*).

4. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për përfundimin e arritur në këtë çështje, vetëm në lidhje me kërkimin e dytë, e çmoj të rëndësishme të shpreh argumentet mbi të cilat mbështes mendimin tim në pakicë.

5. Fillimisht, dua të nënvizoj faktin se bashkohem me parimet e theksuara nga jurisprudenca e kësaj Gjykate dhe shumica se për sa u takon rasteve të papajtueshmërisë, sipas paragrafit 2 të nenit 70 të Kushtetutës ose ligjeve tek të cilat ai referon, Gjykata nuk ka juridiksion për shqyrtimin e tyre, ndërsa për rastet e papajtueshmërisë të parashikuara në paragrafin 3 të nenit 70 të Kushtetutës, kur deputeti kryen veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor, ose fiton pasuri të këtyre, Gjykata, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës, ka juridiksion për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit (*shih vendimin nr. 72, datë 7.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Në ndryshim nga shumica jam e mendimit që edhe pse juridiksioni kushtetues për çështjet e parashikuara në paragrafin 3 të nenit 70 të Kushtetutës aktivizohet vetëm me kërkesë të Kuvendit, sipas paragrafit 4 të po këtij neni, kjo nuk do të thotë se rasti në shqyrtim nuk hyn në juridiksionin kushtetues. Përkundrazi, duke qenë se shkaku që qëndron në themel të qëndrimit të shumicës lidhet pikërisht me të drejtën e një të pestës për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues dhe jo me faktin se pretendimet nuk kanë natyrë kushtetuese, bazuar mbi të njëjtën jurisprudencë dhe mbi të njëjtat fakte të shqyrtuara nga shumica, vlerësoj se çështja duhej të analizohej nën këndvështrimin e legjitimitimit *ratione personae* të kërkuessit. Kjo edhe në respekt të jurisprudencës kushtetuese që ka trajtuar po në drejtim të legjitimitimit rastet kur objekt i kontrollit kushtetues ka qenë vendimi i Kuvendit për mosdërgimin në Gjykatë të çështjes për konstatimin e papajtueshmërisë me detyrën të deputetit (*shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Për legjitimitimin e tij, kërkuuesi ka parashtruar se Kushtetuta ka njohur dy mënyra për vënien në lëvizje të Gjykatës për konstatimin e papajtueshmërisë së ushtrimit të funksionit të



deputetit: ajo e parashikuar nga neni 70 i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata vihet në lëvizje me vendim të Kuvendit për shkeljet e pikës 3 të kësaj dispozite; ajo e parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “e” dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, ku me kërkesë të një të pestës të deputetëve Gjykata vendos për çështjet që lidhen me papajtueshmërinë e ushtrimit të funksionit të deputetit. Ky mekanizëm i dytë kushtetues përdoret për pretendimet në lidhje me ushtrimin e mandatit në kundërshtim me nenin 70, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës dhe në bazë të tij kërkuesi legjitimohet (*shih paragrafin 11.2.1. të vendimit*).

8. Në kuptim të sa më sipër, duke qenë se Gjykata është organi që ka kompetencën për të shqyrtuar në themel çështjen e papajtueshmërisë në ushtrimin e detyrës së deputetit, për të vlerësuar nëse në rastin në shqyrtim, kërkuesi, një grup prej jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, legjitimohet *ratione personae* për vënien në lëvizje të gjykimin kushtetues, duhen analizuar dispozitat kushtetuese dhe ato ligjore në këtë aspekt.

9. Në zbatim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se Kryetari i Kuvendit ose një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit ka të drejtë të paraqesë mocion për konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetit, ndërsa vendimarrja e Kuvendit është e domosdoshme me qëllim vënien në lëvizje të kësaj Gjykate për t’u shprehur për themelin e çështjes, për sa kohë që pa një vendim të këtij organi Gjykata nuk mund të shqyrtojë kërkesa të tilla. Pra, në këtë dispozitë është përcaktuar Kuvendi si subjekt i posaçëm që vë në lëvizje gjykimin kushtetues, si dhe Kryetari i Kuvendit ose *një e dhjeta e anëtarëve të tij* si subjekte që iniciojnë (nëpërmjet mocionit) procedurat parlamentare për këtë qëllim (*shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Përmbajtja e paragrafit 4 të nenit 70 të Kushtetutës është reflektuar edhe në nenin 66 të ligjit nr. 8577/2000, i cili përpara ndryshimeve të vitit 2016 (ligji nr. 99/2016) në pikën 3 të tij parashikonte se kërkesa për papajtueshmëri në ushtrimin e detyrës së deputetit mund të paraqitet në Gjykatë nga Kuvendi për sa kohë vazhdon mandati i deputetit. Ndërsa në përmbajtjen aktuale të nenit 66, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se përveç Kuvendit, Gjykata mund të vihet në lëvizje edhe nga *një e pesta e deputetëve*.

11. Në lidhje me raportin ndërmjet normave të ndryshme kushtetuese në shqyrtim, gjatë interpretimit të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, Gjykata ka pohuar parimin se norma e posaçme ka përparësi mbi normën e përgjithshme. Sipas saj, në rastet e procedurave për iniciimin e kontrollit kushtetues të pajtueshmërisë me detyrën dhe vlerësimin të mandatit të deputetit, dispozita e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës përbën normën e posaçme, për rrjedhojë ajo prevalon mbi parashikimin e përgjithshëm të neneve 131 dhe 134 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 1, datë 23.2.2023; nr. 72, datë 7.12.2016; nr. 7, datë 24.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në të njëjtën mënyrë, bazuar dhe në parimin e hierarkisë së akteve normative (neni 116 i Kushtetutës), ajo prevalon edhe mbi parashikimet e ligjit nr. 8577/2000.

12. Në rastin në shqyrtim, referuar rrethanave dhe fakteve konkrete të çështjes, kërkuesi, *një e pesta e deputetëve të Kuvendit*, për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetes Olta Xhaçka, ka vijuar me paraqitjen në Kuvend të instrumentit parlamentar të mocionit, sipas parashikimit të paragrafit 4 të nenit 70 të Kushtetutës. Referuar edhe objektit të kërkesës, kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit, për shkak të procedurës parlamentare që ka ndjekur. Prandaj mendoj se ai nuk legjitimohet për t’iu drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës, sipas nenit 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, si subjekt i pakushtëzuar për vënien në lëvizje të gjykimin kushtetues.

13. Nga ana tjetër, sipas parashikimit të paragrafit 4 të nenit 70 të Kushtetutës, një e pesta e deputetëve të Kuvendit nuk legjitimohet as si subjekt që mund të iniciojë procedurat parlamentare në drejtim konstatimit të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit. Dispozita kushtetuese përcakton shprehimisht një entitet të caktuar të paraqesë mocion, *një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit*, prandaj vetëm ai entitet ka të drejtë të paraqesë kërkesë/mocion për mbrojtjen e të drejtave të pakicës parlamentare.

14. Sikurse Gjykata ka theksuar, Kushtetuta e kufizon ushtrimin e të drejtave të pakicës vetëm tek ata deputetë që së bashku plotësojnë një kuorum të caktuar, pa marrë parasysh përbërjen dhe krijimin e saj dhe pavarësisht anëtarësisë në parti ose grupe parlamentare. Pra, grupet e deputetëve, të cilat



norma kushtetuese u ka njohur të drejta si entitete, nuk nënkuptojnë dhe nuk barazohen me çdo lloj entiteti ose organizimi politik të deputetëve apo partive politike që veprojnë brenda Kuvendit. Në këtë kuptim, jo çdo grup parlamentar i pakicës është automatikisht edhe subjekt kushtetues, në rast se ai nuk plotëson kriteret kushtetuese, si në aspektin formal (numri i deputetëve kërkues), ashtu edhe në aspektin substancial (të provuarit e interesit në rastet kur është e zbatueshme) (*shih vendimin nr. 42, datë 27.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa më lart, për rastet e parashikuara nga paragrafi 4 i nenit 70 të Kushtetutës, pavarësisht faktit se vendimmarrja e Kuvendit është në funksion të legjitimitetit të këtij subjekti për iniciimin e gjykimit kushtetues për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, procedurat parlamentare mund të vihen në lëvizje vetëm me mocion të Kryetarit të Kuvendit ose një të dhjetës së deputetëve të Kuvendit.

16. Si përfundim, kërkuesi, një e pesta e deputetëve të Kuvendit, nuk legjitimohet *ratione personae* t'i drejtohet Gjykatës për të kërkuar konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit sipas procedurave të parashikuara nga paragrafi 4 i nenit 70 të Kushtetutës.

Anëtare: **Fiona Papajorgji**

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues jo më pak se 1/5-ta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë dhe objekt: “Shfuqizimin e vendimeve nr. 83/2022, datë 17.11.2022 “Për mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka” dhe nr. 84, datë 17.11.2022 “Për miratimin e raportit të shumicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka” të Kuvendit, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka”, kam votuar për: (i) pushimin e çështjes për kërkimin e parë për shfuqizimin e vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit, me të njëjtat argumente si të shumicës (*shih paragrafin 21 të vendimit*). (ii) rrëzimin e kërkesës për kërkimin e dytë për konstatimin e

papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka, për shkak se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae* për vënien në lëvizje të Gjykatës për të kërkuar papajtueshmërinë e mandatit të deputetes, nisur nga premisa kushtetuese që Gjykata ka juridiksion për këtë kërkim të dytë. Në vijim do të parashtroj argumentet e detajuara lidhur me juridiksionin dhe moslegjitimitimin e kërkuesit si subjekt kushtetues, iniciues i këtij procesi.

A. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

2. Sikundër edhe është theksuar në vendim, para Gjykatës janë regjistruar në të njëjtën ditë 2 kërkesa, me kërkues një grup deputetësh të Kuvendit. Përveç kërkesës objekt shqyrtimi, një grup tjetër prej 14 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e 1/10-s të deputetëve, ka paraqitur kërkesë me objekt: “Zgjidhja e konfliktit të kompetencave ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10 e deputetëve. Deklarimi i vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit të Shqipërisë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”. Kjo kërkesë është marrë në shqyrtim nga Gjykata në seancën plenare të datës 18.1.2022 dhe, në përfundim të shqyrtimit, me vendimin nr. 1, datë 23.1.2023, ajo ka vendosur: “Pranimin e kërkesës. Zgjidhjen e konfliktit/mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10 -ta e deputetëve. Shfuqizimin e vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit të Shqipërisë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë” (*shih vendimin nr. 1, datë 23.1.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Në vendimin e saj nr. 1/2023 Gjykata ka analizuar juridiksionin e saj, duke u shprehur: “Gjykata konstaton se ekziston një mosmarrëveshje kompetencash midis subjekteve kushtetuese brenda të njëjtë pushtet, një të dhjetës së deputetëve, nga njëra anë, dhe Kuvendit, nga ana tjetër. Ky konflikt mes subjekteve është konkret dhe *prima facie* ka natyrë kushtetuese, pasi Kuvendi, si interpretues i parë i normës kushtetuese, ka nxjerrë vendimet përkatëse nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022, duke u shprehur për mënyrën se si e kupton normën kushtetuese, mënyrë e cila nga një e dhjeta e deputetëve është kuptuar se kufizon të drejtën kushtetuese të tyre, sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës. Në këto kushte, në referim të nenit 131, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se ka



juridiksion për të marrë në shqyrtim kërkesën e kërkuarit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, sipas objektit (*shih paragrafët 11-18 të vendimit*). Ndërsa për themelin, Gjykata ka arritur në konkluzionin se çështja e vlerësimit të papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes, referuar fakteve, nuk i takon vlerësimit të Kuvendit, por vlerësimit të kësaj Gjykate, pasi ato (faktet) kërkojnë shqyrtimin në themel, në mënyrë që të mund të përcaktohet nëse duhet të klasifikohen në parashikimet e nenit 70, pika 2 ose nenit 70, pika 3, të Kushtetutës (*shih paragrafin 54 të vendimit*). Gjykata ka ritheksuar se në zbatim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit ka të drejtë të kërkojë konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetit, ndërsa vendimarrja e Kuvendit është e domosdoshme, me qëllim vënien në lëvizje të kësaj Gjykate për t'u shprehur për themelin e çështjes, për sa kohë që pa një vendim të këtij organi, Gjykata nuk mund të shqyrtojë kërkesa të tilla” (*shih paragrafin 55 të vendimit*).

4. Në vështrim të sa më lart, çmoj se konkluzionet e arritura në çështjen e sipërcituar vlejnë edhe në çështjen në shqyrtim. Për rrjedhojë, vlerësoj se edhe në çështjen konkrete, Gjykata ka juridiksion për shqyrtimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetes, për sa kohë është konkluduar se nuk i takon vlerësimit të Kuvendit, por vlerësimit të kësaj Gjykate që faktet e çështjes të shqyrtohen në themel, në mënyrë që të mund të përcaktohet nëse duhet të klasifikohen në parashikimet e nenit 70, pika 2 ose nenit 70, pika 3, të Kushtetutës. Edhe pse theksoj se në parim jam dakord me qëndrimin se për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit për shkelje të pikës 2 të nenit 70 të Kushtetutës, Gjykata nuk ka juridiksion, qëndrim i konsoliduar jurisprudencial tashmë (*shih vendimet nr. 44, datë 7.10.2011; nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 32, datë 3.6.2016; nr. 72, datë 7.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në vlerësimin tim, vendimarrja e Kuvendit, si domosdoshmëri për vënien në lëvizje të Gjykatës, është e lidhur me legjitimitimin e këtij organi si subjekt iniciues i gjykimit kushtetues për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit. Për rrjedhojë, nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën se juridiksioni kushtetues i Gjykatës për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e

mandatit të deputetes Olta Xhaçka për shkelje të ndalimeve sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, nuk është aktivizuar ende, ndaj dhe çështja duhet pushuar (*shih paragrafët 34-35 të vendimit*). Pushimi i çështjes me argumentin e mosaktivizimit të juridiksionit kushtetues, pasi Kuvendi akoma nuk e ka dërguar çështjen në Gjykatën Kushtetuese, nuk është aspekt juridiksioni, por legjitimimi, ndaj dhe në këtë vendim duhet të kishte zënë vend analiza në drejtim të legjitimitimit të kërkuarit jo më pak se 1/5-ta e deputetëve.

Për legjitimitimin e kërkuarit jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit

6. Kërkuari, jo më pak se 1/5-ta e deputetëve, ka pretenduar se Kushtetuta ka njohur dy mënyra për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit: mënyra e parë, përmes nenit 70 të Kushtetutës dhe vetëm për shkelje të pikës 3 të këtij neni; mënyra e dytë përmes neneve 131/e dhe 134/c të Kushtetutës, ku me kërkesë të 1/5-s së deputetëve Gjykata vendos për papajtueshmërinë e ushtrimit të funksionit të deputetit për shkeljen e pikave 2 dhe 3 të nenit 70 të Kushtetutës (*shih faqet 6 dhe 7 të kërkesës; faqen 4 të parashtrimeve të datës 18.1.2023*). Në këtë aspekt, sipas tij, Gjykata duhet të marrë në analizë dhe legjitimitimin e drejtpërdrejtë të 1/5-s së deputetëve të Kuvendit, si një legjitimitet substancial për paraqitjen e një kërkesë të tillë dhe jo vetëm një legjitimitet formal, sikundër ai i Kuvendit, (*shih paragrafin 8 të kërkesës*).

7. Neni 70 i Kushtetutës, në paragrafët 3 dhe 4, parashikon se “(...) Deputetët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre. 4. Për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të kryetarit të Kuvendit ose të një së dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë”.

8. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka mbajtur qëndrimin se norma specifike kushtetuese ka përparësi mbi normën e përgjithshme, duke theksuar se në rastet e çështjeve të vlerësimit të pajtueshmërisë me Kushtetutën të mandatit të deputetit, neni 70, pika 4, i Kushtetutës përbën normën kushtetuese specifike (*shih vendimet nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 72, datë 7.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Konkretisht, sipas Gjykatës: “Kjo normë ka përcaktuar Kuvendin si subjekt të posaçëm që vë



në lëvizje këtë gjykim kushtetues, si dhe subjektet që iniciojnë procedurat parlamentare për këtë qëllim (Kryetari i Kuvendit ose një e dhjeta e anëtarëve të tij). Vendimmarrja e Kuvendit, në kuptim të nenit 70, pika 4, është në funksion të legjitimitetit të këtij subjekti për iniciimin e gjykimit kushtetues për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit. Gjykata, ka vlerësuar se edhe pse në përmbajtjen e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës nuk është përdorur termi “është i detyruar”, kjo nuk nënkupton se vlerësimi në këtë rast është në kompetencë të Kuvendit, por se vënia në lëvizje e Gjykatës kërkon një vendimarrje të këtij organi, e cila është produkt i seancës plenare, pas respektimit të procedurave parlamentare” (*shih vendimet nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 32, datë 3.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Për sa më lart, Kushtetuta ka parashikuar një arkitekturë normative, ashtu si dhe Gjykata Kushtetuese ka ndërtuar një arkitekturë nga praktika kushtetuese (jurisprudenca) për sa i përket vlerësimit të rasteve të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, që nëse analizohen së bashku arrijnë të ruajnë integritetin e Kushtetutës si një e tërë.

11. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se çdo normë kushtetuese ka një lidhje të caktuar me normat e tjera dhe, së bashku, ato formojnë një tërësi normash të harmonizuara. Çdo normë e Kushtetutës duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese. Kjo për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik. Natyra e Kushtetutës, koncepti i kushtetutshmërisë, nënkupton që ajo nuk mund të ketë kontradikta të brendshme. Për pasojë, asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete (*shih vendimet nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 8, datë 8.3.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në këtë drejtim, nga pikëpamja normative, neni 70, pika 4, i Kushtetutës ka për qëllim mbrojtjen e garancive kushtetuese të interesit publik, kushtetutshmërisë dhe shtetit të së drejtës, ndarjes së pushteteve, parimit të demokracisë, besueshmërisë së publikut në cilësinë e përfaqësimit të tij nga deputetët, në lidhje me papajtueshmërinë e mandatit të deputetit, si proces që fillon me paraqitjen e mocionit, shqyrtimin e tij dhe vendimmarrjen e Kuvendit, si produkt i

seancës plenare, pas respektimit të procedurave parlamentare për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese.

13. Në lidhje me kuptimin dhe zbatimin e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kushtetutëbërësi e ka ngritur në nivel kushtetues të drejtën e pakicës parlamentare (në këtë rast një e dhjeta e deputetëve) për të kërkuar vënien në lëvizje të saj, si shprehje të ushtrimit të pushtetit të saj kontrollues ndaj shumicës parlamentare. Duke i dhënë asaj një mbrojtje kushtetuese, kushtetutëbërësi ka evituar ndërhyrjen e shumicës në ushtrimin e kësaj të drejte, si dhe diskrecionin e shumicës në interpretimin dhe vlerësimin e saj rast pas rasti. Po sipas Gjykatës, kushtetutëbërësi ka parashikuar ndërhyrjen e saj vetëm për konstatimin e rasteve të papajtueshmërisë të parashikuara në pikën 3 të nenit 70 dhe se përfshirja e saj në këtë proces është bërë për të eliminuar një vendimarrje me natyrë politike nga ana e Kuvendit (*shih vendimet nr. 72, datë 7.12.2016; nr. 7, datë 24.2.2016; nr. 29, datë 30.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në vështtrim të kësaj jurisprudence, një e dhjeta e deputetëve është subjekt i ngritur në nivel kushtetues që mund të iniciojë një procedim disiplinor për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, dhe është vendimi i Kuvendit që në kuptimin formal vë në lëvizje gjykimin kushtetues referuar nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, ku parashikohet: “Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese”. Në kushtet kur kjo nuk ndodh, neni 70, pika 4, i Kushtetutës njeh të drejtën e subjekteve iniciuese të procedurave parlamentare, një të dhjetës të deputetëve, që nëse pengohen në ushtrimin e kësaj të drejte procedurale kushtetuese, t’i drejtohen Gjykatës me kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës.

15. Nën dritën e rrethanave të kësaj çështjeje, sikundër theksova edhe më lart, tashmë 1/10-ta e deputetëve ka iniciuar një gjykim kushtetues, ndërkohë që edhe jo më pak se 1/5-ta e deputetëve ka iniciuar këtë gjykim kushtetues, dhe, në thelb, pretendimet e parashtruara kanë të bëjnë me të njëjtin proces të zhvilluar nga Kuvendi, që lidhet me konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka, që është objekt edhe i këtij gjykimi kushtetues, dhe me të njëjtat



vendimmarrje të tij, pra vendimet nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022.

16. Referuar fakteve të çështjes, rezulton se mocioni i datës 20.6.2022 është paraqitur nga 14 deputetë, ndërsa më datë 1.7.2022 është paraqitur një mocion prej 15 deputetësh. Në Raportin Përfundimtar të Deputetëve të Shumicës Parlamentare të Këshillit për Rregulloren, Mandateve dhe Imunitetit, citohet: “Këshilli, më datë 24 Qershor 2022, mori në shqyrtim të dyja mocionet me objekt: “*Ndjekja e procedurës parlamentare për konstatimin e parlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka*”. Deputeti Saimir Korreshi parashtroi mocionin e datës 20.6.2022. (...) Deputeti Agron Shehaj parashtroi në emër të 15 deputetëve opozitarë, mocionin datë 1.7.2022. Për deputetët firmëtarë në thelb dy kërkesat e paraqitura kanë të njëjtin qëllim dhe i sugjeroi Këshillit, se ato nga pikëpamja ligjore dhe juridike janë të bazuara dhe duhen dërguar para Gjykatës Kushtetuese. Në parashtrimet e tij në lidhje me kërkesën për mocion parashtroi dhe dallimet e kërkesës së tyre nga kërkesa për mocion e depozituar nga 1/10 -ta e deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike” (*shih faqen 14 të këtij raporti*).

17. Për sa më lart, nisur edhe nga situata faktike, vlerësoj të evidentoj se këto dy subjekte, iniciues të procedurave disiplinore parlamentare, për efekt të gjykimit kushtetues, janë një e dhjeta e anëtarëve të Kuvendit, në këndvështrim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës. Në këtë kuptim, nuk mund të lexohen nga pikëpamja kushtetuese, si jo më pak se një e pesta e deputetëve, subjekt kushtetues.

18. Neni 70 i Kushtetutës vendos detyrime për deputetet dhe Kuvendin, të cilat synojnë shmangien e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit dhe përfaqësimin e popullit në mënyrë të lirë dhe me mirëbesim. Veçanërisht pika 3 dhe 4 e nenit 70 të Kushtetutës pasqyrojnë interesin kushtetues për shmangien e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit (në rast se kryen veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit dhe e pushtetit vendor dhe përfitimi i pasurive të këtyre të fundit), por edhe mbrojtjen e mandatit të deputetit, përmes kontrollit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese. Ky proces nuk mund të interpretohet përveçse sipas qëllimit të tij, që si rezultat përfundimtar ka mbrojtjen e

kushtetutshmërisë përmes vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese.

19. Në vlerësimin tim, nisur nga këndvështrimi sistematik i dispozitës, ky synim i kushtetutëbërësit arrihet në mënyrë të harmonike vetëm brenda nenit 70, pika 3 dhe pika 4, të Kushtetutës, i cili përcakton subjektet, procedurat dhe kriteret e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit. Kjo qasje e kushtetutëbërësit shpjegohet duke kuptuar dallimin mes 1/10-s së deputetëve dhe 1/5-s së deputeteve nga pikëpamja kushtetuese. Të dyja subjektet e gjykimit kushtetues parashikohen nga Kushtetuta dhe jurisprudenca si të tilla, po ashtu të dyja kanë qëllim mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe interesit publik. Megjithatë, 1/5-ta e deputeteve (28 deputetë) është përcaktuar si subjekt i pakushtëzuar që mund t'i drejtohet Gjykatës për të gjitha rastet kur Kushtetuta dhe jurisprudenca e kësaj Gjykate e ka legjitimuar (*shih vendimet nr. 18, datë 7.7.2022; nr. 46, datë 29.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërkohë, 1/10-ta e deputetëve, (14 deputetë) legjitimohet për mosmarrëveshje kompetencash, nëse i cenohet e drejta si subjekt në konflikt sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës. Po ashtu, Kushtetuta ka përcaktuar dhe subjektin kushtetues 1/4-ën e deputetëve (35 deputetë) si subjekt me të drejtën për të ngritur komisione hetimore, dhe Kuvendi është i detyruar ta ngrejë komisionin, nëse ky subjekt e kërkon sipas nenit 77, pika 2, të Kushtetutës. Nëse kjo nuk ndodh, ky subjekt i drejtohet Gjykatës Kushtetuese (*shih vendimet nr. 42, datë 27.12.2022; nr. 22, datë 5.5.2010; nr. 20, datë 4.5.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në këtë vështrim, roli kushtetues i 1/10-s së deputetëve që përkthehet në një numër më të vogël deputetësh se çdo subjekt tjetër iniciues i gjykimit kushtetues si entitet që përbëhet nga deputetë të Kuvendit (1/5, 1/4), vjen si garantues i interesit publik përmes inicimit të një procesi disiplinor parlamentar. Subjekti, jo më pak se 1/5-ta e deputetëve, mbart të njëjtin interes kushtetues si dhe 1/10-ta e deputetëve, por procesi disiplinor parlamentar ndaj deputetit si fazë e domosdoshme dhe paraprake e përthith dhe e realizon këtë interes, dhe po ashtu e përçon në mënyrë të ndërlidhur edhe në procesin kushtetues, nëse 1/10-ta e deputetëve pengohet gjatë këtij procesi. Për rrjedhojë, çështja e mbrojtjes së kushtetutshmërisë nuk mbetet jashtë kontrollit kushtetues, dhe po ashtu subjekti iniciues i procedurave parlamentare transpozohet si subjekt në konflikt për



mosmarrëveshje kushtetuese, nëse Kuvendi nuk vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese kur është rasti i tillë, që *prima facie* çështja ka nevojë për shqyrtim në themel, pasi të plotësojë kushtet formale juridike.

21. Procesi i lartpërmendur garanton dhe rolin e Kuvendit si vlerësues i parë i kriterëve kushtetuese të mocionit të paraqitur, në zbatim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës. Kjo hapësirë e vlerësimit të Kuvendit lidhet me verifikimin e kriterëve juridiko-formale, duke respektuar procedurat parlamentare të parashikuara në Rregulloren e këtij organi. Sikundër dhe Gjykata ka theksuar, Kuvendi shqyrton vetëm nëse mocioni i paraqitur ka të bëjë me papajtueshmërinë e mandatit të deputetit. Shqyrtimi juridiko-formal do të thotë që organi juridiksional, në këtë rast Kuvendi, nuk zhvillon hetim për përcaktimin e fakteve, pra nuk shqyrton dhe debaton provat me qëllim përcaktimin e fakteve dhe rrethanave. Në këtë lloj procedure, Kuvendi vlerëson *prima facie* nëse pretendimi i paraqitur në mocion është haptazi i pabazuar ose jo. Ndërkohë, kjo Gjykatë ka pranuar se Kuvendi, si interpretues i parë i normës kushtetuese, gjatë zbatimit të saj ka autoritet fillestar për të shqyrtuar dhe gjykuar kërkesat për shkelje të prezumuara të rregullimit të nenit 70, pika 3, të Kushtetutës (*shih paragrafin 46 të vendimit nr. 1/2023*).

22. Nga sa më lart, në vlerësimin tim, nëse nuk realizohet procesi administrativo- disiplinor i lartpërmendur, Gjykata do të shndërrohet me funksione fillestare në këtë proces, duke verifikuar që nga numri i anëtarëve nënshkrues të mocionit, ekzistencën e dokumentacionit dhe provave e të gjitha kriteret formalo-juridike të kërkuara, sipas nenit 70, pika 3, të Kushtetutës, që do sillte për pasojë dhe ndërhyrje në juridiksionin e Kuvendit. Ndaj dhe sipas kësaj linje arsytimi, legjitimimi nga Gjykata i subjektit të pakushtëzuar, i jo më pak se 1/5-s së deputetëve të Kuvendit, për paraqitje të kërkesës me objekt papajtueshmërinë e mandatit të deputetit, do të asgjësonte procesin administrativo-disiplinor të zhvilluar në Kuvend, i cili do të duhet të përmbyllet me një vendim nga ana e Kuvendit për dërgimin ose mosdërgimin e çështjes në Gjykatë Kushtetuese sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës.

23. Nën dritën e të gjitha argumenteve të mësipërme, vlerësoj se nëse do të pranohej e drejta e jo më pak se 1/5-s së deputetëve për t'iu drejtuar

Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, ky qëndrim do të sillte një kontradiktë të brendshme të Kushtetutës, konkretisht të nenit 70, pika 4, në raport me nenin 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës. Ndërkohë që bazuar mbi interpretimin sistematik, qëllimor, integral e harmonik të Kushtetutës kjo nuk mund të ndodhë, pasi Kushtetuta prezumohet si një dokument me një tërësi dispozitash pa kontradikta dhe në harmoni të plotë.

24. Po ashtu, legjitimimi i jo më pak se 1/5-s së deputetëve do të binte ndesh edhe me jurisprudencën kushtetuese, që nuk e ka legjitimuar këtë subjekt për të kërkuar konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit në zbatim të pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, duke pranuar si subjekt të vetëm që mund t'i drejtohet asaj Kuvendin e Shqipërisë. Konkretisht, me vendim interpretues përfundimtar të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, kjo gjykatë ka vlerësuar: “Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkuesi, një e pesta e deputetëve, si një nga subjektet e parashikuara në nenin 134 të Kushtetutës, nuk legjitimohet t'i drejtohet drejtpërdrejt Gjykatës për të kërkuar konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit. Në të tilla raste, në pajtim me pikën 4 të nenit 70 të Kushtetutës, Gjykata mund të vihet në lëvizje vetëm me vendim të Kuvendit” (*shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 12*).

25. Sikundër kjo Gjykatë ka theksuar në jurisprudencë të konsoliduar, ashtu si edhe në vendimin nr. 1/2023, Kuvendi është *subjekt iniciues i gjykimit kushtetues për papajtueshmëri të mandatit*, sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës. Në këtë drejtim, risjell në vëmendje çështjen e deputetit I. B. (*shih vendimin nr. 44, datë 7.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*), ku Gjykata është vënë në lëvizje nga vetë Kuvendi për shqyrtimin në themel të kërkesës dhe vlerësimin e papajtueshmërisë së mandatit të këtij deputeti; çështjen e deputetit K.K. e iniciuar me vendim të Kuvendit për shqyrtimin në themel të kërkesës dhe vlerësimin e papajtueshmërisë së mandatit të këtij deputeti (*shih vendimin nr. 32, datë 3.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*); çështjen e deputetit R.S. e iniciuar me vendim të Kuvendit për shqyrtimin në themel të kërkesës dhe vlerësimin e papajtueshmërisë së mandatit të këtij deputeti (*shih vendimin nr. 72, datë 7.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*);



çështjen e deputetes V.L., të iniciuar me vendim të Kuvendit për shqyrtimin në themel të kërkesës dhe vlerësimin e papajtueshmërisë së mandatit të kësaj deputeteje (*shih vendimin nr. 93, datë 17.5.2016 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Përveç sa më lart, nëse qëllimi i kushtetutëbërësit do të ishte i ndryshëm, pra nëse do të kishte për qëllim legjitimimin e jo më pak se 1/5-s së deputetëve për konstatimin të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, do ta kishte shprehur përmes ndryshimeve kushtetuese vullnetin e tij, duke ia njohur atë shprehimisht edhe subjektit kushtetues, jo më pak se 1/5-ta e deputetëve. Ndaj dhe për rrjedhojë çdo lloj ndryshimi jurisprudencial do të krijonte normë të re kushtetuese, duke e kthyer Gjykatën në ligjvënës kushtetues. Ashtu sikundër kjo gjykatë ka theksuar, interpretimi përfundimtar që bën Gjykata nuk ka si qëllim shtimin e normave të reja, por deklarimin ose pohimin e përmbajtjes së këtyre normave. Me qëllim shmangien e çdo mundësie për ndërhyrje nga Gjykata në kompetencat e pushtetit ligjvënës, Gjykata nuk merr përsipër të kryejë rolin e legjislatorit, por t'u japë jetë normave kushtetuese përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre (*shih vendimin nr. 29, datë 30.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Referuar arkitekturës normative aktuale kushtetuese, 1/10-ta e deputetëve (14 deputetë) është garanci e mjaftueshme për mbrojtjen e interesit publik dhe respektimit të parimeve kushtetuese si shteti i së drejtës, kushtetutshmëria, e demokracia, si vlera që duhen siguruar edhe përmes inicimit të procesit administrativo-disiplinor ndaj

një deputeti të Kuvendit për papajtueshmëri mandati.

28. Në përfundim, për arsyet e lartpërmendura, vlerësoj se subjekti iniciues për vënien në lëvizje të Gjykatës për konstatimin e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit është vetëm Kuvendi, përmes një vendimmarrje, sipas nenit 70, pika 4 e Kushtetutës, dhe për këtë shkak kërkuesi nuk legjitimohet, ndaj dhe kërkesa duhej rrëzuar.

Anëtare: Elsa Toska

VENDIM

(I shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 29 (470), datë 11.2.2022, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Luçjan Lazër Shqau, i lindur më 12.12.1976, në Shkodër dhe banues në rrugën “Hilë Mosi”, lagjja nr. 1, si dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë e shtetases Linda Lazër Shqau.

KËRKESË

Shtetasja Enerjeta Muça kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë shpalljen e vdekjes së shtetases Tefta Kallaku, e bija e Metatit dhe e Dhëspinës, e datëlindjes 5.12.1938.

KËRKUESE
Enerjeta Muça

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 400 lekë